

# FERHAT ÇAKAJ

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-32  
C16

TREGIME

në  
korie  
mes  
lisash

891.983-32

S

G/16

FERHAT CAKAJ

# NË KORIE MES LISASH

(tregime)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NË KORIE MES LISASH

- Ej, rini, nga kalon kjo udhë?
- Vetëm këtej, xhaxha...
- Epo, më pritni. Më kërreni këtej se lajthita fare...

Burri u ngrit nga shkëmbi mes lisash dhe u afrua me hapa të mëdhenj e të shkathët. Ai shikoi dy të rintjtë dhe ju duk sikur djali dhe vajza u stepën pér një çast. Ata u shqetësuan. «Tashti është fort herët», mendoi burri. «Sapo zbardhëlleren majat, kurse unë nuk durova edhe pak. Sigurisht ngaqë u mërzita vetëm. Tërë jetën kam kaluar pas bagëtisë. Dyzet vjet, po, plot dyzet vjet, djalli e marrtë! Si më qëlloi kjo rrugë tamëm këtej, xhanëm? Po ç'them? Unë vetë erdha këtej që të shikoja greminën ku ra Ajo. Dhe u mërzita. Vëtmia të mërzit. Vitet e fundit unë e kam ndjerë vëtminë dhe e kam urryer, ndonëse kam qenë bari tërë jetën. Sidoqoftë këta të dy e kanë një hall, pra u stepën.»

Ai doli me hapa të mëdhenj e të shkathët, rrugë e pa rrugë mes lisash deri te të rintjtë. Tek afrohej, ai mendonte: «sigurisht që nuk e pritnin t'u dilte këtu mes kories një «xhaxho». Po unë nuk

jam tamëm xhaxho, more bij. Këtu qëndron mese-lea ime. Jam dyzet vjeç, pa grua e pa fëmijë... Këta të dy me të vërtetë duken fëmijë», mendoi.

Burri e kuptonte këtë, por, përsë të stepeshin ata? C'tu ketë ngjarë që shikojnë si me dyshim dhe armiqësi? «Sigurisht që po ndodh si në përralla,» qeshi me vete ai. Takoi hallemadhi shokët e tij të fatit... «Po s'duhet të jetë kështu. Ky djalë dhe kjo vajzë i ngjajnë këtij mëngjezi që po hapet mbi korie, kurse unë atij muzgu që i mbylli sytë mbrëmë. Djalli e marrtë!»

Ai pështyu dhe arriti. Ata u takuan siç takohen të panjohurit. Vazhduan rrugën përpara mes lisash të njomë. Koria kishte lisa dhe shkozë. Mëngjezi fërférinte ndër degë dhe zogjtë po hapnin sytë mes gjethit të ri. Burri ndjente frymëmarrjen e kories dhe se si ajo po shpihej nën horizontin e kaltër të majave.

Në fillim printe vajza, pastaj djali. Në fund «xhaxhua» që i ndiqte me syrin e tij të vëmend-shëm. «Fëmijë, tamëm fëmijë,» tha me vete. «Kaq do t'i kisha fëmijët e mi. Ja, sa këta, por...» — atij ju këput mendimi si rreze drite, se ju kujtua e shoqja, e ndjera...

«O zot më bën nënë! O zot më bën me fëmijë! Sa një lodër le të jetë, veç nga barku im të dalë! Më dëgjo, o zot i madh!...» — zëri i së shoqes i erdhë i shkoqur, i qartë, plot ndjenjë të sinqertë. Ju duk sikur e kishte pranë. E kishte dëgjuar në gjithë këto orë që qëndroi mbi shkëmb, këtu mes kories me lisa, karshi tyrbave të teqesë së Tëranit. Zërin ai gati e ndjente njësoj si dikur, para se të ndodhë fatkeqësia.

— Ç'të ndodhi në këto anë, xhaxho? — pyeti vajza duke kthyer kokën.

Burri e shikoi. Ajo qeshte kur fliste, dhe ju duk më e bukur se në fillim. Zëri i saj kishte një tingull të qartë, melodioz si fragment këngë. Burri shikoi edhe një herë xhaketën e saj prej stofi të bardhë, të lirë dhe tutat prej fanellate të kuqe. «Tamëm fëmijë duket kështu», mendoi. «Sikur të kishte çitjane, do të dukej nuse në lule...»

— Isha deri në lokalitet për ca dhen të kooperativës. Kalova këtej, mos i bija më afér, por më zuri nata këtu në Tëran. U ngrita menatë. Thashë, të zë brigadën për punë... Po ju nga ju kemi?

Djali u kthye dhe e shikoi me mirëbesim. Burri e kapi shikimin e tij.

— Si të të them, xhaxho. Ja, kjo është nga Tërani, kurse unë nga qyteti. Sot mos pyet nga je, po ku punon...

Rruja vazhdonte mes kories. Ndjehezin aromat e frashërit e të dunicës. Lisi kishte endur plotësisht gjethet që lodronin e këndonin nga era. «Tashti ngrejnë kokën lulevedrat dhe lajnë sytë me vesë», mendoi burri. «Pikla e vesës që mbetet në këmborën e bardhë të lulevedrës duket si margaritar shkëlqimtar, sapo i bie rrezja e parë e dieillit. Kur shkoja me dhen, bisedoja edhe me zë me lulevedrat», mendoi ai. «Njëherë unë dhe Ajo e ngritëm nomenë dhe fjetëm pranë kories rrëzë malit. Kur zbriti drita mbi korie, pamë se kishim fjetur mbi lulevedra. I kishim shtypur e thyer ato. Disa këmborë të bardha ishin plasur e shëmtuar. Asaj i erdhi keq për to dhe nisi të thërriste:

«Uuu! Ç'paskemi bërë! Qyqja unë, korba unë!  
Këto s'duhen këputur se janë të shenjta. I ka bekuar zoti. Janë lulet e pranverës në mal...» Zëri i së shoqes përsëri i erdhi qartë si gjatë natës aty mbi kep. Atij i tingëlloi njësoj si më parë, si në ëndërr dhe se si i erdhi. «I ka bekuar zoti», përsëriti me vete fjalët e asaj dhe u drodh. Qeshi me hidhërim dhe shikoi të rintjtë që shpejtonin përpara. Përballë doli kodra. Mbi të qiparizat e errët. Mes tyre — tyrbja dhe teqeja e Tëranit. Burri mbajti vesh dhe ndjeu si erdhën prej andej blegërima dhensh. Ai e urrente këtë peisazh dhe do të donte, sikur të mundej, ta vithiste me gjithë kodër në lumë, por e ndjente se ishte i dërrmuar. Asnjë degë lisi s'mund të këpuste.

— Atje ka qenë teqeja e Tëranit, në s'gabohem — foli burri.

— Ka qenë. E prishëm ne — tha vajza, pa e kthyer kokën. — Dedenë ja falëm dreqit. Dervishët i nisëm nga sytë këmbët. Tani këtu janë stallat...

Vajza përsëri, siç dukej, qeshte sepse zëri i tingëllonte me të vërtetë si vazhdimi i një kënge. Burri shikoi shpatullat e saj të gjera dhe flokët e valëzuar që i derdheshin mbi supe. «Kështu i kishte edhe Ajo», mendoi. «Kështu të gjera, të plota. Kur qante herë-herë për punë të fëmijës që s'po na lindte, unë e zija për supesh dhe e tundja që të vinte në vete. E tundja si kafshë, kurse ajo më lëshohej në qafë dhe më puthte.»

«Pse na dënoi zoti ne, pse?! — thërriste ajo dhe lotët më ngjiteshin për faqesh», mendoi burri dhe përsëri u ndrydh në vetëvete se ndjeu zërin e largët të së shoqes. — Si duket jam sëmurë — tha.

— Do tē kem ethe se po shikoj ēndrra me sy hapur. Apo jam nē ēndërr? Djalli e marrtē, ja ku i kam këta dy tē rijnj dhe vetë po eci pas tyre... C'më mbytën kështu mendimet? Po do tē jem sëmurë, do tē kem ethe... S'ka si tē jetë kjo punë, tha me vete dhe u qetësua.»

Vajza ecte përpara. Tej supeve tē saj dukej fshati tjetër me tarracat që derdheshin valë-valë tē gjelbëra deri mbi lumë.

— Dedei i teqesë ishte demagog — tha djali.

— Cfarë? — pyeti burri që nuk e kuptoi fjalën se ju duk sikur i tha pér «mësues».

— Mashtronte gratë. Sidomos ato që nuk lindnin. Nga ky shkëmb u hodh njëra nga ato se nuk duroi poshtërimin. Atë më duket e quanin Gjeraqinë, se edhe shkëmbin e thërrasin me emrin e saj. Apo jo, Melitë?

— Ashtu, ashtu — u përgjegj vajza.

Burrit i bëri përshtypje emri i vajzës.

— Gjeraqinë e quanin dhe kishte qenë e bukur, nē lule tē moshës. E morën nē qafë... Natyrisht, jo njerëzit e saj, se ata ishin injorantë por këta demagogët e mallëkuar. Ne tē minierës e morëm vesh shumë vonë këtë histori. Kurse Melita e ka parë vetë. Në mëngjez si tani ka ndodhur, apo jo, Melitë? — pyeti tē shoqen djali. Vajza aprovoi.

«Ky duket njeri me gram», mendoi burri. «Në minierë do tē ketë gjithfarë punësh, jo veç nën tokë. Ne barinjtë e kemi punën më tē bukur, mbi tokë, maleve, korieve. Po ky i ka pesë para shkollë. Duket, se flet fjalë tē rënda dhe tē drejta». Ai shikoi dy tē rijnjtë dhe mori frymë thellë. Ndjeu erën e veçantë tē lulevedrës, tē frashërit dhe dunicës, e

syri i zuri hijet e errëta të qiparizave atje sipër mbi kodër. Ofshani dhe pështyu. Atij ju duk sikur ndjeu ulërimën e asaj. E ndjeu qartë si ndjen një-riu në ëndërr, në makth. Ulërima sikur erdhi nga honi i shkëmbit që i hidhte rrënjet poshtë në bregun e lumit.

— Ajo nuk ulëriti fare — tha Melita. — Ne e pamë, kur ajo eci me vrap drejt majës së shkëmbit. E ndiqnin dy dervishë. Donin ta zinin. Pastaj ajo u hodh në greminë, kurse dervishët mbeten si langoj atje në majë. E tmerrshme! Iku kot... Gjithë brigada jonë u kthyte e shkoi atje me vrap. Por vonë. E gjetëm copë-copë, qyqen. Dukej sikur flinte ashtu e copëtar. Por ama nuk ulëriti, kur u hodh... Kam pasur përshtypjen se gratë që hidhen nga shkëmbi, ulërijnë...

Burri e kishte humbur mendjen. Ai përfytyroi të shoqen të vrarë e të copëtar në këtë hon. «Kjo vajzë me brigadën e saj e kanë parë syrin e saj të fjetur atë mëngjez të kobshëm. Dhe ndodhi në pranverë, në një mëngjez si ky». Ai kujtoi një çast. I ndodhi njëherë që, tek flinin, ajo i kishte zënë me trup dorën e djathtë. «Flinte si një fëmijë dhe ishte po aq e bukur edhe në gjumë», tha me vete. «Po sikur të më vdesë», mendova duke e shikuar atë që flinte ashtu... Pastaj ajo qeshi në ëndërr. Dhe atë ditë pranvere që e sollën të vdekur, këtë kujtova. Ah, Gjeraqinë, Gjeraqinë! Të vrava vetë, thëllënxa ime. Ti ishe gati të shkoje prapa diellit, veç të kishim një fëmijë që të thithë gjirin tënd, kurse unë të solla në këtë teqe të zezë. Unë të solla, unë... M'u vu në shpinë tërë shtëpia dhe unë hajvani të solla këtu. Ah, Gjeraqinë! Ah!» — psherëtiu burri.

Ai u drodh. Era e mëngjezit i hyri në gjoksin leshtor nën fanellën e leshtë dhe e zgjoi. «Në djall teqeja me gjithë dervishë», mendoi. «Po unë pas-kam shkalluar sot. Më duket kam ethe, ose jam bërë bihut nga nata. Si djallin e mora këtej rrugën? Ah, po. Erdha vetë që të shikoja greminën...»

-- Ajo shkoi kot. Edhe për fajin tonë shkoi — tha Melita. — Nuk punojmë mirë ne të rinxjtë me fshatarin. Grijmë sallatë nëpër brigadë gjithë ditën, por mësimet e partisë duhet t'i çosh në vatra benda. Ende ka gra që besojnë se do të kishin fëmijë, po të shkonin në teqe. Shkonin në teqe dhe përfundonin në hon. Sidoqoftë, Gjeraqina e zezë ka qenë trimëreshë. Jetoj e vdiq si Gjeraqinë, s'pranoi të zvarritjej në këtë teqe të mallëkuar. — Zëri i vaj-zës, i qartë e melodioz si këngë, e trazoninte burrin mu në shpirt.

«Aman, jo në teqe! Të lutem si zotit, në teqe jo! Të puth këmbën, jo në teqe!...» — burri dëgjoi përsëri zérin e së shoqes si atë natën e fundit. I ishin vënë në shpinë të gjithë. Të gjithë kërkonin që ai ta conte në teqenë e Tëranit, kurse ajo lutej. Nuk donte. Sikur ta parandjente atë që do të ndodhte. «Po edhe unë nuk kisha dëshirë ta çoja atje», mendoi. «Kot si pranova. Çova dashin e zi dy ditë përpara atje. Kur ajo më lutej, çdo gjë kishte marrë fund. Unë do ta çoja edhe Gjeraqinën... E priste teqeja për shërim... Po, pse pranova? Unë, vetë. Po, unë, vetë», tha me vete burri dhe ndjeu lodhjen e natës. Ju prenë gjunjët.

— Kam dëgjuar se në kohën e turkut shqipë-tarkat hidheshin shpesh nga shkëmbenjtë — tha djali. — Më duket se këtë e kemi mësuar në histori.

— Edhe në kohën e tiranit Ali Pasha — vazhdoi Melita.

Burri ishte hutuar. Ai nuk mendonte më as gjë. I vinte mirë që këta dy pëllumbat po e nxirrnin nga ajo korie.

— Bëmë mirë që u vumë drunë këtyre demagogëve dhe kazmën atyre tyrbeve të zeza, se do t'i ndërrohej përsëri emri shkëmbit... — tha vajza. Djali qeshi.

— Zoti. Teqeja, dedej, dervishi... E tmerrshme! Ç'njerëz të poshtër! — zëri melodioz i vajzës përzihej me fërfërimën e gjethit të ri të lisit, të frashërit, të lulevedrës së vogël me këmborëza të bardha.

«Zoti, ku është zoti?», pyeti veten burri. «Dhe unë sonte u ngrita kundër tij. Sonte, pas kaq kohe... Ku është ai? Pallavra! Të gjithë mashtrojnë vec pér hesap të vet. Megjithëse sonte jam i tronditur se jam pa gjumë, jam bërë bihut. Jam si në ethe. Ajo iku e shkoi. E vrava vetë thëllënëxën. Vetë ua çova ndër duar atyre xhahilëve. E kë pa? Gjeraqinën time, shpirtin tim. Unë do të isha i lumiatur edhe pa fëmijë. Ajo më donte shumë, e shkreta. Më donte si ajo», tha me vete plot hidhërim duke kujtar të shoqen.

— Po ju, more bij, s'më thatë kush ini e nga vini... — ju drejtua ai dy të rinxve.

Djali ktheu kokën dhe sikur u mendua pak. Vajza u ndal. Rruga aty merrte poshtë drejt bregut të lumit. Ata do të zbrisnin pas pak dhe do të kalonin urën që të dilnin në xhade.

— A nuk e ndezim njëherë, xhaxho? — tha djali.

Burri u ul mbi një gur dhe ndjeu se guri ishte i ftohtë. Edhe të rintjtë u ulën aty afër, pranë e pranë njëri-tjetrit, por mbi bar. Ata e ndezën nga paqeta e djalit dhe po vështronin lumin. «Lumi rrjedh si gjithnjë», mendoi burri.

— Të një barku ini?

— Jo — tha vajza. — Ky është im shoq, Rrapi.

Ajo foli në një mënyrë sikur po e mbronte, sikur t'ja kishte mohuar dikush. Burri ndjeu në zérin e saj atë notë të veçantë që i dha theksi fjalëve «im shoq».

— Kur ini martuar? — pyeti burri.

Djali qeshi. Vajza e shikoi me seriozitet.

— Sot. Si ta them, more xhaxho... Ne kemi ca kohë që jemi martuar, por dasmë s'bëmë e as celebrim. Sot e bëmë kështu shpejt e shpejt.

— Aa, keq kështu — buzëqeshi burri për të parën herë. Ai i ndjeu shikimet e tyre që e qëlluan si katër tyta. — Mos ma merrni për keq këtë që ju thashë. Po unë s'jam dakord me ju... duhen gëzuar prindët... — tha dhe thithi cigaren. Nikotina i dogji grykën se ishte esëll. Poshtë rridhte lumi nën urë. Tej xhadesë një brigadë po i drejtohej arave, tarracave. Dielli sapo zuri majat dhe ndezi horizontin.

— More xhaxho — tha djali i menduar. — Ne dashurohemë ka një vit. Po prindët e mi dhe të kësaj nuk u morën vesh me njëri-tjetrin. Kurse gruaja do të bëhet nënë pas ca muajsh. Kështu që e mora sonte. Formalitetet i bëjmë më vonë... Do të jetojmë në minierë. Atje punoj unë. Edhe për gruan ka punë sa të duash. Pra, xhaxho, sot është dita zyrtare e martesës sonë. Fill e në gjendjen civile do të shkojmë — tha djali dhe u kollit.

Burri shikoi vajzën. Ajo vështronte rrugën nga do të shkonin matanë urës. Burri i hodhi një sy, por nuk kuptoi gjë në ishte shtatzënë me të vërtetë vajza. «Sidoqoftë kjo është punë e mbaruar», mendoi burri. «Këta e duan njëri-tjetrin dhe së shpejti do të kenë fëmijë».

— Mirë e kini, more bij, mirë... — burri psherëtiu dhe ju duk sikur nxori nga gjoksi erën e keqe të natës. Ai shikoi përsëri vajzën që fliste. E shikoi në sy. Ajo edhe sytë i kishte të bukur, dy sy të qetë, të embël. «Këta e kanë perëndinë me vete», mendoi. «S'ka perëndi në këtë botë. Ka vetëm luftë dhe dashuri. Dashuri dhe luftë. Mirë e kanë, ta gëzojnë njëri-tjetrin».

«Mirë e kini, more bij, mirë», përsëriti me vete burri duke shikuar vajzën. Ai thithi cigaren dhe mendoi t'u kallëzonte të vërtetën e tij. T'u kallëzonte se nata e kaluar e kishte zënë në këtë vend dhe qe ndalur e kishte mbetur aty te ai kepi ku e kishin gjetur të rinxjtë. Kishte ndenjur karshi shkëmbit kobzi të teqesë. Kishte ndenjur se aty i kishin vrarë dashurinë, Gjeraqinën. Se ajo Gjeraqina, që kishte parë vajza para ca vjetësh, kishte qenë dashuria e tij. Dhe kishte ndenjur që dita ta zinte aty rrëzë shkëmbit të asaj. T'u kallëzonte se edhe vetë e dashuroi me shpirt të shoqen, pa çka se atëherë sillej pak ashpër me të; pa çka se e shpuri vetë dashin e zi në teqe si kurban pér fëmijën që do i vinte; pa çka se e pruri vetë me duart e tij Gjeraqinën në këtë varr. «Ah, jo! S'më bën zemra t'ja kallëzoj kujt dashurinë time», mendoi.

Ai hoqi në zemër dhe shfryu thellë, ashtu si bën njeriu kur ka një gur stërmundues mbi gjoks.

— Xhaxho, ç'ke? — e pyeti djali.

Burri e shikoi. Sytë e djalit ishin të kaltër si mëngjezi që po zbriste mbi lumë.

— Më dhemb këtu... — tha dhe vuri dorën mbi gjoks.

— Të të ndihmojmë, xhaxho?

— Ah, jo. Kalon. Do të kalojë — tha dhe hesh-ti. Ai ndjeu se këtë natë kishte provuar një dhimbje të madhe në shpirt. Ishte si i dërrmuar nga ajo dhimbje. «Duhet të eci shumë deri në shtëpi», mendoi. «Duhet ta marr me vrull rrugën, ndoshta më bën më mirë. Kështu do të bëj. Do t'i bie nga gryka, do të dal në stane, pastaj do të varem poshtë, ndosh-ta lehtësohem.

Djali luante me guriçka. Vajza kishte këputur një luleshqerrkë dhe e sillte mes gishtërinjsh.

— Ngrihem? — pyeti djali.

— Ngrihem — tha vajza.

— Po, bij — tha burri dhe u ngrit i pari.

Rrëzë shkëmbit të madh, që varej nga kodra deri poshtë mbi lumë, ende nuk kishte rënë dielli. Të tre udhëtarët zbritën poshtë pyllit me lisa të njomë. Kaluan mbi urë dhe dolën në xhade. Ajri i freskët i mëngjezit u binte mbi fytyrë të treve. «Pranvera e vakët në këto ditë të hyn në shpirt dhe të ndërron gjakun», tha me vete burri.

— Ju do të shkonit xhadesë, përpara? — i pyeti ai.

— Po — thanë ata të dy me një gojë.

— Epo, udhë të mbarë, more bij! E paski një copë udhë për të bërë deri në minierë. Kurse unë deri këtu e pata. Po ja mbath këtej të dal matanë grykës. Këtej e di udhën...

Ai qëndroi një çast dhe pa dy të rinjtë që eçnin përpara në xhadënë e gjerë. «Mirë e kini ju, more bij, mirë. Unë e katranosa vetë me duart e mia në atë teqe të mallëkuar... Vonë, sa para bën...», tha i menduar e me zë sikur i fliste një tjetri dhe u nis përpjetë rrugës këmbësore për t'i dalë matanë grykës ku mali ulej.

## BUZË PRANVERËS

*...atje sipër është një lis,  
ai lis i ka rrënjet t<sup>z</sup> thella.*

### I

#### Një natë

Atë natë dhjetori bëhej pushkë deri brenda në fshat. Plaku Rrahman Gjakovara i grumbulloi gratë dhe fëmijët në odën e zjarrit. Në asnjë çast ai nuk e hoqi martinën nga krahu dhe kjo gjë e fuste luf-tën dhe tërsëllimën e suferinës brenda saherë që ai hynte. Herë-herë, me shkak e pa shkak, ai dilte nga oda dhe humbiste mes errësirës së oborrit e kthehej i mërdhishur në odën e ngrohtë.

Kulla hijerëndë heshtte. Ajo s'pyeste as nga të ftohtët as nga krismat që po vazhdonin diku në qafë. Në odë kishte shumë heshtje. Plaka dhe nusja vështronin martinën e Rrahman Gjakovarës tek humbiste mes errësirës së oborrit dhe tek fuste kokën përsëri në odë. Po nuk flisnin. Ato prisnin t'u

thoshte ndonjë gjë plaku. As foshnjen s'po e zinte gjumi. Gratë kishin zënë frengjité me batanije e leckurina që drita e kandilit mos të dallohej nga jashtë.

Plaku Rrahman, tek hapte derën e odës, dukej sikur futej brenda tok me shprazje bataresh, që sa vinin e dëgjoheshin më pak. Kur hynte ai, plaka dhe nusja e shikonin me kurrestje dhe frikë. Nuk ishte shaka por luftë. Ato kishin parë paşdite egër-sinë e gjermanëve. Dhe ja, në mbrëmje partizanët ishin hedhur në sulm. Thirrjet «para partizanë!» largoheshin dhe shkriheshin me oshëtimën e suferinës.

— Pushka e kaloi kufirin — tha plaku. — Për hajr!

Ai u afrua pranë vatrës, por pushkën nuk e vari në gozhdë. E hoqi nga krahu dhe e mbështeti në qoshen pranë oxhakut. Mbushi llullën dhe shikoi nusen. Ajo, siç ishte e hutuar pas foshnjës, u kujtua dhe u rrëmbye të merrte një zjarr nga prushi si gjithnjë, por plaku e mori vetë. Ai do që nusja të jetë nuse në çdo çast. «Punë shumë, se po bëhet luftë. Edhe lufta pér njerëzit është. Njerëzit e bëjnë», mendoi plaku. «Mos u shqetëso, moj nuse. Unë kam birin, ti burrin. Po sa bij e sa burra janë sonte matanë. Ti nuk e ke provuar, moj bijë. Peshë e rëndë është lufta, por mësoshesh, mësoshesh, moj bijë.»

Plaka rri më këmbë pranë frengjisë dhe plaku e di përsë përgjon veshi i saj. Gjithë qenja e saj është përqëndruar në ato shprazje të largëta, poshtë brinjës së malit, matanë kufirit. Ajo e ka mendjen tek i biri, Avniu. Ato thirrje, që tash shumë pak i dëgjon plaku **Rrahman**, asaj ja kap weshi. Në

fillim ajo i dallonte edhe nga zëri dhe, sipas mendimit të saj, një zë i fortë, i çiltër, që sillte thëllimi deri tek ajo, do të ishte i të birit. Ajo e dëgjonte ende atë «para partizanë!» tek largohej matanë. Pastaj ajo kapte veç «para...». Thëllimi nuk e lejonte ta dëgjonte vazhdimin. Bataretë ishin të ashpra dhe të dendura, por mezi dëgjoheshin. Plaka dëshironte të hapte dritaren, por plaku nuk e linte. Ajo e di dhe shpesh u thotë të tjerëve për plakun: «Baca e ka shpirtin të mirë, por është pak i ashpër, i vrazhdë. Nganjëherë don t'i shkojë veç e tija. Kush nuk ja njeh huqet mirë atij, për kurrgjë pri-shesh me të. Por zemrën e ka të mirë». Prandaj ajo nuk e prek dritaren. Ajo kthehet dhe shikon bacën.

Por plaku nuk është aq i qetë sa duket. Ai thith llullën duke shikuar plakën dhe këmbejnë dialogje të heshtura për punë të frengjisë së myllur me bataniqe e leckurina. Veshi i tij përgjon dhe është shumë i vëmendshëm.

— Loçka e nanës! S'po ja ndigjoj ma zanin, — flet ajo për të birin. — U largue lufta. Po zbret në qytet matanë...

Ajo duket sikur i lutet plakut që ta lejojë tashmë t'i heqë leckurinat e të hapë frengjitë. Nusja prishet në fytyrë dhe lëviz me nervozizëm tek mëkon foshnjën. Ajo s'mund të qëndrojë në një vend. «Po ti, moj bijë, nuk e kupton se as unë nuk mund të qëndroj në nji vend, veç çfarë me ba», mendon plaku. «Do të kisha shkue matanë poshtë brinjës tok me ata. Këtë e kam andërrue të tanë jetën, moj bij. Atje matanë në atë qytet, ku po zbret lufta, im atë i ka pasë trojet dikur. Atje luftoi dikur e

57636

mbet. Kurse unë erdha këtu dhe mbarta mbi shpinë andrrën për t'u kthyesh nji ditë atje poshtë brinjës.

Ma donte zemra të shkoja tok me tem bir në atë qytet që e lashë dikur. Por s'qe e thanë. «Do të rish këtu», më tha ai komisari. «Rri këtu e interesojt përfshatin. Populli të zgjodhi në këshillin nacionalçlirimtar». Po, moj bijë. Kështu më tha komisari. Prandaj qëndrova. Po i qetë nuk jam, mos të të rrejë mendja...»

Plaku thith duhan duke shikuar flakën dhe duke shkrirë duart e ngrira nga thëllimi. «Interesoju përfshatin...» — i tha komisari. Ai labi i ri syshqiponjë i tha shumë gjëra bacës Rrahman. Por baca u plak njeri i pashkollë dhe të gjitha nuk i mban mend.

«Ti, moj bijë, nuk e kuption se unë nuk kisha qëndrue sonte këtu me ju», mendon plaku. «Po komisari jep urdhna si parti. E fjala e tij s'do ba dy. Në luftë fjala s'bahet dy, se e merr lumi punën krejt. Eh, moj bijë, si më ka rrähëjeta mue. Unë të kuptoj mirë ty. Ti do të shkoje pas Avniut tok me ato partizanet e reja. Do të shkoje, moj bijë. Do të zbritje atje dhe unë do t'ju shikoja të kërcenit valle në sheshin para dyqaneve të atij qyteti matanë. Do t'ju shikoja të dy me yje partizane mbi kapa, moj bijë. Le të vinin gjindja e tanë qytetit e të pyetnin, se u kallëzonte baca. Do më bahej zemra mal. Por me atë foshnje në gji, ti, mos lëviz, moj nuse. Mos u shqetëso. Mëkoje ferishten...»

— Po ndjehet rënkim në rrugë, baca Man! — nusja foli shpejt dhe u mundua ta fshihte parandjenë e keqe. Lokja shtangu. Ajo u vrejt dhe tiparet i morën një bukuri të egër. E papritura mund të vijë. Bota është mbushur plot me të papritura. Ato

e kanë mendjen veg tek Avniu. Këtë e ndjen edhe plaku. Edhe atij për djalin i rreh zemra. Ai afrohet i qetë pranë lokes dhe e ndjen rënkimin. Rënkim po i afrohet kullës. Ai po afrohet. I biri ose kushdo qoftë — njësoj. «Njisoj», mendon plaku. «Njisoj asht. Njisoj, bijt e mi. Qëndro, moj zemër! Gajret! Në luftë nuk shkohet për lojë.»

Plaku e kupton nga zërat e tyre se ata do të jenë dy-tre vetë, jo më shumë. Ai e mund veten, e përmban dhe u drejtosh grave i qetë:

— Rënkon nji nga bijt tanë... Epo luftë për Shqypni, s'ke ç'i ban. Nuk shkuen cuba për hajni... Me hajr daltë...

Lokja nuk lëviz. Ajo ka qëndruar pranë fren-gjisë. E egër dhe krenare, pak e zbetë, por e fortë, ajo diç mendon në të vetën dhe nuk flet. Thinjat i vezullojnë ndër tamtha. Drita e kandilit derdhet mbi ta e jep rrezatime shkëlqimtare. Ndjehet lesa e oborrit. Rënki mi po hyn në kullë. Hapi derën, bacë! «Eh, sa e fortë asht zemra e njeriut, sa e fortë!» — mendon plaku. Ai çan me martinën në sup dhe i del natës para. Dy vetë sjellin një të plagosur.

— Bacë, na shtro shpejt! — zëri i të birit e gjeti derën hapur.

— Çfarë bani vaki, more bir?

Plaku është ndalur aty te shkallët e kullës.

— Komisari, bacë...

Avniu nuk flet më. Ai hyn në odën e zjarrit. Ai e di që baca i ka grumbulluar njerëzit atje. E di se nata e dhjetorit kalohet më lehtë aty. «Për komisarin aty është më mirë. Për fëmijën dhe gratë kollaj», mendon baca. «Punë që rregullohet ajo.»

Ai kapërcen prakun me trupin e komisarit mbi shpinë. Automatiku i varet mbi gjoks. Nuk e shikon fare loken e ngrirë në mes të odës, as të shoqen me foshnjen e përgjumur në sisë. Jo, por shkon te qoshja dhe ulet me ngadalë e me shumë kujdes, lëshon trupin e komisarit të ri aty te shtresat.

— Shpejt shtroni në qoshen tjetër shtresat ma të mira. Ç'më rrini ashtu? — baca Man tani bën lëvizje të shkathëta pranë komisarit të ri. I zbërrthen menjëherë pallton ushtarake dhe e largon me kujdes këmishën. Vetëm një plumb ka kaluar në sisën e djathhtë... vetëm, por...

Baca shpejton duart. Fasha e madhe, nxjerrë nga këmisha e të birit, bërë shuk mbi plagë, éshtë llangosur me gjak.

Baca mënjanon komisarin dhe shikon se plumbi, që ka hyrë në sisë, ka dalë nën sqetull e i ka prekur edhe muskulin e krahut.

— Shpejt, duhan, nuse! Lene ferishten!... — thërret ai. Komisari mposht dhimbjen me mundim. Ai nuk rënkon më. Gjeti diku forca sa t'u fliste shokëve:

— Avni, në çantë... dokumentat... Sido që të ndodhë, komisarit të brigadës... Vetëm atij, ose... e di vetë...

Avniu dhe partizani tjetër rrinë më këmbë, shtrënguar e mbërthyer armësh. Ata shikojnë në beben e syrit komisarin e tyre të fortë që mund plagën, dhimbjen, që nuk shikon fare, ç'i punon baca aty, ndërsa djersët i mbulojnë ballin.

— Bacë, amanet, bacë! Nanë! — Avniu shikon rrëth e rrëtull odës. Shikon të shoqen, foshnjen që ka prishur gjumin dhe lëviz duart sikur kërkon ta

marrë Avniu, ta përqafojë, ta shtrëngojë mes gjerdhanësh që i kryqëzohen në gjoks. Ndoshita ato «lojra të bukura» e tërheqin foshnjën tek buzëqesh e lëviz doçkat. Po Avniu nuk ka kohë. Minuta s'pret. Shokët sonte po zënë Gjakovën, armiku duhet shfarosur.

— Vdekje fashizmit! — nderojnë dy partizanët dhe kështu u përshëndetën me të gjithë njëherësh. Tek shikojnë komisarin, partizanit të ri i ndrit një lot në cep të syrit. Ai nuk mund të ndahet nga komisari. Ç'dashuri kanë këta njerëz për njëri-tjetrin. Eh, bijt e bacës! Baca Rrahmani i mendon këto, ndërsa ka pastruar plagën dhe era e rakisë së përzier me duhan mbi plagët kanë mbushur odën e vogël.

— Liri popullit! — përgjigjet me mundim komisari.

— Liria e popullit, bij! — plotëson baca. — Thuaju shokëve, bir, se komisari shpëtoi. Pas dhetë pesëmbëdhëtë ditësh do të jetë me ju...

Partizani i ri i afrohet dhe e përqafon bacën, e puth si atin e vet.

— Të falem nderit, xhaxha!

Ata dalin të dy. Nëna i përcjell deri te lesa, ata fluturojnë nën qiellin plot yje, poshtë brinjës për në Gjakovë, prej nga zëri i luftës i vjen si i mbytur. Ajo rri ca aty te lesa dhe dëgjon hapat e të birit tek vrapijnë në rrafsh të kodrës. Pastaj asgjë, veç zërit të luftës ku po shkon i biri. Qielli ishte plot yje.

Lokja futet brenda, baca urdhëron.

— Ndizni zjarrin në odën sipër, vini fëmijën atje! I sëmuni do qetësi. Këtu shtronit sa më trashë! Sillmë lëkurën ma të mirë e shtroje mbi sixhade

aty në qosh! Edhe dy jastëkët me lesh. Shpejt! Nuse, a ka ma miell?..

Këtu ndërpritet dialogu. Nusja hesht dhe ul sytë. Të kupton mirë fort baca, moj nuse, moj xhevahirja e bacës!

— Ani, atë miell që asht, të ruhet për shumë ditë...

Dhe baca Rrahman vendosi të shëronte komisarin. Baca vendosi të ushqente komisarin (e mielli është sosur, se me urdhër të tij është gatuar bukë i téri pér partizanët). Baca Rrahman do ta çojë komisarin në batalion pér pesëmbëdhjetë ditë. Dhe zemra e tij i do të gjitha këto. Ajo nuk kursehet. Ajo është e madhe si mali, e thellë si deti, plot dashuri. Ah, sa herë ka shëruar plagë plumbi në pulpë, në krah, në..., po jo plagët e këtij farë djali që i buzëqesh dhe nuk rënkon më, që e mund dhimbjen si një shqiponjë e plagosur. Po baca Man nuk di se ç'duar të arta ka.

Dhe baca jepet i téri pas komisarit. Çdo ditë komisari është më mirë, çdo ditë plagët vijnë duke ju mbyllur, po jo pér pesëmbëdhjetë ditë. Baca nuk e lë komisarin të lëvizë. Në odën e tij nuk lejon njeri, veç atyre të treve dhe ferishtes, kur nuk qan...

Dhe komisari bisedon, shqiponja e plagosur tregon pér betejat, komisari i flet pér Labërinë, komisari rri ndenjur, ai nisi të shkruante gati një orë me dorën e plagosur, po baca nuk e lejon më shumë. E ai i bindet bacës si një fëmijë. Zemra e bacës nuk përbahet nga gëzimi. Si shkëlqen ky syri i bacës!

— Komisar, si ta marrësh edhe pak vedin, do të zbresim tok në Gjakovë. Petritat tanë po

vazhdojnë. Kam dëshirë të shkojmë bashkë deri në Gur të Shpuem.<sup>1)</sup>

— Bace, ku është Guri i Shpuem?

— Me këte luftë kena me e gjetë, bir... — ja pret i menduar ai Rrahman Gjakovara.

Ah, komisari e la përsëri në fshat bacën Rrahman. Fluturoi ajo shqiponja labe.

E baca Man martinën nuk e vë më në gozhdë, por e mban pranë. Merr çiftelinë e të birit dhe këndon këngët e tij që nuk shkruhen vec ndër ato dy tela, se baca... s'din të shkruajë. I bie çiftelisë së të birit se aty pranë ka njerëzit, kurse i biri shkoi me atë shqiponjën labe deri në Gur të Shpuem për të çuar në vend fjalën e partisë, për të çuar në vend ato dëshirat që i djegin zemrën bacës Rrahman Gjakovara...

Ata petritat me yjet mbi ballë e çliruan Gurin e Shpuem, luftuan deri thellë në Sërbë. Zemra e plakut gandoi. Dy telat e çiftelisë së të birit u drodhën në duart e plakut duke përfthuar melodi të reja me fjalët e bacës Rrahman dhe me mendimët e komisarit. Gandoi i vogli në djep duke vërejtur gjëzimin që u derdh në shtëpi si kurrë. Çlirimtarët u kthyen nga Guri i Shpuem. Erdhën petritat e bacës, erdhën, por... Ai Avniu i bacës Man mbeti diku andej nga Guri i Shpuem. Mbeti çlirimtarë, mbeti t'u tregonte shqotave rrugën gjatë shekujve.

Po i duhet qëndresë, durim bacës Man. S'e jep veten baca. Duhet të jetë krenar për të birev. Nuk vajtohet petriti me yll në ballë. Dhe baca nuk lejon gjëmë.

---

1) Gur i Shpuem: Sipas shprehjes popullore, toponim që shpreh pikën më të largët, banuar prej shqiptarësh.

Por ama çiftelia e të birit mbeti varur. S'këndoi më çiftelia, jo. Jo, veç atë nuk e preku baca. Do ta lërë me ato tela që shkeli gishti i të birit.

## II

### Kaluan vite...

Rrahman Gjakovara hyri në mbrëmjen jubilare qetë-qetë, me vetulla të ngrysura dhe me qeleshen e bardhë. I nipi i tregoi tryezën bosh dhe ai u ul. Disa vajza të reja u ngritën e i dhanë dorën. Ato e priten tërë zhurmë. Po ai u jepte bisedë sa për t'u bërë qejfin. Se baca nuk ishte në qejf. Ai nuk e ndjente veten mirë dhe po mundohej të kujtonte se çfarë e kishte mërzitur gjatë pasdites që nuk ishte mirë. Kjo ishte një darkë festë, ku i nipi e solli se kishte gjithë shokët e punës. Po plakun diç e shqetësonte. Diçka mendoi që e dëshpëroi e tani s'po kujtohej.

Dikush e përshëndeti mbrëmjen me një fjalim. Plaku nuk i mori vesh ato që u thanë, por e kuptoi se flitej për sukseset e spitalit. Ai shikoi të nipin që po dëgjonte i menduar.

«U rrit ferishtja e Avnisë. U ba mjek ky Azemi. Nuk qëlloi të bahej trim si ai Azem Galica...», mendoi plaku. Salla duartrokiti, gotat kërcitën. Pastaj nga këndi filloi muzika e sazexhinjve dhe Azemi u ngrit të kërcente. Edhe vajzat kërcenin. Gjithë salsa merrte pjesë në kërcim. Tek-tuk nëpër tryzea kishin mbetur qejflinjtë e rakisë. «Qejfe-qejfe është

dynjaja, të tana nuk janë njisoj», mendoi plaku. «Po unë ç'djallin kam sonte?» — pyeti veten ai. «Ky Azemi, si thonë, operon fort mirë këtu në spital. Operon çdo lloj plage, por ama dorën nuk moshan. Me këtë dorë shërova komisarin...», plaku shikoi dorën e tij të rreshkur e të nxirë, tërë damarë mavi dhe u ngrys më shumë. Ai kujtoi ardhjet e komisarit pas çlirimt në kullën e tij. Por ardhjet ishin rralluar vitet e fundit. Kurse baca e ndjente se u plak shumë dhe vetë s'mund ta merrte rrugën për te komisari. Në mes atyre ardhjeve të komisarit në kullë, kishte ardhur edhe një letër prej tij. Ishte një letër e shkurtër. Ajo kishte ardhur në shtëpi në dimër. Atëherë kishte nisur të festohej Viti i ri. Plaku nuk po e kujtonte mirë punën. Atij i dukej se po i ngatërronte pak gjërat. Mund që po humbte edhe kujtesën. Rrezik që ta shikonte komisarin dhe mos ta njihte fare. Kjo gjë po i ndodhë shpesh me njerëzit. Kohët e fundit nuk kishte asnjë lajm përtë. Ku do të ishte tani komisari? Vriste mendjen plaku. Ai e ndjente se kishte nevojë ta shikonte dhe një herë komisarin. Kishte diçka të përbashkët komisari me të birin... Kishte. Ishte syshqiponjë ai, si i biri. Duhej të shkonte vetë në Tiranë. Ndoshta do të takonte me të. Duhej të shkonte atje, pa të bëhej ç'të bëhej. Një herë po e bënte këtë Rrahman Gjakovara, dy herë jo...

Tani plaku e kuptoi se kjo ishte arësyjeja që e cingriste në tru e nuk e linte të qetë. I ishte mbushur mendja të shkonte një herë vetë asaj Tirane. Po ky Azem doktori nuk lëviz prej të sëmurëve. Ky nuk po e gjen kohën asnjëherë ta çojë bacën në Tiranë. E baca i tij i mbushi tetëdhjetë e dy vjetët, treqind s'do të jetojë. Tashmë baca mezi

ulet deri këtu në qytetin e vogël një herë në vit.  
«U plake, Rrahman Gjakovara, u plake!» — mendoi ai.

Ishte në këto mendime, kur i nipi ju afrua me një vajzë. Fytyra e saj ishte skuqur si shegë. Vajza përshtendetet me bacën, dicë i thotë. E plaku i kuption nga sytë dy të rinjtë. Ai e kuption se ata duhen. Sytë u shkëlqejnë. Por baca ka hallet e shqetësimet e veta. «Mirë boll po i bajnë këta nipat këto punë», mendon plaku në të vetën. Vajza largohet, baca e pyet Azemin:

— A merr leje ndonjëherë ti, o bir?

— Ç'leje, bacë?

— Si gjithë njerëzit. A din me pushue ndonjëherë, apo... si mushka?

— Ma kanë dhënë. Vetë e kam shtyrë... Pse?

— Pa, desha me zbritë deri në Tiranë... Thashë mos takojmë ndonji të njobun andej... — plaku ngrysni vetullat e bardha dhe thithi llullën.

— Bacë, lart mos shko. Për dy-tri ditë nisemi për në Tiranë.

Plaku ngre gotën, ndërsa vetullat e bardha i zbresin mbi sy. Atje thellë në sytë e tij shkëlqen një shkëndijë.

— Bafsh hajr, bir! Bafsh hajr! — i thotë.

...dhe baca Rrahman e pa Tiranën plot drithë. Ajo ishte e madhe, shumë e madhe. Në mes të gjindjes që derdhej si lumë, baca e ndjeu veten të vogël, fare të vogël.

Një pasdreke Azemi s'ja prish gjumin dhe ulet prej hotelit për të pirë kafen diku. Por pas pak ulet edhe plaku e del. «E bukur asht Tirana! Nuk ka qytet ma të bukur nën diell!» — mendon plaku dhe i rreh zemra në atë që ndjen. Ja, ai po i për-

shkon rrugët qosh më qosh si zot. Kurrë nuk e ka ndjerë veten kështu mes njerëzish. Të gjithë i hapin rrugën. Dikush do ta ndihmojë, kur ai gati pengohet. Dikush e pyet mos është sémurë, kur është ulur në një cep trotuari. Po baca ngrihet dhe ecën ~~nëpër Tirane, Shikon, shikon. E sa do tu kallezoje njerëzve pér Tiranën!~~

Bie nata. Po Tirana s'ka natë. Yje, yje, yjet! «Gjithëjeta këtu është mbushur yje!» — Mendon baca. Sa larg është fshati i tij atje pas malesh shpi-népërhimët. Baca ndjen mu në zemër këngë çiftelie pér këto yje...

Ka harruar hotelin. S'din as si ta kérkojë, por pa ngrënë nuk mbetet. Ai ka pare dhe dyqanet janë plot. Po vajti vonë. Si nuk ja di emrin atij hotelit?! Pyet njërin, por nuk di ta ndihmojë. E çon në dy hotele të tjera.

— Ah, jo, jo këtu... — i thotë baca me mirënjohje burrit që interesohet pér të. Së fundi zen një vend në një hotel tjetër. Por si ta gjejë nipin? Ai me siguri e kérkon nëpër Tiranë. «Këtu humb, Tirana asht e madhe», mendon baca. Të jetë puna pér malësinë, baca di me pëllëmbë çdo shtëpi, çdo shpellë, çdo brinjë ku shkeli Shota me atë Azem Galicën. Po Tiranën...

(Shumë vonë, kur baca ka fjetur, doktor Azem Gjakovara, pasi ka kontrolluar tërë hotelet e Tiranës, e gjen. Lë porosi te sportelisti që plakun ta mbajë aty, se do të vinte ta merrte vetë të nesërmen, më gjashtë të mëngjezit. I lë edhe adresën e hotelit të vet dhe ikën.)

Të nesërmen është ngritur në kohë fshati baca Rrahman. Nuk është nga ata dembelët që i zë dielli te krevati. Nuk është si ai sportelisti që u fut në

krevat sa u hapi derën e hotelit atyre që shkonin te treni... Është pak i mërzitur për të nipin, por sot do ta gjejë pa tjetër dhe do të kryejë ndonjë punë.

Ecën baca trotuarit duke trokitur shkopin për qejf. Mëngjezi tiranas është i bukur. Sa shpejt që ecin njerëzit! Si vrapojnë për në punë! «Ecni, ecni, ju pastë baca!» — mendon. Po është pak i mërzitur për të nipin. Ai nipi nuk u duk fare. E si ka fjetur ai pa bacën? Qytetarin e parë që ndesh, e pyet, por jo për hotelin. Për Komitetin Qendror të Partisë. Atje punuaka komisari. Parmbrëmë i tha i nipi. Po, po bash aty. I madh, a i vogël, kjo s'ka rëndësi, por ai atje punon. Qytetari i njerëzishëm e shikon me vëmendje bacën dhe i tregon pallatin pranë lulishtes. U, po këtu ka kaluar baca edhe mbrëmë. Si nuk e ka ditur që ky është Komiteti Qendror!? Sa shumë njerëz që hyjnë aty! Bacës nuk i gjasojnë ata as me ministra as me gjeneralë. Afrohet baca, mos kushedi, shikon komisarin dhe e njeh vetë. Mund të shikojë edhe ndonjë të krahinës. Ai mendon se të gjithë ata që vijnë me shërbim nga krahina, këtu kanë punë. Mund t'i zërë syri pa tjetër ndonjë të njohur.

Ulet dhe pret aty te parmakut i lulishtes. Orët kalojnë. Njerëzit hyjnë e dalin. Ata bisedojnë të qetë. Shumica ecin shpejt. Syri i bacës i shikon të gjitha prej parmakut të lulishtes aty pranë hyrjes. Kaloi mesdita. Baca thith llullën. E shkund atë mbi shkop dhe e mbush përsëri. Ja tash po dalin krejt. Në mëngjez ai ka ardhur vonë me siguri, kurse tanë... Pa tjetër, tanë do t'i shikojë me vëmendje. Do t'i shikojë dhe, po të jetë, do ta njohë menjëherë atë... Komisari sigurisht ka ndryshuar shumë në

këta vjet, por baca do ta njohë nga sytë. I ka të mprehtë, syshqiponjë si i biri... Kot s'e pat thirrë «shqiponjë» atëherë ...«Ah, veç të jetë këtu!» — mendon plaku.

Rregullon qeleshen dhe shkopin mes këmbësh që mos ta pengojë. Pret me padurim duke shikuar njerëzit, veturat. «Shumë njerëz paskan qenë këtu», mendon. Një grumbull dhjetë-dymbëdhjetë vetash dalin të fundit. Tani këtu te parmakët është vetëm ai dhe përballë ka vetëm ata. I shikon baca me vëmendje njërin pas tjetrit. Por edhe atyre nuk u shpëton prej syrit. Njëri ndahet nga ata. I hollë, i gjatë, i mprehtë, syshqiponjë, buzëgaz — tamëm si i biri! I afrohet bacës. Po, po, te baca Rrahman. Lëviz plaku prej vendit. Shqetësohet. Këtë nuk e njeh. Burri qëndron aty para tij dhe nuk flet por e vëren. Zbërthen xhaketën, këmishën dhe i tregon gjoksin e zhbiruem.

— Bacë! A je, Rrahman Gjakovara? — burri e përqafon, e puth plakun.

Baca është shqetësuar. Atij sikur i humbën fjalët. Ai mendon se është plakur fare. Kujtesa e ka lënë krejt. «Eh, komisar, komisar! Sa shumë paske ndryshue në këta vjet! Sa shumë të paskan mbulue thinjat në këta vjet! Kaq punën e paske pasë në këta vjet?» — plaku i mendon këto dhe nuk i shpreh dot.

Ai grumbulli i vogël që ishte te shkallinat pak më parë, vjen fill aty. Kujt t'i përgjigjet baca më parë? C't'u thotë?

— Më ka hupë cuni i Avnisë, bre komisar... Ishim në hotel. Unë hupa, desha të them... S'e gjeta dot. A po më ndihmon?

Grumbulli i shokëve të komisarit qeshet dhe të

gjithë janë aq të dashur, sa plaku hutohet. Komisari, si e mori vesh punën e bacës dhe të nipit, i jep një copë pusullë shoferit të njërës nga veturat dhe e nis me gjithë maqinë.

— Bacë, doktor Azemin na e sjell shoferi me maqinë. Eja të shkojmë në shtëpi...

— Po unë kujtova se je ministër a gjeneral, mor bir... Si je thinjë e dobësue kështu? — e pyet Rrahman Gjakovara. Burrat qeshin tok me bacën Rrahman Gjakovara.

## Z G J I M I

Ishte mbrëmje e vonët. Unë vazhdoja të lexoja, kërrusur mbi tryezë. Dera trokiti lehtë ashtu siç trokasin fëmijët e lagjes, kur vijnë të drojtur për të marrë ndonjë libër në dhomën time. Por ishte vonë, shumë vonë. **Kurse e trokitura u përsërit.** Ajo ishte e lehtë, e drojtur, si prej fëmije. Lashë librin dhe u ngrita. Hodha sytë nga dritarja dhe pashë se rrallë, tek-tuk kishte mbetur ende nëpër lagje ndonjë dhomë me dritë. U bëra kurioz se në këtë orë zakonisht nuk më shqetësonte kush. Hapa derën. Përpara meje qëndronte Sadriu, një punëtor që e njihja. Ai na humbi nga sytë për tre vjet me radhë, se punoi e jetoi në një qytet tjetër.

Ndër duar kishte dy valixhe dhe një rrjetë, mbushur me tesha. U përshëndetëm dhe e futa në dhomë.

— Nga kështu? — e pyeta.

— Mos e pyet — qeshi ai. — Rreth e rrotull...

— Për vizitë kështu?

— Jo. Më mirë të them se te ti erdha për vizitë, kurse...

- Çfarë, po kthehes?
- Pikë.
- Çfarë do të katranosësh tani me të?

— Hiç — tha dhe u ul më mirë në karrige. Vuri buzën më gaz dhe thithi duhan sa e zuri kolla. — Erdha vetëm për një këshillë... Si të ta them për një mendim... Unë i fëlliqa punët me atë tjetrën andej. Iku me një tjetër ajo lavire... E zura vetë dhe i vura drunë. Prandaj edhe u ktheva. Thashë, mos...

Sadriu u mendua dhe sikur u ngatërrua në mendimin e tij, sikur nuk donte ta hapte shkoqur fjalën.

— Si thua, të shkoj përsëri te Marta?... Është si thua?... A më pranon Marta? — ai m'i nguli syftë. Në sy i lodronin hijet. Ata herë qetësoheshin, qartësoheshin e zbuteshin, herë mjegulloheshin, veniteshin dhe në ta vallëzonin e lodronin hijet. E kishte me gjithë mend. Duhej t'i jepja një këshillë, një mendim. Gjëja më e lehtë në botë është të japësh një këshillë, sidomos kur nuk mendon fare dhe këshilla del vetvetiu ashtu lehtë-lehtë, meqë ajo ka të bëjë veç me të tjerët.

— Provoje njëherë — i thashë. — Ndoshta edhe të pranon...

Ai u ngrit. Më thà t'i ruaja valixhet dhe u nis tek e shoqja. E pashë se ishte i emocionuar, sepse qeshi dhe tha diçka me vete që unë nuk e mora vesh.

— Po nuk e rregulllova punën me të, këtu më ke disa net — tha dhe tërhoqi derën pas.

\* \* \*

## Martina

Martina u kthye vonë nga shkolla e natës. I biri e priste te dritarja. Pas pak në shtëpi i erdhë shoferi i autobotit dhe i tha se i shoqi u kthye. E kishte parë vetë në stacionin e Laçit dhe kishte zbritur pak pa hyrë në qytet. Kaq. Pastaj ai iku. Kurse Martina ngriu në vend. I biri, që e dëgjoi në heshtje atë bisedë, e mbyti me pyetje. Po Martina nuk e dëgjoi fare. Shikoi në errësirë tek zhdukej silueta e shoferit të autobotit. Pas pak ajo u kthye nga i biri. I dha darkë dhe e përkëdheli. Vazhdoi përrallën e Kësulëkuqes, por në fund përrallën e ndryshoi. Kësulëkuqja nuk gaboi. Fundi ishte më i gjëzuar.

— Kështu më pëlqen, mami... — thotë i biri nëpër gjumë, ndërsa Martina është e këputur dhe s'ka fuqi të tregojë më mbi Kësulëkuqen. Ai mund t'i vijë nga çasti në çast... E çfarë s'ndodh me një-rezit?

I biri fjeti, por Martina s'fjeti. Ajo treti diku larg, në atë natën e plazhit...

«...grua e mirë është ajo që di të heshtë. Hesh-tja është flori» — i thoshte ai me zë të marrur e të mërzitur në atë mbrëmje plazhi. Sa herë e kishte dëgjuar ajo atë mendim prej tij. Sa herë ja kishte përsëritur edhe e éma. I dukej Martinës se gjithë jetën ky mendim e kishte përkundur e nanurisur që në djep. Ky mendim i kishte hedhur shtat, ky mendim i zi si korb i qëndronte pezull mbi kokë si një copë qiell i vrenjtur mbi èndrrat e saj, mbi shtratin bashkëshortor...

E pse t'ja përsëriste i shoqi? A kaq budallaqe e kujton ai? — mendonte ajo. I vinte të pëlciste, por nuk donte ta zeméronte më shumë të shoqin. Ai dukej si i mérzitur, si i pakënaqur prej saj. Ajo kishte ardhur këtu që nga qyteti i vogël i veriut të rrinte ndonjë natë, të gëzohej me të, jo të grindej. Kurse ai ishte i mérzitur. Dukej që nga zëri. E, sa mirë po e kuptonte Martina!

(Martina në atë lodhje e kapitje e ndërpret parafytyrimin mbi plazhin. Buzëqesh. Mbulon më mirë të birin. Por, sa e prek djalin, përpara sysh i del Ajo tjetra. Ajo...)

C'ishte ajo që kërceu me të? Po me të vërtetë, si nuk e pyeti Martina atë natë të shoqin. Ajo tjetra kërcente me të shoqin dhe qeshte. Qeshte. Martinës ju duk sikur e përbuzte ajo e qeshur. Jo, në një farë mënyre e pyeti të shoqin. E pyeti:

— Pse kërcen vetëm me atë? — e pyeti sapo i shoqi u ul pas një kërcimi.

— Ajo më pranon... Unë s'e di mirë fokstrotin...

«O zot, sa shumë ka ndryshuar ky», mendoi Martina atëherë. Ajo kishte parë si kërcenin burrat me gratë, por të shoqin po e shikonte për të parën herë. Ajo nuk kishte kërcyer kurrë as si vajzë në fshat, as si nuse e re me të shoqin. Dhe ky lloj kërcimi i dukej diçka e mirë, e këndshme, që e joshte. Po pse të kërcente ajo tjetra me të shoqin dhe jo Martina? I vinte plasje. Vetë s'dinte, kurse atë tjetren s'mund ta shikonte tek zbardhët dhëmbët në atë fytyrë thatanike. Edhe sytë i kishte të dalë jastë, ca sy të mëdhenj të dalë. Edhe qesh. Martinës nuk i rrihej më aty. Donte të shkonte në dhomë një minutë e më parë. I shoqi u kthyesh përsëri i djersitur dhe dihaste. Ishte lodhur i shoqi me atë tjetren.

Erdhi u ul, por nuk hëngri. Ajo tjetra shkoi në tryezën përballë. Ishte e gjëzuar ajo dhe qeshte. Kurse i shoqi s'po e shikonte në sy Martinën. Edhe ai sikur ishte i shqetësuar si Martina. Seç ngatërronte me pirun në pjatë, po për të ngrënë nuk hante. E gjella ishte e mirë. Kishte rigon në të ose diçka që sillte erë të mirë si kanella. Gjellët ishin të mira, por edhe Martinës nuk i hahej.

— A shkojmë? — e pyeti ai.

— Po si jo. Unë u mërzita këtu.

— Këtu unë nuk mërzitem. Është shumë bukur. Deti... kjo pistë... zhurmat... muzika... Pse mërzitesh ti?

— Nuk e di. Shkojmë? — dhe Martina u ngrit. Të dy shkuan në fjetore. Martina e pa atë të nesërmen dhe gati çdo ditë. Ajo kishte shumë fustane dhe i ndërronte tri herë në ditë: në mëngjez, në drekë dhe në mbrëmje, kur vinte në pistë, kurse Martina s'kishte veç një sa për t'i mbuluar tutat... Ajo vinte e takohej me të shoqin dhe nuk i fliste Martinës, veç e përshëndeste me kokë. E shikonte me bisht të **syrit dhe qeshët**. Qeshte njësoj si në pistë. E, kur qeshte ajo, Martina mpakej. Vlonte nga brenda, por si t'ja bënte të shoqit. Tashmë e kish marrë vesh, ata ishin në një ndërmarrje. Ishin shokë pune. Ajo punonte diku në llogari, kurse i shoqi po specializohej në një maqinë për llogari të uzinës që do të ngrihej së shpejti. Ja, kaq gjë i kishte sqaruar i shoqi.

Pastaj ai u sëmur papritur dhe ata e lanë plazhin. Martina u gjëzua se do të ktheheteshin në shtëpi e do të merrnin fund ato ditë. Do të merrte fund ai tundim që ndjente çdo mbrëmje, kur i shoqi kërcente me atë tjetren në pistë. Shyqyr që po iknin!

Por në Tiranë, i shoqi u ndal. U ndal pikërisht në çastin e fundit, kur kishin hipur në autobus. Gati në nisje. Kjo gjë e tronditi edhe më shumë Martinen. I erdhi si e papritur. Këto të papriturat po i shtoheshin nga çasti në çast. Ajo nuk e kuptonte atëherë se si mund të ndodhnin kështu gjérat. Zemra s'ja donte, por e kuptonte se gruaja nuk i zgjatte shumë llafet me burrin. E tillë ishte atëherë Martina. Prandaj qëndroi dhe heshti, kur foli ai:

— Shiko, unë do të vizitohem njëherë. Vij nga e e enjtja...

Dhe këtë ja tha mes njerëzish. E ç't'i thoshte Martina aty? Ai po rrinte. Si mund t'i fliste burrit ajo mes njerëzish, veç «mirë ardhsh», sikurse i tha? Kaq.

U kthye vetëm në shtëpi dhe e gjeti të birin te fqinja. Në shpirt kishte një pështjellim të madh që e ndrydhte. Diçka mund të ndodhë, diçka e tmerrshme që nuk i kishte ndodhur kujt. Martina u mbyll në vetëvete. Ajo e priti të shoqin një javë, dy. Pastaj nuk vonoi ajo gjë e tmerrshme. Ajo e ndjeu fërfërimën e krahut të zi. I fërfëriu te veshi sapo lexoi telegramin. Ishte një telegram me ca fjalë të çuditshme, të pabesueshme. «Mos më prit. Martohem. Sadriu.»

Në fillim nuk i besohej. Të martohej i shoqi? Babai i fëmijës tre vjeç të fluturonte nga çerdhja pas një tjetre që dansonte fokstrot? Jo. Nuk ishte e vërtetë. Nuk ishte e mundur. Kjo nuk kishte bërë vaki as në fshat as këtu në qytetin e vogël të veriut. Jo. Kush e dinte si qëndronte puna. Sadriu do të kthehej dhe gjithshka do të sqarohej. Mund të ishte ndonjë lojë ose ndonjë gabim në këtë mes. Martina kishte dëgjuar se dikush diku kishte bërë një tele-

gram të rremë vdekjeje pér të provuar dashurinë... Ku ta dinte Martina, e çfarë s'ndodh në këtë botë? Mund të kthehej i shoqi...

Po ai nuk u kthye. Të gjithë ata që e njihnin dhe që vinin nga Durrësi, i thoshin se i shoqi ishte martuar me atë tjetrën që i kishte sytë të dalë jash-të. Bile, si i kishin thënë, priste edhe fëmijë me të. Punë e ngatërruar. Ishte bërë lëmsh...

Dhe Martina vendosi t'i vinte zemrës një gur. Martina gjeti forca të duronte dhembjen. Vendosi të mos mposhtej nga turpi para botës. Ajo u dha e gjitha pas të birit. Ndoshta pér këtë s'duhej fort heroizëm. Por, që ta mposhte ndjenjën që e ndrydhet, që ta zhdukte atë hijen e opinionit në lagje imbi arësyen e ndarjes, nuk qe e lehtë. Jo, ajo e dinte mirë këtë. Duhej gjithë përpjekja e saj, gjithë puna dhe qëndresa e saj që bota ta kuptionin se ajo ishte grua e ndershme, serioze në jetë. Ta dinin të gjithë që ajo nuk kishte asnjë faj pse e braktisi i shoqi. Gjithë fajet, mendonte Martina atëherë, i kishte ajo tjetra e fokstrotit dhe i shoqi.

Koha bëri të vetën, kurse ai s'u pa më në qytetin e vogël të veriut. I biri hyri në klasën e parë, kurse ai ja tek u kujtua të kthehej. Ai po kthehej, po Martina e di si i kaloi këta vjet... Në fillim ajo qëndroi e s'u dha, nuk e lëshoi veten që ta mëshironte kush. Vazhdoi të punonte në ndërtim, në repartin e parafabrikateve. Vërtet që atëherë i vinte vdekje nga shoqet e saj të punës. I dukej se ato flisnin pér të saherë që i gjente në bisedë e sipër. Ato e shikonin njësoj. Te secila vërente të njëjtin sy kureshtar e mospërfillës që i thoshte: «Fj, ti, vejushë, si u katandise. Të dukej vetja më e re, më e pashme... S'të la kot yt shoq...» — Këto men-

donte Martina në fillim, por këto nuk ja tha asnjëra nga shoqet. Asnjëherë. Edhe kur e pyeti njëherë përgjegjësja e repartit, e pyeti si njeriu që të do të mirën. Martina ja tregoi fill e pér pé një pér një, por qau. I rrohdhën lotët duke treguar se shpesh kujtonte të birin në ato çaste. Qau dhe i erdhi inat që u tregua e dobët. Lotët, si e gjykonte ajo, shpreh-nin dobësi. I dukej se po e ndjente veten fajtore. Kurse s'kishte faj ajo, pse i shoqi u verbua pas asaj tjetrës.

Por asnjëra nga ato nuk ja hapi fjalën e braktisjes së burrit. Asnjëra nuk i tha «oj, ti, vejushë!» Ato i harronin shpejt fjalët e ashpra të Martinës. Ajo edhe me djalin u soll ashpër. Aq ashpër, sa një ditë i biri ju ankua: «Moj mami, pse më bërtet kaq shumë? Më parë më doje...» Martina e kuptoi se duhej ta shtonte kujdesin ndaj tij. E me gjithë këto, ashpërsia ju bë natyrë e dytë asaj.

Në parafabrikate punonte sa pér dy. Pas një pune të tillë ndjehet e lodhur dhe e këputur aty mes shoqesh, por nuk e jep veten. Duke shikuar pllakat e prodhua ajo qesh nga gjëzimi dhe shoqet qeshin.

— Moj Marte, a u lodhe?

— Pak... — dhe Martina ecën mes tyre e gjëzuar.

Ato bisedojnë të gjitha përnjëherë siç e kanë zakon, bëjnë edhe shakara. Dikujt burri i ka blerë një kazan pesëdhjetë kilogramësh pér të mbushur ujë se deri në katin e katërt janë gjashtëdhjetë e katër shkallë dhe ai përton të ulet shpesh te çesma. Martina qesh me hidhërim. Ajo diç mendon... por nuk jep mendim.

Një ditë pas punës u bënë zgjedhjet e komi-

tetit profesional. Atë e zgjodhën shoqet në komitet. Nga ky çast Martina nisi të fliste gjithnjë e më shumë nëpër mbledhjet punëtore. E pra Martina është e ashpër. Ajo flet me zë të lartë dhe me një-farë zemërimi gjithnjë. Por gjithnjë ajo flet me të drejtë. Dhe kjo gjë i tërheq të gjitha gratë e parafabrikateve. E tani gjithë reparti zjen nëpër mbledhjet punëtore.

... Martina zgjohet nga parafytyrimet. Ndjen përsëri lodhjen rraskapitëse të ditës dhe të shkollës së natës. Ka gjumë. Shikon të birin. Ja fut duart nën jorgan dhe mendja i shkon tek ai...

\* \* \*

## Mumja

Autoboti u ndal në mes të qytetit dhe shoferi hyri në klub. E vërteta ishte se ai kafen e kishte pirë me shokë por, të marrësh një rrugë të gjatë pa njeri në kabinë, është mërzi e madhe. Këtë rrugë shoferi i autobotit e bën një herë në ditë. Dhe shumë herë i qëllon që ta bëjë me njerëz. I qëllon që ta bëjë edhe vetëm. E atëherë rruga i duket e gjatë, e pasosur. Zakonisht në klub rrinë malësorë apo udhëtarë të tjerë që s'kanë mundur të gjejnë vend në autobusat interurbanë. Këtë e di mirë shoferi i autobotit. Prandaj afrohet te banaku dhe shikon te qoshku i sallës një grup shokësh të vet që sa pojanë shtruar në tryezë. I përshëndet me dorë, por nuk shkon atje.

Pranë banakut i afrohet një burrë i gjatë vratëlie i mpirë, si mumje.

— Më falni, ju jeni shoferi i autobotit?

Shoferi e shikon me vëmendje dhe mendon një çast të mos e marrë këtë pasagjer se i duket i bezdissħem e i mérzitħem.

— Ku do të shkosh?

— Tutje, nē veri.

— Prit atje.

— Pimë një kafe?..

Shoferi e shikoi me interes.

— Shkojmë. Do të nisemi.

Burri i gjatë i liroi rrugën te dera dhe aty shoferi pa se teshat e trupit ai nuk i kishte të reja, por i kishte të mbajtura mirë. «C'djall njeri!» — mendoi shoferi dhe hyri nē kabinë.

Autoboti çau përpara. Ai po mbarte karburant për uzinën metalurgjike dhe pasagjerin e gjatë vratëlie. Pasagjeri heshtte. Shoferi e pyeti përvendbanimin dhe punën, por pasagjeri ju përgjegj nē një ményrë filozofike që nuk u mor vesh. Ai fliste me përtesë, tamam si njerëzit kur lodhen së ngrëni. «Ky dreq nuk e di që, po t'i mbushet mendja, shoferi e zbret, ja, këtu nē malet e Shupalit që t'ja mbajë më këmbë...» Shoferi u mérzit. «E pat edhe kjo ditë. Kabina bosh. Sot duhet të hesht derisa të shkoj te fëmijët...», mendoi ai dhe treti nē mendime. Nuk ka si shtëpia. Shoferi mendoi të blente ndonjë gjë përfëmijët. Po fillon vjeshta. Duhen çizme të reja. Ata luajnë gjithë ditën nëpër rrugët e qytetit të vogël të veriuut dhe mund të ftohen. Duhet t'u ble nga një palë çizme të mira. Gruaja u end çorape leshi të ngrohta.

Shoferi shikoi pasagjerin e gjatë. Edhe ai men-

donte, por nuk fliste. Tani shoferi e pa më mirë fyttyrën vrarëlie që mendohej. «Ky sikur shkon të vrasë njerëz», mendoi shoferi. «Në sy ka mjegull. Njerëzit e rrezikshëm kanë mjegull në sy». Maqina mori një malore me kthesa të fortë.

— Ju sikur thatë se banoni në Durrës? — pyeti shoferi.

— Jo. Tani askund. Isha atje, por... po shkoj te të mitë... — tha pasagjeri dhe sikur u zgjat. Nga sytë pér një çast ju davarit mjegulla. Pastaj u grumbullua përsëri. S'donte të fliste. E po s'donte.

Në Fushë-Arrëz shoferi bleu çizmet e kalamajve. Pasagjeri s'lëvizi nga vendi. Autobusi kishte bërë pushimin e drekës. Dy shoferat u takuan në mes të autobusit dhe autobotit.

— Hë, sa vetë ke? — pyeti shoferi i autobotit.

— Vende bosh...

— Po ma heq qafe një mumje?..

— Sillma!

Shoferi u afrua te kabina e vet.

— Mos doni të shkoni në autobus? Kishte vende bosh...

— Jo, s'desha vetë... E kam hallin kështu, shofer... — u gjallërua mumja.

Shoferi mendoi se pasagjeri ishte pa lekë dhe e kishte më lehtë me te se sa me shoferin e autobusit. Ndoshta ishte kjo arësyje që rrinte si mumje.

— E po mirë — tha shoferi dhe hipi në kabinë. «Ej, budallaj! Po pér 23 lekë të nxihet burri kështu? Do t'ja kisha dhënë vetë...», mendoi. Kjo ishte hera e parë që shoferi mendoi kështu pér të. Pastaj rruga heshtte mes luginash, qafave të malit dhe bregut të lumit.

Pasagjeri i gjatë vrarëlie notonte në mjegullat e veta. Shoferi herë-herë ndizte duhan, por pasagjeri nuk e pinte.

— Ndize, he burrë!

— S'e pi.

— Ta paska mbledhur — qeshi shoferi i mërzitur. Mumja lëvizi buzën dhe i dolën dhëmbët. Kur ju afroan qytetit, pasagjeri foli:

— Unë do të ndaloj këtu.

Autoboti frenoi me gulçimë, kurse shoferi ofshani. Pasagjeri tërhoqi dy valixhet dhe po mblidhëte plaçkat në rrjetë. Dy valixhet do të ishin plot me plaçka, se ai i tërhiqte ngadalë dhe me vështirësi. Ai po vonohej, ndërsa shoferi ndezi një cigare. Pasagjeri nxori pesëdhjetë lekë dhe ja drejtoi shoferit.

— S'kam të thyera... — tha shoferi. — Merri!

— Ani... — «S'paska qenë halli i lekëve që nuk shkoi në autobus...», mendoi shoferi. Kartmonedha qëndronte si njollë e bokërrimtë mbi motor.

— Merri lekët! Zbrit! — shoferi nduku bishtin e cigares dhe e pështyu nga dritarja. Pasagjeri u ul pa i prekur lekët. Shoferi i mori ato dhe i hodhi me zemërim nga dritarja.

— Ta kisha ditur, ti nuk e kishe shkelur sedilen... — i tha.

Përplasi derën e autobotit dhe i dha gazit sa mundi. Në pasqyrën e krahut të djathëtë shikoi mes pluhurit dhe tymit siluetën e gjatë që u ul në mes të rrugës të kërkonte kartmonedhën. Reja e pluhurit dhe e tymit e mbuloi fare hijen e gjatë, të brrit vrarëlie.

Në të hyrë të qytetit, pranë agjencisë, shoferi

frenoi. Aty e zuri autoboti i dytë. Ai fatbardhi kish-te nja dy mësuese të reja dhe një djalë. U nda me ta shend e verë duke u shtrënguar duart me përze-mërsi. Pastaj i erdhi pranë.

- Or ti, mos kishe një pasagjer me vete?
- Po, ishte një...
- Ku e le?
- Më të hyrë, bregut të lumit.
- Mos ishte ai i gjati që të erdhi në banak?
- Po. Pse?
- Për nga e theu qafën?

— Të mbytej në lumë... E, ku di unë? Nuk desh të vinte në qytet. Zbriti atje te bërryli. Po pse?

— Ka ca histori të ngatërruara. Para ca vjetësh la gruan me një fëmijë këtu te ne dhe mori një tjetër në Durrës. Kurse para ca ditësh e la ajo durrsakja se shkoi me një tjetër. Më duket, ky po kthehet te buka e vjetër... Nuk erdhi me mua, se unë ja njoh dhëmbë e dhëmballë.

- Aha! Gjete viktima, thashethemaxhi!...
- Çfarë?
- Si qenka puna... Po e shoqja a është martuar?
- Ciла, ajo atje apo kjo këtu?
- Kjo. Ajo-në djall të shkojë! Kjo me fëmijën?
- Jo. Prandaj ky ka shpresë mos e ndreq pune-n me të. Hallin s'e ka te gruaja, por ky zotnia ka mbetur thatë andej, ose kushedi ç'ka menduar. U kthyesh prapë te gruaja e parë. **A e di** sa grua e mirë është? S'e ke idenë. Ajo s'ma merr mendja se e fal, por dreqi e di...

— A thua?

— Bën vaki. Gjithshka bën vaki. Megjithëse ajo ka ndryshuar krejt. Nuk është më ajo fshatarja

e turphme, e humbur. Tani, më duket, është përgjegjëse në parafabrikate. E kemi parë një ditë tok. Ti seq më fole për të...

— Cila, more? «Drenusha me libra»?!

— Po, dora vetë.

— Djalli e marrtë! Qenka i poshtër ai shuli. Sikur t'i kisha dy pare muhabet me të shoqen, do të shkoja tani në shtëpi dhe t'ja thyeja hundët vetë.

— Shiko, shiko... Mos don ta marrësh vetë ti?

— Unë e kam pëllumbeshën time. Ti mos llap...

— Pra, kur janë dy, i treti është i tepërt. Hajde, vemë ja themi njëzë nga birraria...

\* \* \*

Në krahët e përrallës së Kësulkuqes kishin rënë nënë e bir. Martina, lodhur e këputur nga dita, kishte rënë e veshur, veç sa ta vinte të birin në gjumë. Por...

— Marte, oj Marte!

Ja, zëri i tij! Po troket në derë. Martina brof nga krevati. Ajo e njeh që është i shoqi, Sadriu kokë e këmbë. Ajo rregullon flokët para pasqyrës. U jep një krehër ca cullufeve të hallakatura. Shikon sytë e përgjumur dhe e mbledh veten. Si e zuri gjumi, kur ajo e priste këtë? Të paktën të kishte menduar... Ndërsa ai trokiti përsëri.

— Kush është tash vonë... — foli Martina si nëpër gojë dhe një drithmë i përshkoi trupin. Po sikur t'i merrej goja? Po sikur të qante? «Kulmi... Para tij, jo!» — mendoi ajo. Dera nuk hapet kaq vonë, kurse ai nuk po ndjehet njëherë.

— Kush thërret aty? — zëri i ashpër dhe i egër i Martinës ra mbi natën si tingulli i një metali të mprehtë. Ajo u afroa te dritarja dhe hapi kanatën.

Hija e të shoqit doli nga nata dhe mori format e shkoqura duke u afroa te dritarja. Hija e heku-rave të kryqëzuara të dritates ra mbi fytyrën e tij vrarëlie dhe e copëtoi atë në katrore-katrore të çrrëgullta. Martina i shikoi një çast copat e fytyrës së të shoqit. Ai uli sytë dhe foli diçka, që Martina nuk e mori vesh.

Për një çast fytyra e copëtar u bë bardh-bardh si ekran i fikur televizori. Tani Martina pa në sfondin e bardhë e si të fikur minifundin ngjyrë gri prej teritali dhe atë tjetrën tek qeshte me ligësi në pistë. Ishin po ata sy të dalë jashtë të asaj tjetrës, që qeshnin me ligësi duke shikuar Martinën.

Pa të shoqin me sytë e ulur, të mërzitur, që rrinte si lypsar aty pranë saj dhe sikur kërkonte diçka. «Po, ky kërkon diçka dhe kjo duhet zgjidhur», mendoi Martina.

— Vonë, shumë vonë, Sadri!

Ajo i foli në emër dhe kjo ishte e para herë që e thërriste në emër. Ai duhet ta kuptonte edhe vetë. Ajo shtyu kanatën dhe u ul në karrige pranë tryezës. Ai priti edhe pak atje, por nuk trokiti më. Ai lëvizi dhe shtyu kanatën. Për një çast u shikuan sy ndër sy. Ai buzëqeshi si me frikë.

— As dorën s'po ma jep, Marte?

— Si është puna, mos të ka mbetur ndonjë plaçkë këtu?

Asaj ju kujtua një xhaketë e të shoqit prej stofi. Xhaketa ishte e re dhe e bukur, por e zezë. Ajo edhe mund ta kishte shitur xhaketën, mund t'ja

kishte dhënë një tjetri. Por nuk ju dha asnijëherë që atë xhaketë ta niste jashtë derës. Kurse i shoqi nuk erdhi më në shtëpi as për gruan as për xhaketën. Ai i braktisi të dyja. Mos vallë tash do të mjaftohej me njérën? «Ne për të ishim njësoj», mendoi Martina duke e shikuar. Ajo e vërejti me kujdes, si u gjallërua ai, kur dëgjoi fjalën plaçkë.

— Unë erdha. Mbaroi. S'kam punë me atë tjetrën...

— Ashtu? Bukur fort. Si duket, erdhe për dimër këtu... — Martina qeshi. Ajo i përmblodhi mirë fuqitë. Para tij s'donte të tregohej e lodhur nga puna e ditës. Po ai nuk qeshi.

— Marte, pash rizan e zotit, harroj ato... Më fal për hir të fëmijës që kemi!

— Sadri, sa fëmijë jetimë le andej nga plazhi?

— S'pata asnijë. Ajo nuk pillte — u gjallërua fytyra vrarëlie e tij.

— Po atë tjetrën, ç'e bëre? Pse nuk e ke prurë për vizitë?

— Marte, unë të thashë. Mbaroi ajo. Iku me një tjetër. E zura vetë. Prandaj kot llafi... Hape derën!

«Ende kujton ky se unë jam copë mishë me dy sy», mendoi Martina. «Më mendon si xhaketën e vet, që të më hedhë krahësh si të dojë... Hajde mendje, hajde!»

— Vonë, shumë vonë, Sadri! Më mirë shko e shiko punën tënde, më lërë rehat...

Martina ja tha këto fjalë e vendosur, pa ju dridhur zëri, pa u tallur me të. Ajo u ngrit. U afrua dhe mbylli kanatën përpëra syve të tij që kullotnin në dhomën e gjumit. Asaj ju duk sikur po i vritnën

gjumin e të birit. Uli perden dhe përsëri u mbështet mbi tryezë. Ndjeu hapat e tij dhe njëfarë mërmëritje në kalim. Hapat u ndalën te shkallarja e hyrjes. Kaluan ca minuta, pastaj ai shkrepit çakmakun. Sigurisht po ndizte cigaren. Kaloi mjaft kohë dhe Martinës ju duk kohë e gjatë. Hapat erdhën përsëri te dritarja.

— Hape derën! Shtëpinë na e ka dhënë shteti të dyve...

Zëri i tij ishte kërcënues. Martina vendosi të mos i përgjigjej por u pendua shpejt. «Ai e di që jam zgjuar», mendoi. «Më mirë t'i përgjigjem. T'i përgjigjem dhe t'i tregoj rrugën.»

Ajo u afrua përsëri te dritarja dhe tërhoqi kanatën.

— Shteti ma ka kaluar vetëm mua shtëpinë — tha e vendosur dhe prerë. Ligjërisht s'ke vend këtu, Sadri. Kuptove?

— Unë kam djalin këtu...

Martina qeshi. Ai zgurdulloi sytë.

— Im bir nuk ka baba — i tha e qetë. — Nga i ati ka mbetur vetëm një copë letër telegrami...

— Telegramin e bëri ajo pa lejen time...

— Kjo gjë tashmë nuk ka rëndësi. Largohu, të lutem! Mos më bezdis më!

— Marte, falmë, do jem yti. Do të jetojmë të qetë. Më mbushi plot mend jeta. Falmë, nuk kthehem kurrë tek ajo tjetra!

— Dëgjo, Sadri... Paske ardhur me shpresa të mëdha. Kujton se po gjen Marten që le për një minifund gri. E le për një fokstrot... Ah, sa më dhimbshesh, Sadri! Je gabuar. Më dhimbshesh, të them të drejtën. Po unë kam ndryshuar. S'jam ajo Marta

që le ti. Unë tash dua një tjetër. Së shpejti mar-tohem...

Tjetri ngriti kokën sikur u zgjua nga një ëndërr e keqe dhe katroret e hijeve që i kryqëzoheshin mbi fytyrë u prishën.

— Ligjërisht je imja. Unë nuk e kam bërë di-vorcin...

Martina qeshi. Ajo e shikoi e qetë. Fytyra vra-rëlie po i afrohej tok me errësirën për t'i grabitur dritën e dhomës dhe lirinë. Vala e zemëratës, që i mbushi gjoksin dhe i ngushtoi fytin, kërkonte të derdhej.

— Paske mbetur prapa botës, more i mjerë! Në këta tre vjet unë kam rilindur. Udha e mbarë të goftë dhe shikoje mirë punën tënde...

Martina u tërhoq përsëri nga dritarja dhe u ul në karrige pranë tryezës. Ai nuk lëvizi.

— Marte, unë po largohem meqë dëshiron ti... Drinin e kam afër. Lamtumirë! Nuk do ta shohësh më Sadrinë tënd... Lamtumirë, jeta ime...

Martina qeshi me gjithë shpirt dhe me zë të lartë.

— Sa poshtë paska rënë katundi — tha. — Ikë, Sadri, ikë! Drini s'i merr njerëzit si ti, i nxjerr në breg shpejt...

Sadriu ndërroi mendje. Inati ja ndezi sytë dhe ja bëri fytyrën prush. Nisi të dridhej. Duke parë atë, Martinës i shkuant të rrëqethura në trup, se ju kujtuan çastet kur ai e rrihte.

— Dëgjo — tha ai — hape derën, se do ta shpër-thej!

Martina s'foli. Ajo gjeti forca ta shikonte drejt e në sy. Tani ju zgjua zemërimi dhe kërkonte të

shpërthente. T'i fliste dhe t'i fliste për tre vjetët e jetës, për jetën e tërë, për djalin dhe për veten. Por u përmبajt. Një dallgë punëtorësh të turnit të tretë u derdh në sheshin përpara shtëpisë tamam në atë çast, sikur ta thërriste ajo. Disa nga ata panë takimin dritëhije dhe u ndalën të ndiznin cigaret. Martina s'priti më.

— Shokë, ejani pak këtu! Ky qytetar po më bie më qafë... — tha Martina. — Ma hiqni, ju lutem...

— Oj, oj, kush na qenka! — thirri njëri nga ata.  
— C'erë të solli këtej?

— Pa eja, probe, se Marta është jona... Eja, se i kemi dy llafe tok.

Punëtori që i foli, u afrua, e zuri për gjoksi dhe e tërhoqi tutje. Sadriu u mundua të shkëputej, por dy-tre të tjerë ndihmuani shokun e tyre.

— Mos na nxirr telashe para turnit... Hajde, nuse! Para, mos e zgjat!

— Hotel «beqarnia» ka boll vend për ty...

Dallga e përlau me vete. I uruan natën e mirë Martinës dhe ikën. Ajo mbylli dritaren dhe u kthyte tek i biri, e lodhur dhe e dëshiruar për gjumë. Ra e fjeti menjëherë si e vdekur. Të nesërmen do të shkonte në parafabrikatë që në orën shtatë.

## FUNDI PREJ TERITALI

Gjithshka nisi kështu.

Stacioni i famshëm i Rrogozhinës, para se të ndërtohej hekurudha për Fier. Vapë korriku. Atëherë reparti ynë ndodhej në fushim diku tutje atij Berati, kurse unë po kthehesha nga leja. Nuk kisha biletë autobusi dhe m'u desh të rropatesha në gjurulldinë e atij stacioni që e kujtojnë të gjithë, edhe sikur vetëm një herë t'u ketë rastisur të kalojë andej. Meqë brenda, para sporteve, kishte aq shumë njerëz, saqë nuk kisha shpresë për biletë, dola jashtë të bisedoja me përgjegjësin nga dritarja. Aty zakanisht vinin shoferët e kamionëve për të firmosur fletelinjat. Sa ju afrova dritares, ndjeva se di-kush po më vinte pas. Ishte një vajzë.

Ajo mund të ishte punëtore kombinati, mësuese, shtëpiake, nëpunëse, e martuar nga ato që nuk mbajnë unaza, veç jo vajzë e keqe. Kjo gjë më ra në sy nga vështrimi i saj serioz, që më ngjalli menjëherë respekt. Që në të ecur dukej delikate, ndonëse kishte një fytyrë të plotë. Unë e pashë mirë atë, kur u afrua lehtë-lehtë pranë dritares së përgjegjësit te hekurat ku isha qepur unë. Pas saj er-

dhën shpejt shumë burra, gra, djem dhe kalamaj të djersitur që shtynin njëri-tjetrin.

Një burrë me këmishë najlon, çau mes tyre si trim dhe ju afrua pranë vajzës. Unë u tërroqë pak. Shumë duar të djersitura bënë piktura të bukura impresioniste mbi këmishën najlon. Burri shau po aq bukur, u tërroq dhe u mënjanua. Vajza më shikoi me mirënjojje, se sigurisht edhe duart e mia të djersitura bënë puniën e tyre mbi këmishë. Unë i buzëqesha me mirësjellje, se desha t'i thosha që ja dija mirë adresën edukatës, pa çka që atë ditë në udhëtim isha edhe i parruar. Vazhdova të prisja me shpresë se shoku përgjegjës do të merrte ndonjë vendim më në fund, ndonëse ishim nga tre-katér pér çdo destinacion.

Vajza u shty edhe më shumë pranë meje. «Më fal, shoku ushtar» — më tha e skuqur dhe u mundua të buzëqeshte. Ndjeva trupin e saj të butë mbi te-shat e mia verore. Mua më erdhi keq pér të; por s'kisha si ta ndihmoja, se isha në hallin tim. «Më fal ti» — i thashë, dhe u mundova të shtyja me shpatulla të tjerët që t'i lija hapësirë të mjaftueshme vajzës. Po nuk kishte bir nëne që i tundte ata që ishin pas nesh. Kishte edhe gra mes tyre. Sipër nesh digje si me kast dielli i korrikut.

Dëgjova një zhurmë të veçantë grisjeje, pastaj pashë diçka që feksi te këmba e vajzës. Ajo u lëkund dhe sakaq vuri dorën. Ishte këmisha e mëndafshët që llamburiti nën minifundin prej teritali, që kishte hapur gojën në të qepurën anësore.

Vajza u bë lulkuq. Shpejt e shpejt ajo e mbësh-teti në mur atë gojën e bardhë të minifundit dhe më shikoi me lot në sy.

— Kush? — e pyeta. Isha gati t'ja krisja grusht tē parit që do tē më tregonte vajza e tmerruar nga turpi, sidomos asaj këmishës najlon, që tani kishte ardhur përsëri e shtyhej aty afér dhe më dukej sikur më kishte ngrënë bukën.

— Jo. Vetëvetiu... — m'u përgjegj lehtë vajza, ndërsa kokën e mbante nga hekurat e kryqëzuar tē dritares së mbyllur.

— Ke njeri këtu?

— Jo.

— Ke vëlla?

— Po — tha e çuditur — por jo këtu...

— Unë jam vëllai yt... — i thashë. Shpalosa fletën e kapës dhe i tregova gjilpërën me pë. — Dil pas agjencisë. Lëre biletën, djalli e marrtë!

Ajo u tërroq ngadalë në cep tē murit. Ika edhe unë nga radha.

— Do tē vij përsëri — i thashë atij që kisha pranë.

— Mos u bëj merak, do tē ta ruajmë... — qeshi këmisha najlon, sikur ta dinte që unë e doja si prushin në gji. I tregova kapën me yll dhe ika. Të tjerët qeshën. Sigurisht me atë, s'besoj tē kenë qeshur me mua. Vajza rrinte pas cepit tē murit tē agjencisë, qante në heshtje dhe dridhej. Ajo kishte një çantë tē vogël nga ato, ku gratë mbajnë paratë dhe tē kuqtë e buzëve. Po ajo nuk lyhej. Vajza vazhdonte tē qante kryeulur dhe unë nuk dija si ta ngushëlloja. I dhashë gjilpërën dhe perin. Peri ishte i verdhë i mbyllur, në ngjyrën e zakonshme tē rrobës sonë, kurse minifundi i saj ishte terital bojëhiri.

— Qepe shpejt. Unë po rri pak këtu... Nga unë mos ki turp, më ke si tëndin...

Ajo u përkul që ta kapte minifundin, por ai ishte aq i ngushtë, sa e hapte atë gojën e bardhë pa masë, duke ja deformuar trupin e saj të bukur dhe duke i nxjerrë më në pah këmishën e saj prej mëndafshi.

— S'e qep dot — tha dhe përsëri e mbytën lotët. Njerëz hallexhij kalonin tutje-tëhu në punët e veta, si në stacionin e autobusave të Rrogogzhinës. E pashë vajzën me vëmendje dhe mendova: Si ëshë e mundur, kjo vajzë kaq e mirë, kaq e bukur të katandiset në një gjendje të tillë? Si dreqin t'ja bëj? Dhe me gjithë mend unë s'dija si t'ja bëja, si ta ndihmoja. Të ulesha e t'ja qepja vetë, do të bëhesha gazi i botës. Do t'u tërhiqja vëmendjen kallimtarëve. Të shkonim ndokund, ku të shkonim? Ajo nuk mund të lëvizte fare, se goja e bardhë e minifundit gri llamburiste.

— Të thërras ndonjë grua? — e pyeta.

— Mazallah! — tha e tmerruar dhe unë i pashë sytë e saj të tmerruar. Ata sy, pa atë furtunë lotësh, do të ishin shumë të bukur. Lotët i kishin njomur krejt faqen prush.

— Po ti mos qaj, se nuk u bë kushedi se çfarë.

— i thashë. Desha t'i thosha se në plazhin e Durrësit unë kisha parë turistet që kishin dalë bullevardit me veshje më të shkurtëra se sa këmisha e saj. Po lëre, mendova, nuk është koha për qyfyre. E vërteta ishte se unë doja që ta qetësoja. Vajza nuk foli. Ajo më zgjati gjilpërën me perin e verdhë të mbyllur.

— Më mirë ju — më tha dhe u mundua të tre-guhej e qetë. Unë e pashë se ajo ishte menduar gjatë para se të merrte këtë vendim. Kurse tani varej vetëm nga dëshira ime, nëse do ta zbatoja apo jo.

Unë e pashë se në sytë e saj kaltëroshë kishte diçka të pastër dhe të bukur. Më shumë tek ajo flisnin sytë se sa fjalët. U ula menjëherë, po në shpirt më hyri krimbi i shqetësimit. Mjerë unë nga rromuzet, po të më shikonte ndonjëri nga shokët e repartit tim!

— Ej, ushtar, të erdhi radha! — më thirri koka e këmishës najlon nga cepi i ndërtësës. Shikoi me përcëmim dhe iku. Unë nuk fola, por i dhashë nga pas urrejtjen time të heshtur si një dangë mbi najlonin e tij. Vazhdova punën time të bukur, gati i qetë.

— Më fal — tha ajo — të lashë pa biletë...

— Moj motër, ti qetësahu njëherë — i thashë.

— Dhe mblidhu pak, se nuk po më shkon mbarë kjo punë... Eshtë i ngushtë.

Ajo nuk foli fare. I mbledhi këmbët pranë njëra-tjetrës dhe nuk foli. Minifundi ishte tepër i ngushtë, kurse vajza ishte e shëndetshme. Unë nuk po e qëlloja dot punën time se herë-herë dora më ndeshte në këmbën e saj dhe tronditja ime shtohej e shtohej, sa u mbyfta në djersë. Mbi kokën time të qethur vazhdonin të binin lot të heshtur.

— Mos qaj — i thashë. — E ka fajin minifundi.

— Jo, jo. Koka ime.

Unë ngrita sytë dhe ne u pamë një çast. Sytë e saj ishin tërheqës dhe të menduar. Ata shprehnin vuajtje dhe zemëratë. Unë e shkova fillin për bukuri dhe e mbylla gojën e bardhë. Tani ajo e mori veten.

— Të falem nderit, vëlla!

— Edhe një minutë — i thashë. — Ta forcoj, se peri është i vdekur. — Ajo nuk lëvizi. Ishte bërë e urtë si dele.

— Tani në rregull — i thashë dhe u ngrita. Ndjeva në gojë shijen e kripur të djersës që më ro-dhi nga buza.

— Nga je, vëlla? — më pyeti ajo.

— Përse të duhet? — qesha unë. — Jam nga s'je ti.

— Si të quajnë?

— Ushtar.

Unë e kuptova se ajo donte që të më shpër-blente në një farë mënyre.

— Ku shërben, në cilin repart?

Ajo u gjallërua dhe në sytë e saj unë lexova shumë mendime të turbullta. Sytë e saj ishin shumë shprehës, ca sy të bukur, të atillë nuk kisha parë tek asnjë vajzë.

— Është sekret ushtarak — i thashë dhe i rrasha shpinën miqësish. Tani unë e ndjeja me gjithë mend veten të afërt me të.

— Të lutem — tha — kallëzomë si të quajnë dhe ku i ke prindët!

— Mos më pyet më gjatë. Unë nuk tregoj asgjë. Sot, unë e di, ti je shumë mirënjoshe ndaj meje për këtë që ndodhi. Por nesër, kur ta kujtosh këtë dhe të mendosh se unë jetoj diku dhe quhem filani, ti do të vuash dhe nuk do të shkelësh atje ku jam unë.

— Do të të ndjek si hija jote... — ajo vuri buzën më gaz dhe unë pashë se si qeshën sytë e bukur. Ajo e tha këtë më shumë që të shikonte në do të jepesha unë apo jo.

Ajo rregulloi flokët dhe unë pashë ngjyrën e tyre të përflakur. Ne u larguam nga qoshja e kënd-shme e njohjes sonë dhe e lamë agjencinë dhe bishletat. Shkuam në pasticeri të pinim akullore. Kur

## «BIN-JAK! BIN-JAK!»

(skicë)

Kjo ngjau më 1956, në muajin shkurt. Që atëherë rodhën kaq vjet. Sha Xho Ta-ji, pasi mbaroi universitetin tonë, shkoi të punonte në atdheun e vet. Kurse dy binjakë më erdhën sot në klasën e parë të shkollës së mesme. Mos janë këta «bin-jakët» e Sha Xho Ta-jit?

\* \* \*

Treni turfullon përpara mes fushës. Unë i lë studentët e tjerë në kabinë dhe i afrohem Sha-jit. Ai ka kohë që po qëndron te dritarja e korridorit. Qëndroj aty pranë tij dhe shikoj se ai e ka tretur vështrimin diku në fushë.

— C'ke, je mérzitur? — e pyes.

Ai bëri një lëvizje të shqetësuar sikur u zgjua. Sytë e zez i shkëlqyen.

— Jo. Në fushë gjëra shumë interesant ka...

— tha i menduar e me seriozitet. Unë e shikova me vërejtje. E çfarë i bën përshtypje këtu Sha-jit?

Në korridordin para kabinave ka shumë kalimtarë. Ata e shikojnë me vëmendje Sha-jin. Një fshatar plak me një torbë në sup qëndron pranë nesh. Ai e shikon në mënyrë të çuditshme Sha-jin. Ndoshta po shikon për herë të parë një kinez dhe e gjykon me vend që të qëndrojë pranë nesh. Herëherë ai kthen sytë nga Sha-ji. Kush e di q'mendon ky plak, por vetëm një gjë ai s'e mendon me siguri: ai nuk e di që Sha Xho Ta-ji është nga ata njerëz që nuk do të bjerë në sy dhe e bezdis vëmendja e të tjerëve. Sha-ji ndjen kënaqësi të veçantë të rrrijë mes njerëzish. Po plaku është në punë të vet aty fare pranë nesh, kurse Sha-ji vazhdon të shikojë fushën.

Treni po kalonte pranë një kodre për të dalë përsëri mes fushës.

— Shiko — më tha Sha-ji dhe përsëri i xixëlluan sytë. — Shiko si punon ai atje...

Diku tutje mes fushës një fshatar lëronte tokën me qe. Ai ecte ngadalë mbi brazdë me ritmin e pendës. Një grua dhe një fëmijë hanin drekën rrëzë trungut të një lisi.

Treni hyri në periferinë e një qyteti të vogël duke fërshëllyer e duke çarë me gjoks erën e ftohtë të shkurtit.

Unë ngrita supet. E çfarë gjë interesante po shikon ky Sha Xho Ta-ji këtu në fushë? Fshatarin, të shoqen dhe fëmijën? Tokën ugar, qetë...

Sha-ji qeshi.

— Shqipëria e vogël. Populi i madh. Ju — popul shumë i madh — tha. — Armik, armik, armik —

ai bëri me gjest sikur po më tregonte pikat e horizontit. Sytë i shkëlqenin nga një zjarr i brendshëm. U mendua ca që t'i gjente fjalët më mirë. — Fshatari punon i qetë. Nuk shqetësohet fare...

Ja, përse e vriste mendjen Sha-ji. Kurse mua m'u kujtua se ato ditë flitej shumë nëpër gazeta për ishujt Kue Moi.

Treni hyri në qytetin e vogël. Mori frymë thellë dhe u ndalua me gulçimë. Në korridorin e ngushtë u shtuan lëvizjet. Një grumbull pasagjerësh vinin si dallgë dhe, sa shikonin kabinën tonë të zënë, derdheshin te tjetra. Fshatari me torbë as pyeste për kalimtarët. Ai mendohej dhe pinte cigare, ulur aty pranë. Unë hyra në kabinë te të tjerët.

Pesë minutat e pushimit mbaruan shpejt. Ndjeva bilbilët e konduktorëve. Sha Xho Ta-ji nuk ishte te dritarja. Dola nga kabina, por ai nuk ndodhej as gjatë korridorit, as në kabinat e tjera të afërtë. «Sigurisht do të ketë zbritur për ndonjë punë», mendova. Ika me vrap. Në sheshin e stacionit ai nuk dukej. Vrapova nëpër vagonat e tjerë. Bilbili ra për të dytën herë. Kohë s'kishte më, edhe një minutë. Pasagjerët e fundit po ngjitnin me shpejtësi shkallaret dhe shtyhesin e ngjesheshin nëpër korrideret. Dikujt i shkela këmbën në vrapimin tim. Ai më shau vence, dhe unë e përtypa mirë atë të sharë, se më shijoi fort.

Në njërin nga vagonat e klasës së tretë, mbushur plot e përplot, unë pashë Sha Xho Ta-jin përkulur mes dy fronave të drunjë të një kabine të gjatë. Ai ishte përkulur shumë. Kishte hapur duart dhe rrinte ashtu. Në fillim i pashë shpinën. Ende duke vrapuar drejt tij, treni bëri një lëvizje të fortë, si ndonjë dem i zemëruar që e têrheqin nga

hallka. Ai nisi të rrëshqiste. Te dera përballë hyri një grua flokëshprishur, e lemerisur.

Gjithë kjo ndodhi për dy sekonta.

Sha mbante dy foshnje që flinin, lidhur ndër pelena, secili në njërin nga fronat e drunjtë. Ai vazhdonte t'i mbante foshnjet me duar e me kujdes se mos ndonjëra nga ato kapërdihej e binte nga tronditja e trenit. Gruaja e lemerisur ngriu aty më këmbë. Unë s'fola. Sha ktheu kokën nga gruaja që u ul, në fron. Ajo mori njëren nga foshnjet në prehër. Foshnja ende flinte. Nënës i erdhi turp. Tani mbi fytyrë ju derdh një prush i valë. S'dinte si ta falënderonte Sha Xho Ta-jin.

— U bëfshin të mirë! Qutetarë të mirë! — Sha qeshi dhe eci me mua duke i lënë të dyja foshnjet në prehrin e nënës.

— Ç'deshe këtu, Sha?

— Mes popullit... muhabet... — tha dhe përsëri qeshi. — Si quhen du fëmijë... një nënë... një ditë lindje?..

— Binjakë.

Sha u ndal mes wagonit të gjatë, mbushur plot e përplot me njerëz.

— Bin-jak! Bin-jak! — rrokëzoi si gjithnjë, kur mësonte një fjalë të re.

— Binjak — i shqiptova ngadalë dhe eca. Dikush qeshi aty afër. Ne kaluam në punën tonë.

— Unë mbajta du bin-jakët — tha Sha. — Ti pse shqetësosesh për mua?

E shikova dhe s'i fola. Ai ishte ende i emocionuar. Ç't'i thosha? T'i thosha se shoqëruesi i tij për në jugë përgjigjet për të, do të kujtonte se unë i druhesha përgjegjësisë. Mund të ndodhë që

edhe të më mbetej njëri nga ata në ndonjë stacion dhe, po të më ndodhët kjo gjë, më shumë do të ishte turp për mua. Se ata ishin të bindur si ushtarët. Pra, ndonëse unë nuk fola, Sha e kuptoi shqetësimin tim. Kur shkuam në kabinë te shokët, Sha foli diçka kinezçe. Unë e mora me mend se ai nuk u tregoi për bin-jakët, por për vete dhe për mua. Se shokët u bënë seriozë menjëherë. Ju vërsulën dhe i bënë dash me kritika një copë herë. Unë ndërhyra, por ata më thanë se komentonin një material të Zheminzhibaos. Sha dëgjonte i qetë shokët, nuk kundërshtonte. Herë-herë fliste pak dhe qetë, pranonte në heshtje ato që i thoshin shokët.

Treni ecte drejt përparrë. Pas pak ai do të merrte kthesën, pas brinjës së kodrës. Sha Xho Ta-ji lexonte një libër me kopertinë të kuqe dhe sytë i shkëlqenin.

## M E R K O

Merko Merkaj ecte drejt sektorit të montimit në rrugën plot llucë. Retë vinin nga jugu grumbuj-grumbuj dhe copëtonin këmbët mbi kreshtat e malit. Oshëtima e lumiit dhe e atyre mijëra maqinave të kantierit derdhej e përhapej nëpër luginë dhe njeriu nuk mund ta dallonte mirë në ishte gjëma e lumiit apo gjëma e maqinerive. Së shpejti, si dukej, do të fillonte rrebeschë. «Po, po rrebesch», mendoi minatori Merko duke hyrë në sektorin e montimit. Ai kaloi nga klubi dhe te banaku gjeti një grup montatorësh.

— Ç'je bërë kështu, o i zi... — qeshi njëri nga ata duke shikuar fytyrën e Merkos tërë danga vajrash. Merko e di që ka zakon të fërkojë ballin herë-herë dhe këtë punë të bukur e ka bërë me siguri duke i pasur duart me vajrat e sondës.

— Po bëj përpjekje të të ngjaj ty... — i tha Merko i qetë dhe ktheu gotën e konjakut e doli. U fut në repartin ku montohej një vinç gjigant, i cili do të lëvizte mbi shina. Aty ishte ajo. Ai ngriti kokën të shikonte se ku mund të ndodhej ajo, por i ra një pikë e madhe shiu mu në ballë. «Po fillon

rrebeshi... Gjithnjë kështu fillon, me pikë të rralla si kjo që po ma lan ballin», mendoi.

— Lizaa! — thirri ai poshtë vinçit gjigant. Diku nga kabina e vinçit u duk koka e një vajze që i tundi dorën. Djali hyri nën këmbët e vinçit dhe ngjiti shkallaret lart. Tani nuk e ndjente më të ftohtët. Po ngjitej drejt asaj. Rrugës takoi dy shoqë të tjera elektriciste që po ngatërronin diçka në një pjesë tjetër.

— Vajza, ku e keni brigadieren?

— Në kabinë! — i tha njëra nga ato, duke e shikuar si me dyshim e me tallje. «Ah, jam mësuar me këtë smirën tuaj», mendoi Merko. «Në djall të vini. Unë e dua Lizën dhe aq më bën...»

Ai hyri në kabinë. Ajo rrinte mbështetur te dritarja. Cullufja e flokëve i lodronte mbi ballë, kurse ndër duar kishte një fije tel bakri, që po e këpuste copë-copë në pincë.

— Lizë, na la sonda... — i tha. Mori frymë dhe u mbështet në derë të kabinës.

Vajza e shikoi, ju afrua pranë dhe i hodhi duart mbi supe. Afroi cullufen e flokëve pranë ballit të tij të zhigatur dhe e puthi lehtë. Dora që mbante pincën u var prapa supit.

— Thuaj se më do... — i tha ajo.

— Të dashuroj. Ta kam thënë edhe dje. Unë të dashuroj, Lizë... — Vajza ishte bërë prush në ftyrë. Merkos i dukej se ajo e kishte pritur me orë të tëra.

— Më puth... — i tha ajo, pa e larguar dorën me pincë që varej pas supit të tij. Pas pak djali shikoi dritaren dhe vërejti se xhami ishte errësuar, ndërsa mbi të rrëshqitnin shirita të ujshëm. Ai

mendoi rrebeshin dhe kujtoi shokët që, sigurisht, vazhdonin të rropateshin më kot pranë sondës, ose ndoshta e kishin lënë fare atë dhe vazhdonin me matropikë. «Tani Kadriu, mendoi Merko për shokun e tij, nuk po këndon këngën e tij të preferuar «Dea është e re, Dea është e bukur... Sigurisht ai është mërzitur se nuk po ja dalin dot në krye...». Për këto që mendonte, Merko ishte gati i sigurtë, se ai kishte qenë vetë mekanik para se të bëhej minator dhe e kuptonte nga përvoja se sonda kishte një defekt të rëndë.

- Lizë! — ai desh t'i thoshte edhe diçka vajzës.
- Merko, sa bukur është këtu, larg tokës...
- tha ajo. — Puthmë edhe një herë... Shtrëngomë...
- Filloi rrebeshi — ja ktheu Merko pas pak.
- Po vesh mushamanë — tha vajza duke u shkëputur nga krahët e tij. — Shpresa — thirri ajo shoqen e vet — vishni mushamatë! Do të shkojmë në kuotën tre...
- Të marrim shumë tel? — ushtoi zëri në trupin e vinçit.
- Merrni, merrni!

Pas pak ata u ulën njëri pas tjetrit poshtë trupit të vinçit. Vajzat nisen të qeshnin dhe zëri i tyre ushtonte si fragment i një kënge. Dolën mes rrebeshit duke lënë pas vinçin i cili dukej nën renë e rrebeshit si silueta e murrme e një minatori që shkund krahët dhe gatitet për të bërë diçka. «Tamam si Kadriu në çastin e ndezjes së minave, kur kontrollon me sy gjithë ambientin rrëth e rrötull tij se mos ka mbetur kush», tha Merko me vete duke e shikuar vinçin për një çast dhe vazhdoi rrugën.

Ata kaluan kryqëzimin e rrugëve dhe hynë në pjerrësirën që të conte në depresionin e thellë. Ky

depresion në fillim ishte pjesë e malit që ngrihet në veri. Atëherë Merko shkonte pas të atit dhe gjuante lepuj në mal. Por malin e shembën në këtë pjesë, e rrafshuan dhe e thelluan. U hap ky depresion si një hinkë e stërmadhe me pjesën konike poshtë. Brigada të tëra minatorësh punojnë këtu. Gjithë sektorët e tjerë punojnë për këtë hon konik të stërmadh. Dhe Merko me shokët e tij punojnë në pjesën shkëmbore, që tani mezi duket prej rrebeshit. Shokët rrinë grumbull pranë sondës. Tani Merko i dallon mirë shokët dhe sondën dhe nuk e ka mendjen fare te balta e madhe që është formuar nga kalimi i maqinave që mbartin papushim zhavorr e dhë që e hedhin tutje, matanë grykës së konit. Çizmet i futen thellë në baltë e ai mezi i nxjerr andej, por mendjen e ka te shokët. Vajzat ecin para tij dhe ai shikon si shkëlqen mushamaja e Lizës nën rrebeshin që e rreh me tërë forcën. «Ky është dimër, tamam dimër,» mendon Merko. «Liza është më e mirë se sa e njoh unë. Ajo është më e mira nga të gjitha vajzat që kam njohur.»

Kur u afroan te shokët, Kadriu i ngrysur u ngrit nga shkëmbi ku ishte skrupulluar prej rrebeshit.

— Erdhët, ë?! — thirri ai dhe shkoi te vajzat.

— Lanë punën atje... — i tha Merko.

Sonda heshtte si send i vdekur. Ndërsa shkëmbi i fortë qëndronte i patundur. Tutje vinte si gjëmim zhurma e sondave të tjera. Kjo, ndoshta, ja cingriste nervat Kadriut që rrinte i ngrysur dhe shikonte sondën e vet të heshtur. Ai nuk këndonte më këngën e tij mbi Dean e bukur që u mbyt në va sepse dashuroi, as atë pjesën e stisur prej tij, ku Dea e re dhe e bukur dashuron minatorin e ri. Jo, ai hesht

tani si sonda dhe shikon Shpresën. Ato diçka thanë që atij nuk i pëlqeu.

— Në djall të shkojë, mall i huaj! Nuk ka as patentë kjo austriakja — tha Kadriu për sondën, ndërsa vajzat po zbërthenin impiantin elektrik.

— Po të ishte me patentë, nuk hante bukë në brigadën tonë — u zgërdhi njëri.

— Llaf me vend... — ja priti Kadriu.

Merko shikonte me vëmendje duart e vogla të Lizës, që preknin me kujdes lidhjet e elektromotorit. Vajza u kthye njëherë nga Merko dhe ai pa sytë që i shkëlqenin nën cullufen e lagur e të ngjitur për ballë. Dukej sikur gjithë rrebeshi i kishte rënë mbi fytyrë. Duke punuar ajo nuk mund të mbrohej nga shiu. Nga faqet i uleshin pikla uji. Kapuçeta e mushamasë rridhte çurg, dhe në këtë kornizë Merkos i pëlqente më shumë vajza. Ai shikoi horizontin e myllur të malit dhe pa rebeshin që përplasej me rrëmbim.

— Në impiantin elektrik nuk ka defekt — tha Liza e ngrysur. — Duhet të jetë në pjesën tjeter motorike...

Vajza fshiu me pëllëmbën e vogël ballin e larë nga rrebeshi. Shikoi Merkon e dëshpëruar dhe futi pincat në xhep. «Sigurisht ajo e di se ç'do të thotë me këtë», mendoi Merko. «Kësaj i thonë: fluturo, o krahëthatë!»

— Pazotësinë tuaj na e tregoni si të sigurtë diku tjeter... — thirri Kadriu i nevrikosur.

— Prit njëherë — i tha Merko.

— Ç'të presim. U bënë dy orë pa punë... A ecet larg me matropikë?

— Domethënë dëshironi t'jua zbërthejmë ne?!

Nuk është vështirë, por kjo nuk është detyra jonë... — tha Liza e qetë duke u afruar pranë pjesës tjetër motorike.

— Largohuni! E gjejmë vetë... — foli Kadriu i zemëruar.

— Mos prek! Ende e kemi ne sondën në duar. Vajza, më ndihmoni ta përfundojmë kontrollin elektrik këtu... — tha ajo dhe ja nisi punës në pjesën tjetër motorike.

Sonda heshtte si e përgjumur aty mes të rinxve dhe rrebeshit, ndërsa Liza dukej si kirurgu që i ka hapur gjoksin një ushtari dhe don t'i shikojë zemrën.

— Ja, merre, shoku zjarrvënës. — Liza i drejtoi Kadriut një detal të thyer mes për mes. Mbi duart e vogla detali po lahej prej rrebeshit. Kadriu e tërhoqi atë, kurse vajza i futi duart nën mushama. Merko e kuptoi se ajo u mërzit nga detali. Sigurisht që edhe ajo e kuptonte se sonda do të qëndronte gjatë në atë heshtjen e saj ogurzezë.

— Si quhet kjo, baterflaj? — pyeti Shpresa Kadriun.

— Baterflaj, madamë baterflaj<sup>1)</sup>, jepmë dorën tënde!... — Kadriu deklamoi tërë zemërim duke ju afruar vajzës si në estradë.

— Ikë, budalla! — i tha ajo.

— Duhet ta bëjmë vetë me, forcat tona — tha Merko.

— Siç po shihet, me forcat tona... — ja priti Liza e menduar.

— Me forcat tona, baterflaj!? — Kadriu përsëri qeshi, por Merko e kuptonte më mirë se të gjithë atë

---

1) (Inglisht) — flutur, zonja flutur.

të qeshur të zemëruar që nuk do të qetësohej lehtë.

— Tani, shokë, të punojmë me matropikë. Ti, Merko, me Kadrinë nisuni për në oficinë — foli njëri nga djemtë.

Kështu që u nisën ata të dy dhe vajzat. Jujgjiten së përpjetës së honit plot baltë. Tani rrebeschin e kishin përpara. Ai vinte i furishëm, me erë të ftohtë dhe i rrithë të rinjtë që çanin veç përpara. Merko shikonte Kadriun me baterflajin në dorën që mbante pas. Ai i tha Lizës të shkonte me ta. «Më mirë me të», — mendoi. «Do të na ndihmojë prania e saj».

Por në oficinë inxhinieri mekanik nuk i priti mirë. Nuk bëhet, nuk bëhet... «E përse nuk bëhet, moj diplomë?» — mendoi Merko.

— Shkoni, se do të ketë pjesë këmbimi në magazinën qëndrore — tha ai më në fund. Të rinjtë dolën andej të ngrysur. «Siç po shihet, duhet t'i hyj vetë», mendoi Merko. «Por duhet të largohem nga tri ditë nga honi i turbinave. Duhet të ngulem këtu në oficinë. Më duhet tornoja universale, një ratifikë dhe ndonjë gjë tjetër. Vetëm ato më duhen përzonjën baterflaj.»

— Shko nga zyra e partisë. Shko shtroje çështjen atje — i tha Liza, pasi e mori vesh rezultatin e oficinës. — Nuk është shaka një sondë-çekiç më pak, kur ne po preqatitim shpërthimin e madh...

Liza po fliste sikur të ishte në kokën e tij. Merko e shikoi me dashuri cullufen e deformuar e ende të patharë që i ishte mbledhur mbi ballë. «Shpesh po më ndodh e njëjtë gjë me ty, Lizë», mendoi ai. «Të dua, Lizë. Të dua shumë,» tha me vete duke e shikuar atë që mendohej e ngrysur mbi sondën-çekiç dhe mbi shpërthimin e madh. Ai qeshi, u shtrën-

goi duart atyre të dyjave dhe iku drejt zyrave të kantierit. Liza dhe Shpresa e shikuani një copë herë dhe diçka biseduan me njëra-tjetrën aty në hyrje të sektorit të montimit.

## II

Sonda ishte blerë shtrenjtë te një firmë e huaj. Ishte blerë sonda, por jo pjesët e këmbimit. Kështu që pérçapjet nëpër uzinat e qytetit qenë të kota. Çështja mbeti përmbledhjen punëtore. Merko rri e vret mendjen si t'ja gjejë anën kësaj pune, kur nuk e përkrah mendimin e tij inxhinieri mekanik dhe të tjerët si ai. Mbledhja kishte rrëth një orë që kishte filluar dhe ende nuk kishin dalë atje ku duhej. Dikush lëkundej me singeritet, dikush po-honte kot vetëm që të dilte optimist. Merko ishte mërzitur duke shikuar e dëgjuar diskutantët. Por kjo gjë nuk ndodhë me Pjetër Muranën. Ai, i ulur në një karrige pranë një maqine, gati në mes të oficinës dëgjonte me vëmendje çdo diskutant. Merko e kuption sekretarin e partisë. Ai e di se gjithë puna është që të prodhohet baterflaj këtu në këtë sallë, nga këta njerëz, nga ky kolektiv të rinjsh dhe mjeshtrish. Këtë e kuptione më së miri tanë Merko.

— Si thua, shoku Merko? — i foli Pjetër Murana duke vënë buzën në gaz. Merko shikon në fytyrën e Pjetrit diçka të re, ndonëse ai i ka mbushur me kohë të dyzetat. Merko ngrihet më këmbë. «Duhet t'u them copë këtyre,» mendon. «Është e këtë të kolovitem në shtjergullën e inxhinierit.»

Merko läviz nga ratifikja ku éshtë mbështetur dhe hedh sytë rrëth e rrotull. Ai i ndjen ato qindra vështrime që vijnë nga çdo qoshk i sallës së ofiqinës.

— Vështirë éshtë... Éshtë e vërtetë se duhet preçizion i lartë. Por...

— Bëhet! — ndjeu Merko zérin e rëndë e të mbytur që e njihnin të gjithë. I ati, mjeshtër pensionist, që nuk dukej këtej nga ofiqina veç me raste, thithë çibukun në mes të sallës. Mustaqja i ishte varur poshtë dhe Merko e kuptoi se i ati ishte i pakënaqur.

— Bëhet, pse mos të bëhet... — përsëriti plaku i tij.

Merkos i erdhi rëndë nga ndërhyrja e tij. Sigrusht që i ati humbi besimin jo vetëm te të rinjtë, por edhe te Merko. «Eh, more baba Sinaj. Sa pak besim që ke», e qortoi Merko me mend të atin duke shikuar fytyrën e tij që u vesh për një çast nga vellua e bardhë e tymit të llullës. I ati po mbushte gjashtë muaj që kishte dalë në pension. Kohët e fundit ai kishte kaluar edhe një pleurit. Megjithëkëtë ai nuk rri rehat në shtëpi, por vjen e rropatet gjithnjë këtej nga puna. «S'ke ç'i bën, éshtë mësuar kështu gjithë jetën,» mendoi Merko.

Merko e di jetën e tet, ashtu si fëmijtë ngjarjet e një novelëze. Ai e di se, kur ishte baba Sinaj gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë, kishte ikur nga atdheu si shegert i një kovaçi diku tej kufive dhe që kthyer pas mjaft vjetësh pa një grosh në xhep, por me zanat e me pak vegla pune. I ati éshtë njeri i talentuar për punë zanati, si i thonë fjalës. Dora e tij prodhon çdo gjë që i shikon syri. Dikur pat dëgjuar nga të tjerët se i ati në kohën e luftës pat rregulluar deri viaskat e maliherrit të një partizani. Të tjerët

tregojnë ende shumë gjëra për jetën e punën e tij, kurse ai nuk flet. Dhe ja tani flasin përsëri për pensionistin që nuk u bë shkencëtar kurrë. «Nuk u bë që nuk u bë im atë shkencëtar,» mendon Merko. «Ndoshta, po të kishte pasur rrethana të tjera që në rininë e tij, sot do ta mbyllte jetën e tij të lavdishme me të vërtetë si shkencëtar. Im atë është krenar për jetën e tij. Nuk është i penduar».

Merko e ka ndjekur pas në zanat për disa vjet të anë. E ka njohur vetë në punë. «Mos e kurse dorën sot, mor bir! Se sot ne e bëjmë për Shqipërinë tonë...» — ja pat përsëritur disa herë i ati Merkos këto fjalë. Merko e kuptonte mirë se i ati donte ta edukonte në këtë mënyrë. Ja këshfu, i tillë erdhi i ati deri në këtë hidrocentral ku doli në pension. Sikur u lodh plaku. Si u pa, pensioni, nuk qe për të. «Njerëz si ijm atë nuk jetojnë as edhe një çast pensionistë», mendoi Merko. Ai u mërzit që ditët e para. U mërzit aq shumë, sa një ditë erdhi po te ky Pjetër Murana me atë diçka rinore në fytyrë e që tani po buzëqesh tek e dëgjon me vëmendje.

Mbledhja sikur ka marrë zjarr. Plaku, shihet qartë, është me Lizën dhe të rinjtë e oficinës. Sa besim ka te puna dhe te duart e tija! Po sa u lë-kund te Merkuia.

— Bëhet që ç'ke me të... Gabim e kanë ata që thonë nuk bëhet... — tha i ati i menduar aty mes të rinjsh dhe se si i lëvizi duart përpëra. Merko i pa si dridheshin duart e tet nga njëfarë emocioni. «Është mosbesimi i tij,» mendoi djali. «Nuk beson, ndonëse i do të rinjtë».

— Xha Sinaj ka besim te djemtë — ndërhyri Pjetër Murana. — Ta provojmë me forcat tona njëherë. Si thoni? — ai shikoi rrëth e rrotull ata qindra

sy të vëmendshëm që kishin marrë pjesë në diskutim.

— Po. Bëhet. Duhet ta bëjnë djemtë tanë atë djall «butterflaj». E, po nuk e bënë, e bëj unë... — zëri i tij ishte si i marrur dhe i lodhur. «Do të ketë temperaturë», mendoi Merko.

— Derdhjen me rërë e bëj unë! E marr unë përsipër — foli njëri nga të rinjtë e oficinës.

— Më duhet një aliazh si ai i origjinalit. Unë do ta bëj punimin e tij me dorë — foli një i ri tjetër pranë plakut. Plaku Sinaj e shikoi me bisht të syrit dhe ngrysi vetullat e bardha.

— Limimin e bëj unë — tha një i ri që qëndronte shkujdesur fare pranë Merkos. I riu po fshinte duart me ca lecka të pambukta.

— Për termimin përgjigjëm unë. Do ta bëj ku të mundem.

Dikush shkruante pranë Pjetër Muranës. Merko ishte i sigurt se shokët e tij do t'ja dilnin mbanë fjalës së tyre. Vetë Merko e di mirë se nuk është e lehtë të prodhohet moduli i baterflajit, por nuk është e lehtë edhe të merret zotim kështu para të gjithë shokëve. Do të bëhet diçka, do të bëhet me siguri...

### III

Nga ajo natë i ati nuk u shkul nga oficina. Mirë i thonë fjalës «shyqyr që ndodhi kjo vdekje, që të takohemi përsëri». Mjaftoi ai detal që plaku të ngulej mirë në oficinë. Ai rrinte në punë me të rinjtë

gati gjithë ditën. Vetëm mbrëmjeve vonë shkonte në kapanon dhe binte në gjumë. Merko vetë i foli disa herë në ditët e para, por plaku Sinaj qeshi me të birin dhe e porositi të rrinte i qetë. Si po e shikonte Merko, plaku nuk do të largohej nga oficina pa e prodhuar baterflajin. Ditët po kalonin dhe prodhimi i detalit po vonohej, kurse Merko e shikonte të atin si dilte qetë-qetë mes të rinjsh nga oficina dhe drejtohej për në mensë.

Kishte të rinj që qeshnin dhe i uronin xha Sinajt rikthimin e tij në punë. Merko e dinte se plaku i tij nuk ishte nga ata punëtorë që mendojnë se pa ata shembet kantieri. Jo, plaku i tij nuk ishte i tillë. Sigurisht që i ati po bënte provën e madhe me energjitet e tij. Ai nuk donte as ta mendonte e jo më ta besonte se rropatja e tij ishte e kotë.

Nga këto rropatje në të tria turnet, kohë e pa kohë në oficinë, Merko e gjeti plakun një mëngjez me temperaturë të lartë. Tre të rinj i rrinin pranë te krevati. Të tjerë kishin shkuar të merrnin maqinën për ta dërguar në spital. Plaku herë-herë fliste diçka me zë të mbytur që nuk merrej vesh. Pastaj e çuan në shtëpi, ku erdhi menjëherë mjeku dhe nisen kurat e vjetra. Atë natë, pas disa orësh, plaku u bë më mirë dhe mjeku nuk e shtroi në spital. Kështu që ai mbeti nën kujdesin e së shoqes.

Merko e ndiqte me interes dhe kishte vërejtur se ndonëse shumicën e kohës ishte i qetë dhe rrinte shtrirë si njeri i lodhur nga puna, mbrëmjeve keqë-sohej dhe i hipte zjarrmia. Atëherë plaku fliste pa kuptim, dhe djali pendohej që nuk e kishte shtruar në spital. Por, sa ja sillte mjekun, plaku përmendej dhe ndodhë që e merrte veten e qëndronte aq mirë, sa mjeku e këshillonte Merkon që ta kishte nën kuj-

des vazhdimisht, por të mos shqetsohej për të. Çdo mbrëmje Merko mblidhej në shtëpi dhe në çaste temperature dëgjonte plakun që fliste mbi çekiçin e sondës së huaj, mbi baterflajin, mbi... Kështu që Merko ditë për ditë, kalonte nga oficina dhe intesohej për ato që shqetësonin plakun. Kur e gjente mirë, i tregonte ashtu rastësisht për ato që kishte parë në oficinë. Plaku gëzohej dhe buzëqeshte nën mustaqen e lodhur.

— Do ta mbarojnë edhe baterflajin, do ta mbarojnë... — i tha ai djalit, pasi dëgjoi për sukseset e oficinës.

— Ajo mbaroi sot, baba. Por s'po gjejmë dot mënyrën e hapjes së kanalit të brendshëm për thepin pengues... — ja priti Merko.

Plaku u vrenjt.

— Nga brenda nuk bën, se thepi del... — shtoi djali.

— Ta bëjnë nga jashtë. Edhe ata të origjinalit nga jashtë e kanë shpuar me siguri. Thepi duhet të vijë deri në gjysmë të rrezes së detalit. Pjesa bosh do të mbushet pastaj. Kështu thepi nuk del më, veç po të thyhet.

— Të falem nderit, baba! Po shkoj që sonte atje. Na dhe një ndihmë të madhe — i tha djali.

Ndërsa Merko vishet, plakut i është ndehur një gjëzim e krenari në fytyrë. Ai e përcjell të birin me atë shikim, tek del nga shtëpia.

Detali u prodhua e u riprodhuva disa herë sepse nuk jepte rendimentin e origjinalit. Merko i sillte lajmet plakut gati ditë për ditë. Dikur u prodhua një aliazh që i përshtatej detalit dhe dha rendimentin qind për qind e sonda e shpoi shkëmbin përsëri po aq thellë, sa në fillim. Natyrisht që Merko u

gëzua tok me shokët, se tani po i përvishej përsëri punës për shpërthimin e madh.

Ndërkaq plaku Sinaj e mori veten dhe në ditë të mira dilte deri në verandë e rrinte. Mjeku i lagjes, që vinte me shkas e pa shkas, fliste gjithnjë fjalë shpresëdhënëse, por nuk e lejonte kurrsesi të rrinte gjatë në verandë.

Një pasdreke Liza e gjeti Merkon në klub. Djali pa tej dritares shoqet e saj që pritnin.

— Pse nuk i more shoqet, do të na shpenzosh?  
— e pyeti ai, sapo vajza ju afrua. Ajo tundi kokën dhe cullufja e flokut i lodroi mbi ballë.

— S'dua ëmbëlsira. Dua ty... — Ajo gati i pëshpëriti fjalët.

— Do të më hash?

Vajza qeshi, ndërsa Merko e ndjeu se ajo e donte shumë.

— Ç'flet kështu? Sonte do të vish në shfaqje. Është një koncert i madh jubilar. Merri këto dy biletë, njëra është për Kadrinë. Jashtë më pret Shpre-sa me shoqet... Mos harro: tjetra është për Kadrinë — tha dhe ja vendosi biletat në dorë e iku qetë-qetë.

Në klub kishte shumë ecejake, tym duhani dhe zhurmë. Vinte erë tallashi që njomej nga çizmet e përzihej me llucë. Merko u nis të gjente Kadriun. Por, ndonëse u lodh duke e kërkuar, nuk e gjeti kund, kurse urbanet e fundit po niseshin për në qytet. Tani, o duhej të shkonte, o të rrinte edhe vetë pas Kadriut. Koncerti fillonte pas dyzet minutash. «Po shkoj, ndoshta është nisur përpara,» mendoi Merko. Ai hipi në urban, gati në nisje e sipër. Kështu që nuk pati kohë fare të shkonte deri në shtëpi e të shikonte plakun Sinaj. Lizën dhe shoqet i gjeti tek prisnin në hyrje të teatrit dramatik. Ato i tërhoqën

vërejtje për Kadriun. Merko e kuptoi këmbënguljen e Lizës, ishte Shpresa. Tani i tingëlluan ndryshe fjalët që i tha Liza në klub. «Po ç't'i bësh këngëtarit të Deas?» — qeshi me vete Merko. Kur e kërkon, s'e gjen dot Kadrinë; kurse kur s'ke punë me të, e ke gjithë ditën me vete si baltën në çizme».

Të rintjtë zunë vendet në sallë. Merko, ndenjur mes vajzave, dëgjonte se si ato qeshnin me një zonjë, veshur me mantel demode që kishte hyrë me vonesë dhe qe ulur aty afër tërë naze. Koncerti me të vërtetë ishte i bukur dhe Merkos i pëlqeu, por vajzat vazhdonin të qeshnin me zonjën që tani e kishte hequr mantelin dhe zgjaste qafën e saj të dhjamur tërë vijëza si brazda të një are private, punuar me parmandë. «Kjo zonjë me siguri mundohet që të duket edhe një herë e re», mendoi Merko. «S'e kanë keq këto që qeshin me të.» Herë-herë Liza i afrohej djalit për t'i thënë diçka dhe Merko ndjente peshën e krahut të saj të butë mbi sup. Ai e ndjente dashurinë e vajzës më shumë se sa kujtonte ajo. «Ne djemtë jemi si guakë në dashuri. Ne nuk dimë t'i shfaqim ndjenjat, nuk dimë të flasim shumë. Ndryshe është me vajzat. Ndoshta kjo ndodh vetëm me ne punëtorët,» mendoi ai dhe gati qeshi duke shikuar Lizën. «Sa mirë kuptohemi ne të dy! Ah, Lizë, Lizë! Veç kështu të dua unë! Të tillë! Çamarroke, me këtë cullufen mbi ballë, me këto duar të vogla topolake...»

— Dëgjo koncertin! Këngë e bukur — i tha ajo që e pa se ai po e vërente.

— Po. Këngë e bukur — i tha. — Kjo këngë ka jetë...

Në çast një dorë e zuri për supi. Ai ktheu kokën i hutuar dhe pa Kadriun.

— Në shtëpi — shpejt! Xha Sinaj është keq...  
— i tha ai. Merko nuk foli, por u ngrit.  
— Xha Sinaj? — pyeti Liza.  
— Po. — Kadriu nuk lëvizi nga vendi.  
— Ulu, or shul! Ose kris jashtë... — foli njëri prapa tij.

Kadriu u kthye andej dhe shikoi.

— Cila është ajo nuse që kërkon takim? — pyeti. — Njerëzit nisën të qeshnin. Dikush tjetër, a ndoshta ai i pari, shau përsëri «në mënyrë të kulturuar» e me zë të ulët. Liza me shoqet po dilte. Merko e vuri përparrë Kadriun se mos ngrihej ndonjë i krisur dhe i vinte në «takim».

— Si janë punët, Kadri? — e pyeti Merko porsa dolën jashtë.

— Keq. Shpejt!

Të rintjtë shkuan gati me vrap në shtëpinë e Merkos. Merko hyri nxitimthi dhe pa nënën që rrinte pranë Pjetër Muranës. Aty ishin shumë minatorë të turnit të parë dhe shumë nga ata të oficinës. Sinaj dukej sikur flinte.

— Nënë... — tha Merko duke e gjelltitur fjalën.  
— Shoku Merko, qofshi vetë... — ju drejtua Pjetër Murana.

— Nënë, kur?..

— Ishte mirë, bir — i tha nëna duke hyrë njëherësh në shpirtin e tij të trazuar. Para tri orësh u bë keq dhe telefonova në kantier. Por gjetëm shokun Pjetër dhe... I erdhi shpejt. Ishte mirë, bir...

— Ne e gjetëm me fjalë në gojë. U gjëzua kur na pa. Diçka foli për formën e një guide çekiçi për sondat tuaja. Pastaj...

Dhoma është mbushur plot e përplot. Minatorët

vijnë dhe shkojnë pjesë-pjesë. Plaku po hesht mes tyre. Të gjithë e dinë se ai edhe në çastin e fundit ka patur diçka për të thënë. «Si qëlloi kështu? Si nuk u mendova asnjëherë se im atë mund të vdiste?» — pyeti veten djali. «Kaq i lidhur të jem pas jetës, sa të harroj se ekziston vdekja? Po kështu, ndoshta, ndodh gjithnjë me njeriun,» mendoi Merko.

#### IV

Retë e bardha vinin me nxitim grumbuj-grumbuj dhe copëtonin këmbët mbi kreshtat e malit. Merko po ngjitej në skarpatën e depresionit tok me Kadriun. Ishte e shtunë e ngrirë dimërore, dita e shpërthimeve të mëdha të minave.

Kadriu ecën pranë tij dhe fërshëllen melodinë e këngës së tij. Parasysht, në kryqëzim të rrugës, si mënjanë ishte ndaluar një buldozer i rëndë. Pranë tij Liza dhe Shpresa. Merko mendoi të mos ndalonte, por ajo la punën dhe fshiu duart, ndërsa e shikonte me vërejtje. Tani Merko e dalloi mirë melodinë që fërshëllente Kadriu.

«*Dea është e re,  
Dea është e bukur.  
Ajo dashuron  
Një minator nga ne...»*

— Zjarrdhënësin tonë... — plotësoi Merko. — Pse nuk po e këndon këngën me fjalë? Sikur nuk ta kam dëgjuar këto ditë...

— S'më ka rënë në mendje. Kur nuk jam në qejf, nuk këndoja — tha. — Njatjeta, vajza.

— Merko! — dëgjuan ata zërin e Pjetër Muranës. Merko pa sekretarin tek vinte pas tyre. Flokët ja merrte era e ftohtë dhe ja përndante duke i zbuluar ballin e madh e të gjerë. «Sa ballë të madh që ka,» mendoi Merko. «E pra, punëtor si ne është. Kot llomotitin se vetëm intelektualët kanë ballë të madh... Dhe pleqtë. Dokrra!»

Pjetri u përshëndet me ta, pastaj u tha ta linin punën se shpërthimi i madh javor nuk kishte as njëzet minuta. Vajzat mbyllën pjesën motorike të buldozerit dhe mblodhën veglat e tyre. Të gjithë tok po ngjitnin rruginën drejt kapanoneve njëri pas tjetrit. Liza ecte përpara Merkos.

— Ku do të strehohesh gjatë shpërthimit? — e pyeti ajo.

Djali shikoi në sytë e saj diçka të butë dhe fëminore.

— Te dy shkëmbenjtë e bardhë. Është pak afër, por sot është shpërthim vertikal me detonant në krejt rrjetën e pusetaive. Zor se arrin deri aty tollovia e shpërthimit — i tha Merko.

Vajza shikoi kurrizin e kodrës që varej nga mali. Matanë kodra ishte veshur nga një pyll njerëzish. Kodra ishte shkëmbore, prej shkëmbenjsh të bardhë gëlqerorë, por ata mijëra njerëz, që dislokoreshin në të gjatë shpërthimeve, ja ndërronin ngjyrën, sikur i jepnin jetë.

— Ata dy shkëmbenjtë janë të murrmë, si të zinx... — tha Liza.

— Të duken ashtu nga hija ereve, po ata janë të bardhë — ndërhyri Pjetër Murana. Pastaj ai u ndal me ca montatorë. Katër të rinjtë u përzien me

grupe të mëdha punëtorësh, u shkrinë njësh me ta. Pas pak morën përpjetë brinjës së kodrës ku ishin shkëmbenjtë.

— Ej, ndaloni me ne! Ku po shkoni, apo të zini qielin? — u foli inxhinieri mekanik i oficinës, i cili ishte shtrirë buzë pérroit. Të rintjtë vazhduan edhe pak, pastaj Kadriu u kthye:

— Do të të shikojmë ty, inxhinier. Do të të shikojmë nga lart-poshtë. Do të jetë diçka interesante... Si thua?

— Ju vaftë mbarë! — qeshi inxhinieri.

Të rintjtë u ndalën te shkëmbenjtë. Kjo ishte pika më e afërt. Njerëzit, në shumicë, ishin vendosur në kodrën tjetër. Më këtë anë të pérroit ishin fare pak, kurse këtu te shkëmbenjtë ishin vetëm katër të rintjtë. Merko u ul mbi shpinën e shkëmbit. Liza qëndroi aty pranë tij. Kadriu shtriu këmbët dhe u mbështet në bërryl e nisi të luante me një gur, kurse Shpresa mbështeti shpinën te Liza për t'ju mbrojtur erës. «Të katër presim këtë shpërthim,» mendoi Merko. «Sot duhet të arrihet kuota tre mbi nivelin e detit. Do të arrihet pa tjetër. Dhe së shpejti do të vendoset ajo sallë që ne qysh sot e thërrasim «salla e turbinave». Askujt nga ne s'ja merrte mendja në fillim se ishim në gjendja ta shembnim këtë mal plak dhe të ngrinim një mal të ri prej betoni, vetëm e vetëm për atë sallë që do të rrezatojë për gjithë vendin», mendoi ai.

— Sa më pëlqen ajri këtu në lartësi! — tha Liza.

Kadriu i humbur në mendimet e veta dhe nga lodhja, e shikoi dhe nuk foli. Shpresa qeshi.

— Kadri, na këndo këngën e Deas... — i tha Merko.

Në çast gjëmoi, sikur malit vetë ju thyen esh-

trat dhe u drodh. Follanga tymi dhe pluhuri të murrmë e të zi, ku shkëlqenin për një çast shkëmbenj të çarë që fluturonin qindra metra lart dhe binin me të atillë shpejtësi, që Merkos nuk ja kapte dot syri. Liza, duke shikuar atë tollovi të mahnitshme që e kishin pregetur minatorët me aq djersë, u trondit. Ajo mbështeti dorën e saj të vogël mbi dorën e Merkos dhe e shtrëngoi gati pa vetëdije. «Kjo është emocionuar, ose frikësuar nga shpërthimi dhe nuk shikon si e vëren Kadriu,» mendoi Merko. «As-kush më shumë se ne minatorët, nuk e shijon bukurinë e egër të këtij shpërthimi të llahtarshëm.»

Pas pak çastesh mbeti vetëm një masë tymi e pluhuri që notonte pezull si re e zezë mbi kantier.

— Në Fierzë do të jetë edhe më bukur... — tha Liza duke mos ja lëshuar dorën, ndërsa tollovia po binte.

— Atje, sigurisht, do të bëhen shpërthime më të mëdha — ju përgjegj Merko.

— Do të vish atje?

— Po ti?

— Ku të shkosh ti...

— Mos u bëni merak, se edhe ne me vete na keni... — tha Kadriu i menduar pa e prishur terzinë fare.

— Ti i bën hesapet pa hanxhinë, or qyq... — i tha Shpresa dhe uli sytë se Kadriu u ngrit menjëherë.

— Mos thashë ndonjë gjë të re? — e pyeti përsëri Kadriu, ndërsa Shpresa u nis.

Merko shikoi Lizën. Sytë e saj dukeshinë e ndërrimtarë. Dukej se ajo ende shijonte bukurinë e llahtarshme të tollovisë. Cullufen kapriçioze ja merrte

era dhe lodronte sipas qejfit mbi ballin e paqtë.  
Dora e vogël sikur kishte gjetur ngrohtë aty në  
dorën e tij. Merko e shikoi atë me dhimsuri. «Kjo  
është vajza më e bukur dhe më e mirë,» mendoi ai,  
ndërsa era dimërore lodronte mbi ballin e vajzës.

## DY ORIGJINALËT

Shtabi u përqëndrua pranë majës së malit. Aty vendi ishte i zhveshur dhe vetëm në pranverë, siç dukej, mbulohej nga bari qumështor i zonës çizalpine. Pylli i pishave ishte më poshtë.

Cadrat u ngritën me shpejtësi dhe toga e sanititet ja mori me gjumë, **sapo nxori postërojet**. Dotë flinin dy orë. Në postëroje vajzat nxorën tri shoqe dhe Vjollcën a Vockën, si e thërrasin ato, mësuesen e re trupvogël. Dikush u ankua. Komandanti nuk foli. Ai shikoi si me inat dhe përcëmim atë që foli. Vocka e shikoi shoqen **po me atë syrin** e komandanit. Shoqja ishte vajza e permanentit. Në qytetin e vogël krahinor u hap edhe dyqani i permanentit dhe u derdhën vajzat dhe gratë atje, po Vocka nuk shkoi. Ajo nuk e honepste dot vajzën që punonte aty, jo pse ajo ishte më e bukur se Vocka, jo pse Vocka dukej si fëmijë para saj, jo. Por Vocka e kishte inat ashtu kot. S'mund ta honepste dhe nuk shkonte atje asnjëherë për të prerë flokët. Ajo i pret vetë flokët në dhomën e beqareve. Shoqet bëjnë vërejtje, qeshin rrith saj, kurse ajo kërrç-kërrç i pret vetë, dhe te vajza e permanentit nuk shkon. Prandaj ajo e shikoi si me inat e zemërim vajzën që foli, se pati frikë mos i qëllonte asaj radha e rojes.

Kështu që rezervistja Vockë mbushi krehërin e automatikut dhe iku tok me tri shoqe në postëroje, pa fjalë, duke bluar në kokë diçka jo të mirë për atë të permanentit. **Ajo u vendos në veri** të çadrës së komandës, tamëm në grykën e rrugës që vinte poshtë nga pylli i pishave. Kurs tri të tjerat zunë pikat ku nuk i lëpinte era.

Asaj i duket se thëllimi dhe errësira po i shpojnë syfë. Vajza mbështetet në shkëmb dhe përgjon. Ajo e di se nuk duhet të lejojë asnjë lëvizje. «Me të vërtetë është stërvitje kjo, por rregullat nuk janë kot,» mendon ajo. «E keqja ndodh njësoj, në çdo kohë». Prandaj ajo e gjykon me vend t'i fusë automatikut fishekun në gojë dhe t'i ulë sigurecën. Tani ajo është gati për çdo të papritur. «Ama edhe kjo kohë e bukur, tash në janar...», mendon Vocka që e kishte parashikuar stërvitjen me furtuna dëbore dhe vështirësi të jashtëzakonshme. «Janari po kalon. Kjo është dita e gjashtë e stërvitjes, kurse bora s'po duket. Kohë tamam pér ne,» mendon Vocka. Në fillim, të gjitha mësueset në dhomën e beqarve mezi e priten borën, pastaj, kur morën fletëthirrjet e stërvitjes, u trembën prej saj dhe grumbulluan ku nuk ishin gjithë xhupat e leshtë e queskat e sheqerit. Se pér marshim hyka shumë në punë sheqeri. «Eh, ç'budallaçka që jemi ne», mendon Vocka dhe nxjerr duart nga dorashkat e lëkurta me lesh përbrenda se ato i shpojnë duart. «Dorashkat e tij! Sa egoiste që jam,» mendon ajo duke kujtuar të fejuarin. «Ja mora dorashkat pa të keq. Kurse ai m'i dha tërë gjëzim. Dhe sonte kushedi se ku është... Mirë në shërbim që nuk gjen kurrë qetësi, por edhe këtu në stërvitje? Si ja gjejnë atij punën më të vështirë? Por ai e kërkon vetë...» — Vocka është përmalluar pér të fejuarin.

Duke menduar kështu, ajo fshin syrin që ja ther veriu i mprehtë dhe qesh me vete. Ajo kujton atë çast që do ta mbartë tërë jetën me vete si gjéné e saj më të çmuar.

...atë mbrëmje ajo shkoi në sallën e teatrit të estradës tok me gjithë shoqet e dhomës së beqareve. Të gjitha u veshën, veç Vocka jo. U pa në pasqyrë si gjithnjë. Sytë e zez e të gjallë i shkëlqyen nën ballukan që i fshihte ballin. Ajo i rregulloi flokët me duar. Tundi kokën për t'i çuar në vend ca fije të pabindura dhe ja krisi gazit me zë të lartë, kur Leti u tha të tjerave: «Shikoni, vajza. Vocka te pasqyra!»

— Hajt, budallaçka, se po na mbylllet dera — u tha Vocka. — Kanë vënë rregull si në Tiranë. E mbyllin derën pesë minuta para fillimit të shfaqjes. Ja, kështu u nisën e shkuuan.

Në fillim të pjesës së parë pati qetësi dhe Vocka u detyrua të rrinte serioze. Kurse ajo kishte nevojë të qeshte. E qeshura sikur e ushqente atë. «Kot nuk më thërrasin Vocka dhe jo Vjollca», mendon ajo përveten, ndërsa veshi i saj përgjon mos dallojë ndonjë zhurmë të veçantë nga oshëtimi e veriut mbi pyllin e pishës atje poshtë. «Në estradë të qeshurën e blejmë një lek e pesëdhjetë qindarka, jo shaka,» qesh me vete Vocka duke shtrënguar automatikun më pranë.

Atë mbrëmje Vocka e ndjeu se po e vriste në shpirt qetësia e sallës si në tragjeditë e Shekspirit. Kjo gjë nuk i pëlqeu Vockës. Deri atë çast vajza kishte heshtur dhe priste me padurim të dilte njëri nga aktorët. Po e humbi durimin. Ai ndoshta s'kishte numër fare, kurse premierën po e merrte e mira. Po ikte pjesa e parë pa asnje çikëz të qeshur. «Kësh-

tu s'bën», mendoi ajo atëherë. «Duhet gjetur këtu rrëth e rrotull». Prandaj zuri të kërkonte ndonjë «numër». Dhe e gjeti. E gjeti aty para saj. Aty rrin dy «origjinalët»... Ata të dy kishin ngritur skenën e tyre një radhë para saj. Njëri, kaçurrel e zeshkan, me ca buzë pak të trasha, flinte si bebe mbështetur në supin e shokut. Kurse tjetri, shumë serioz, me ca vetulla hark e ca sy të menduar, vazhdonte e vazhdonte të lexonte një libër në gjysmë-errësirë. «Eh, ç'fatmadhe që jam», mendoi Vocka atëhere. «Ja estrada, dora vetë! Shiko seç punojnë. Qëllimiشت për të dalë «origjinalë»... Tani ua ndreq unë samarin të dyve». Pickoi shoqen që kishte pranë: — Leti — i tha — Bebjë im po fle. Mos qesh, se po ma zgjon... — Kurse imi po lexon abetaren — ja ktheu Leti: — shkronjë e madhe e dorës, shkronjë e vogël e dorës... — u tall ajo duke u tërhequr vëmendjen dy shoqeve të tjera. Kaq u desh. Vajzat qeshën me zë. Në skenë solisti, që këndonte, e ngriti zërin i dehur nga suksesi. Ishte finalja e të gjitha këngëve që u kënduan. Por bebjë nuk e prishi terezinë. Kishte gjetur rehat mbi supin e shokut dhe sigurisht që shikonte në ëndërr diçka më të bukur. Origjinali tjetër, që i dëgjoi të gjitha, ktheu faqen e librit, shikoi ftohët Vockën dhe vazhdoi leximin.

«Me gjithë mend e ke?» — i pëshpëriti Vocka.

«... por jo me ty...» — hyri në duel ai.

Vajzat qeshën. Tani në skenë po këndonte një solo të lehtë shoqja e tyre. «Kusur e paç», mendoi Vocka dhe e gjykoi me vend të vazhdonte programin e vet.

— Po ky Bebjë i shkretë, seriozisht e ka? — e pyeti përsëri ajo origjinalin e thelluar në libër.

— Kur të zgjohet, do ta pyes. Po e pati seriozisht, veç me ty e ka... — i tha ai ftohët.

Vajzat qeshën përsëri, por tani nuk ishte keq. Kishte edhe të tjerë që qeshnin.

— Po sikur të shembet tavani, si do t'ja bësh Bebes, moj Dado e mjerë? — Të dyja nofkat i gjeti Vocka vetë. Vajzat qeshën me të madhe. «Kjo nuk ishte batutë, por bombë», mendoi ajo me krenari.

— Zgjohu, origjinali im! — i foli Bebes që flinte. Bebja hapi sytë i shqetësuar.

— Ç'është? — pyeti Dadon ai. Dhe Dadua ktheu sytë pas e tregoi Vockën që po rrinte serioze, tek gajaseshin vajzat. Bebja qeshi dhe në këtë çast të bardhë ajo pa e mahnitur dy sy të lodhur e të shqetësuar që duke shin sikur po i kërkonin ndjesë. Ai queshte aq çiltër, siç qeshin foshnjet. Lëvizte i shqetësuar në karrige. Diçka i thoshte Dados që vazhdonte leximin: «Tamëm bebe», mendoi atëherë Vocka. «E ku ta dija atëherë se do të fejohesha me të?» — pyeti veten vajza, humbur në èndërrimet e saj, aty mbështetur për shkëmb, tek përgjonte çdo tingull të pazakonshëm.

«Po ai ashtu është, si bebe», mendoi ajo. Prandaj e thérret ende veç bebe e asnjeherë Beqo, sikurse edhe ai, që veç Vockë. Por atëherë hynë në valle edhe Leti me shoqet... .

— Vajza, sigurisht që sonte në Tiranë luhet «Mrika» e Prenk Jakovës. Thonë se karrigat kanë mbetur bosh... — u tha Vocka. Vajzat qeshën. Bebja u kthyte pas. Përsëri shkëlqyen sytë e lodhur dhe qeshi si foshnje, por nuk foli. Dadua foli i qetë e serioz, pa e ngritur kokën nga libri.

— Na kanë marrë për «origjinalë»... Tregoj asaj seriozes aty pas se nga ke ardhur sot.

— Sot... — përsëriti Bebja dhe e shikoi vajzën në sy.

— Kthehu para! — i foli atëherë Vocka me se-riozitet, ndonëse kishte qejf që ta shikonte përsëri si qeshte ai.

— Sot vij nga ekspedita. Raportin e punës e rezervoj për në mbledhje... — qeshi Bebja.

— Shiko, shiko. Bëka edhe shakara Bebja!... Po ti, Dado, s'po qesh hiç? Po mbyllët sipari... — i ngacmoi vajza përsëri. Atëhere Dadua u kthyte.

— Meqë je kaq këmbëngulëse, prezantohem: Martin Kastrati, inxhinier ndërtimi. Aspak origjinal!

Bebja, pa qejf mërmëriti pa e kthyer plotësisht kokën: — Beqir Morina, inxhinier gjeolog.

— Unë jam Vocka. Kjo — Leti. Ajo Shpresa dhe tjetra Ana: të gjitha merremi me bebet e shkollës. Qartë? Kurse ju prapëserapë mbeteni Bebja dhe Dadua..., — por Vocka kaq u tha, se djemtë qeshën me zë dhe të gjitha shoqet nuk u përbajtën fare. Kështu ndodhi...

Kur dolën nga shfaqja, dy djemtë vinin pas tyre. Pastaj ata u larguan dhe humbën mes njerëzish, kurse vajzat vazhduan qyfyret. Sidoqoftë Vocka mori vesh nga Leti mjaft gjëra interesante mbi ata. Kështu Bebja vinte rrallë në qytetin e vogël, por flisin mirë pér të. «E zgjedhin në presidiume mbledhjesh. E kam parë një herë vetë, kur shkova me pionierë pér një përshëndetje — i tha Leti atë natë. — Atë e lavdëronin, se kishte zbuluar diku mes malesh një minierë...»

«Jo minierë, por mineral» — e korrigjoi njëra nga vajzat Letin.

«Për minierë flitej atëherë... — nguli këmbë Leti. — Kurse Dadua projekton pallate dhe rrugë të reja në urbanistikë...»

Të nesërmen dhe më vonë Vocka e pa më shpesh

në qytet. Përshëndeteshin, kalimthi bënин edhe ndonjë shaka. Një herë Bebja e gjeti rastin. Vocka po kthehej vetëm nga shkolla. Ai e ndaloi në rrugë në mënyrë shumë zyrtare, por që nuk i shkonte fare se qeshte si foshnje. Donte t'i pregatitnin një grafik. Vajza i shtroi menjëherë e zyrtarisht kërkesën e saj për kampionet e mineraleve të kësaj krahine të «egër». Sytë e Bebes sikur u futën brenda dhe ju ftohën kurse balli ju rrudh. «Edhe kështu është i bukur, dreqi...», mendoi Vocka atë çast, por e kuptoi se ai u prek.

— Kampionet jua sigurojmë. Pse jo — i foli Bebja me seriozitet. — A mos e di nga bie ajo krahina e butë, ku lulëzojnë lulet e rralla? — pyeti ai ca me «ju» e ca me «ti».

— Atje ku ka minerale të rralla, shoku Beqo — qeshi Vocka se e pa që Bebes nuk i pëlqeu fjala «e egër» për krahinën. — Tjetër herë vërë kollaro, Bebe! Thuaj edhë Dados të t'i hekurosë pantallonat.

Bebja qeshte, kurse vajza e shikonte. Ata ecën pak rrugë tok, por ranë menjëherë në sy kalimtarësh. Në qytetin e vogël bie në sy menjëherë. Gati në të ndarë, ai i tha ato fjalë...

Diku u irrokullis një gur. Vocka e ndjeu atë, ndonëse oshëtima e veriut vinte dallgë-dallgë prej pyllit me pisha.

— Ndal! — britma e Vockës çau ajrin e ngrirë si krismë dhe u ul poshtë në pyllin që oshëtinte. — Parullën?! — klithi vajza, ndërsa kishte hequr dorashkat e ngrohta dhe drejtoi automatikun duke zë-në pozicion në shkëmb. Gurin e kishte rrökullisur një njeri. Ai po ngjitej vetëm fare. Nga britma e rojes ai u ndal për një çast.

— Shqiponjat! Kundërparulla? — nga zëri nje-

riu ju duk vajzës se ishte i lodhur e i raskapitür. Ajo u mendua një çast, pa e humbur pozicionin dhe personin nga shenjestra. Zëri ju duk si i njojur, si i Bebes, por i ngjirur, i marrur.

— Yjet! Afrohu dhjetë hapa... — i tha vajza, ndërsa automatikun dhe pozicionin nuk i lëshoi. Ajo ndjeu se arma po i ngjitej për duar. «Duhet të jetë ulur shumë temperatura», mendoi. Kur njeriu u afrua disa metra pranë shkëmbit, ai foli me zë të ulët e si me të qeshur.

— Pse nuk thërret oficerin e rojes?..

Tani vajza e njoju. Ishte ai.

— Bebe... — foli ajo me zë të ulët.

— Vockë, ti qenke?

— Eja, Bebe! Eja këtu! Çdo rregull ka një përjashtim... .

Ai sikur u çudit në fillim, diç mendohej. Pastaj lëvizi drejt saj. U përshëndetën dhe ai u ul aty pranë saj mbi shkëmb.

— Me ty kam qenë në postëroje deri tani — i tha Vocka. — Se si m'u kujtua ajo premiera e es-tradës.

— Cila? Oh, po. Kisha dy net pa gjumë. Kishim një avari në një sondë të minierës N. Isha lodhur dhe mië zuri gjumi: fajin e kishte Dadua që na preu biletat... — Djali qeshi, por Vocka nuk e pa dot se i pështillte errësira. «Sigurisht si atë natë qesh», mendoi ajo. — Edhe sonte ky është i raskapitür. «Zgjohu, origjinali im! Mos fli pranë meje! Edhe unë kam bërë pesëdhjetë kilometra malore më këm-bë sot. Unë dua që ti të qeshësh gjithnjë si foshnjë dhe gjithnjë të të shkëlqejnë sytë. Është lodhur. Qenka dërmuar fare», mendoi.

— Nga vjen kështu? — e pyeti vajza.

— Mos më pyet. . . Sonte kam bërë gafë që nuk do ta shlyej me asgjë. . . Më duhet të shkoj në shtab, t'ua kallëzoj të gjithëve. . .

— Çfarë?

— Shtabi më ngarkoi detyrën që të udhëhiqja togën e zbulimit dhe tok me të gjithë batalionin e tretë. Natën humba rrugën në Pyllin e Ujqërvë. I futa gjithë njerëzit nëpër rrugën këmbësore të një gremine, nëpër të cilën, po kalove një herë, të dytën nuk kalon më, edhe sikur të të vënë tytën e mitralozit në gjoks. . . Gati humba gjithë njerëzit. . . A më kupton, Vockë?

— Të kuptoj, po ti a ishe me ta?

— Isha i pari. Sa para bën. Edhe po të më ndodhët gjë mua, njerëzit përsëri ishin në rrezik, se andej nuk kthehet dot mbrapa. Vdekja të sillet mbi kokë nga të gjitha anët e greminës. Se si shpëtuam, as unë nuk e di. Mirë unë, që jam mësuar të udhëtoj si mushkë nëpër ekspedita, por nënreparat. . . Kaluam të gjithë, por gjithë faji rëndon mbi mua. . .

— Bëtë apel? — vajza ndjeu natën dimërore që ja kaloi gishtat e padukshëm nëpër trup. Gishtat e natës ishin të ftohtë si fërshëllimat e veriut mbë trup të pishës.

— E bëmë tani aty poshtë në përrua. Një orë rresht veç me apelin u morëm. Kontrolluam emër për emër çdo skuadër. Ishin të gjithë. . . A mos e ke parë Dadon?

— Kishte montuar trapin për kalimin e lumenjës dislokimin e nesërm. Ishte gërvishur pak. Shkoi ta mjekonte Leti. . . — vajza qeshi. Bebtja u zgjat dhe e puthi në faqe. Ajo nuk lëvizi një çast, por ai nuk e puthi më.

- Këtu bën shumë ftohët — tha ai.
- Merri dorashkat... — i tha vajza.
- Ke nxehtë?
- Nganjëherë, sipas rastit. Kur të kam... Kur do të martohemi? — Vocka ndërroi mendim. Ajo desh t'i thoshte: kur të kam pranë ty, nuk kam ftohët, por ju duk më e arësyeshme ta pyeste për atë gjë që ajo nuk e vriste mendjen fare. Por ja që Bebja e mori me seriozitet.
- Kur do të martohemi?! — pyeti ai i çuditur.
- Sa të mbarojmë stërvitjen. Marrim një dhomë diku dhe...
- Pse nuse me lecka do të bëhem unë? — vajza vazhdoi ta ngacmonte Beben.
- C'thua? Unë do të të çoj në shtëpi. Nja një muaj do të çlodhemi atje...
- Pastaj përsëri këtu... — plotësoi Vocka.
- Sigurisht, derisa të më dalë emri për tjetër-kund.
- Ke lindur veç për malet, Bebe...
- C'të bëj, Vockë? Ja që mineralin e mbajnë malet në gji.
- Po — ja ktheu vajza. — Mineralin e rrallë e mbajnë malet në gji...
- Po flet me figura si poete — qeshi Bebja.
- Poet është ajo Dadua jote. Më duket ja ka marrë mendjen Letit me atë origjinalitetin e tij...
- Ai e dashuron Letin.
- Pse nuk ja thotë?
- Si t'ja thotë? Dashuria e vërtetë nuk thuhet.
- Thuhet, thuhet. A të kujtohen ato fjalët e tua?.. «Vjollca, a më beson mua? Mendoju, pastaj tregomë...» E, Bebe, a më the kështu?

— Si urdhëron, shoku manjetofon. Pikë për pikë! — ai qeshi.

— Dhe unë të kuptova. Sigurisht që nuk e kishe vrarë mendjen për ato fjalë.

— Sigurisht.

— E pra. Edhe Dadua duhet t'ja thotë dy fjalë Letit. Mjaft më me libra e me shkrimtarë. Leti ëshië vajzë e mirë...

— Kjo punë varet prej tyre, Vocka. I treti është gjithnjë i tepërt.

— I treti nuk është i tepërt. Atë Dadon tënde këje kujdes, se si shumë origjinal po qëndron.

— Mani... — djalit ju hap goja. Vocka përsëri desh t'i thoshte «zgjohu, origjinali im!», por ndërroi mendje. Ai ishte i raskapitur, kurse kjo vetë po e mbante me llafe.

— Bebe, shko fli pak në shtab se je lodhur. Së shpejti bëhet zgjimi.

— Sigurisht, ke të drejtë. Më ka lodhur tmerrësisht ajo gremina. Më shumë nervat e tendosura se sa muskujt. Shkova... — ai u ngrit më këmbë. E zuri vajzën për krahësh dhe e puthi në buzë. Mes tyre ishte automatiku i Vockës me fishekun në gojë dhe sigurecën e ulur. Vajza e ndjeu armën që ju shtrëngua si diagonale në gjoks.

Bebja u largua në drejtim të çadrave të shtabit, kurse thëllimi i mprehtë ushton atje poshtë në pyllin me pisha. «Shko, shko, origjinali im!» — tha vajza me vete. «Do vij të të zgjoj vetë».

Tej horizontit të murrmë vajza pa aurorën tek vinte krahëbardhë e ngrirë dhe e ftohtë, por ndonëse mes dimrit, pa dëborë, pa gjëmime, bubullima e shkrepëtima. Vajza vazhdoi të sodiste rënjen e mëngjjezit mbi reliefin plot dallgë malesh.

## SHQETËSIMI I METALURGUT

Unë dhe Sala po hynim në oborrin e uzinës.

— Salë, një minutë! — na thirri Vera në hyrje dhe erdhi me vrap. Atë ditë ajo i kishte lidhur flokët me një shami të bardhë dhe dukej më e kuqe, më e qeshur.

— C'është? — i foli Saliu ftohët, duke ngrysur vetullat e trasha. Unë i shikova me vëmendje të dy dhe s'po i kuptoja, as gjëzimin në fytyrën e Verës, as vetullat e zeza e të ngrysura të Saliut.

— Shëndet biraçëve! Besoj keni kohë për tur-nin. Ja, dielli i qershorit ende s'e ka kaluar majën e malit. Më saktësisht, keni edhe tridhjetë e pesë minuta plot. Pra, ç'desha të them... Mamaja më tha se i pëlqen të ndërrojë dimijat, prandaj dua t'i blej një palë tuta dhe një fustan. Natyrisht, tutat jo si këto të miat. Mirëpo copat e vitrinës janë nga ato të kombinatit, c't'i zgjedh? A do më ndihmosh?

— Mjaft grive sallatë, ku e ke hallin? — i foli Saliu pa qejf.

— Shoku Petrit, a me këtë humor shkoni në konvert ju biraçët?

— Kush tha? — e pyeta.

— Eja, Petrit, shkojmë. Kanë kohë gjithnjë kë-

to tē kompresorëve tē fryjnë kazanët tanë. . . Hajde!

— Prit njëherë — i thashë. — Po ç'kishe, Vera?

— Po ja, kam dëshirë tē hamë mëngjezin tok. . .

— ajo tani rrinte si fëmijë.

— Ti ke qejf, po unë s'kam qejf! Do tē vish, Petrit? Ika unë.

Saliu iku, unë mbeta vetëm me Verën.

— Hiç, éshtë zemëruar që në shtëpi, kurse ti kohët e fundit s'je dukur fare — tha ajo dhe iku e dëshpëruar për nga kompresorët. Unë e ndoqa Saliun për në sallën e ngrënjes. Ai ishte ulur në një tryezë dhe luante me lugën në tasin e madh tē qu-mështit. Shkova, u ula dhe unë aty me tasin tim e nisa tē përsleshja. Ai po hante pa qejf. Pastaj e la, e shtyu tutje.

— Ç'ke, pse nuk ha?

— S'kam oreks fare, s'e di çfarë drequin kam.

— Po me Verën, ç'pate?

— Éshtë me dy faqe. S'më pëlqejnë njerëzit që bëjnë politikë, si motra ime, e kuption? — dhe më shikoi mprehtë nën vetullat e zeza.

— Ç'politikë ka këtu?

— Shumë. Kjo «klasa punëtore» e kompresorëve higjenikë éshtë llastuar, éshtë aq akrobate, sa s'e ke idenë. . .

— Pse flet kështu për shoqet? — e pyeta unë.

— Por, ç'është e vërteta, në kompresorët puna éshtë më higjenike, prandaj atje u vendosën tē gjitha shoqet që erdhën pas laboranteve në uzinë.

— Vera éshtë vetëm motra ime, jo shoqja ime. . . Mbrëmë. . .

— Ç'ndodhi mbrëmë?

Ai pa orën.

— Pas punës rrimë për drekë në uzinë, sot nuk

do të shkoj tek «mamaja e babaja» — qeshi ai duke imituar Verën. — Do të të kallëzoj gjithë historinë dhe gjykona kush ka të drejtë, ajo që do të më tërheqë, apo unë që rri kështu. . .

Në sallë kishte shumë lëvizje dhe biseda. Pranë nesh kaloi mjeku i uzinës.

— Kush e la qumështin? — thirri ai. Zhurma pushoi. Punëtorët u ndalën. Ata të tryezave pranë nesh na i ngulën sytë. Saliu u kishte kthyer shpinën si pa të keq dhe nisi të fliste kot.

— E din ti, Petrit? Aty në konvert e ndjej vreten më mirë, se më pëlqen ngjyra e metalit të shkri-rë. E di që atë ngjyrë unë e shikoj shpesh edhe në ëndërr dhe, me gjithëse ka ato vështirësi që ti i di vetë, mua prapë më pëlqen.

— Mos dërdëllit, jepu përgjigjen! — i thashë me zë të ulët.

— Ju, shcku Sali? — pyeti mjeku.

— Cfarë? — ju kthyte Saliu.

— Pse nuk keni ngrënë?

— Aha, s'pata oreks.

— A mund të vini pak në ambulancë?

— Pas punës, pos... .

Të tjerët ja krisën të qeshurit.

— Jo «pas punës», por tani, shoku Sali! Dhe mos qesh! Shëndeti yt s'ka asgjë për të qeshur.

— Ashtu them edhe unë. Jam si molla... .

— Léri qyfyret, të lutem, eja pas meje! Punë sot s'ka.

Mjeku ishte shumë i rregullt në detyrën e tij.

Saliu mori tasin ndër duar dhe nisi të hante, ndërsa shokët qeshnin duke këputur ndonjë shaka. Mjeku priste me durim dhe kontrollonte me sy tryezat e tjera ku vlonte muhabeti me zë të lartë.

— Mbarova, «dotorre»...

— Mirë fort. Tani eja me mua të të vizitoj njëherë.

— A, tani mjaft nga shakatë... filloj turnin. Hajt, ditën e mirë, «dotorre»!

— Shoku Sali Meta, dëgjoni si ju thonë! — thirri mjeku duke i dalë përpara. Në këtë çast hyri në sallë sekretari partisë i uzinës.

— Mirë mëngjez, shokë! Ç'ka ndodhur?

— Shoku sekretar, ky metalurg nuk është në rregull sot dhe nuk dëgjon urdhërin që po i jap...

— Si është puna?

— Oreks nuk ka. Ushqimin e la. Humorin e ka të prishur. Fytyrën të zbetë. Duket se ka pasur temperaturë dhe pagjumësi. E ftova për vizitë, u ul përsëri në tavolinë dhe e piu me zor qumështin. E përsëri nuk pranon të vizitohet.

— Salë, nisu! — buzëqeshi sekretari duke i tre-guar mjekun.

— Unë po shkoj, por, për fjalë të nderit s'kam gjë... Kjo s'ka lidhje fare me shëndetin tim. Nejse, e pat. Më paç më qafë, moj bluzë e bardhë! Më ndave nga turni sot për mustaqet e...

Nga ky çast unë nuk e pashë më Saliun se shkova në konvert. Pas dyorëshit në konvertin tim, ika për pushimin. Ju e kuptioni, se në kushtet e konvertit nuk punohet më shumë se dy orë. Dhe këto me ndërprerje. Se konvertet janë të mëdha. Në barkun e tyre cilindrik të përthyer e të stërmadh sillet e pështillet llava e zjarrtë e metalit. Ajo llavë goditet nga rryma e fuqishme e kompresorëve, që të shpejtohet shkrirja. Ne biraçët qëndrojmë rrëth një metër larg barkut të stërmadh të konvertit. Kur

sytë e tij (ai ka bira nga të cilat na shikon llava e zjarrtë, prandaj ne na thërrasin «biraçë»), errësohen sadopak nga metalina, ne e godasim me shufrën metalike dhe lirojmë ajrin. Barku stërmadh gjëmon nga fryrja që i bëjnë kompresorët, llava e zjarrtë na shikon përmes syve flakërues dhe ne godasim e godasim. Ndërsa gazi sulfuror, i gjelbër dhe ngjyrë vjollce, përhapet valë-valë rrreth e rrotull. Qindra shkëndijëza të kuqe shpérndahen nga goditja dhe ne ndjejmë temperaturën, ndonëse veshje-sigurimi ynë prej impianti është i mirë. Djersa rrjedh nëpër trup pa hesap. Shpesh, kur punoj, kujtoj fjalët e Saliut, i cili, kur erdha këtu në konvert, më thosh: «kur ta kesh vështirë me temperaturën, mendo këto vite... dhe atëherë do ta godasësh si biraç i vërtetë, do ta kesh më lehtë...» Dhe unë e kuptoja, uzina jonë është ngritur në vitet gjashtëdhjetë me forcat tona.

Në të tilla çaste unë shikoja Saliu në platformën pranë konvertit të parë. Ai m'i ngulte sytë që i shkëlqenin pas gjyslykëve transparentë dhe dukej se më thosh: «Forca, rendimenti!» Kjo ishte shprehja e tij më e dashur, më e zakonshme, kur ishte i gjëzuar aty mbi platformë. Unë e dëgjoja në të tilla raste me vëmendje, se ai është më me përvojë se unë, është më veteran, si i themi ne. Ç'është e vërteta, kur Saliu kishte veshur kominoшет, unë ende ja merrja me gjumë bjeshkëve, me çiftelinë pranë e fyellin nën kokë, duke ruajtur dhentë e kooperativës. Por ai ka respekt për mua si shok i vërtetë dhe më quan punëtor, metallurg, megjithëse metallurgët e vërtetë janë si ai. Ai nuk dallohet vetëm nga kominoшет e përlyera e me njolla të errëta të grimcave të shkëndijëzave të kuqe të metalinës. Meta-

lurgu si ai, ka diçka të veçantë në të folur, në mendime, që s'e kanë të tjerët. Fjala e tij ka shumë blister dhe pak, fort pak skore. Kurse mendimi në ato fjalë të pakta është i rëndë plumb. Ndoshta më duket mua kështu, ndoshta kështu është me të vërtetë. Por unë flas nga platforma e konvertit.

Kur mbarova dyorëshin, në konvert erdhi shoku tjetër. Por në konvertin e parë s'u duk Saliu. Bëra dush, u ndërrova dhe dola në oborrin e uzinës. Shkova nga klubi. Ai nuk ishte. «Do gjë?» — më pyeti banakieri. «Partizan gjirokastre» — i thashë. «E ke parë Saliun?» «Nuk ishte në qejf sot. S'piu asgjë. E pyeta mos ishte sëmurë, por ai më shikoi i mërzitur dhe u largua. Iku. Duhet të jetë nga sallat e lojërave, në mos pastë shkuar në shtëpi.»

Unë s'e zgjata më me banakierin që kishte kohë për llafe. E durova, se më interesonte puna e Saliut, Ja mbatha nga salla e lojërave. Atje kërciste bilar-doja e të qeshurit. Ika që andej dhe hyra në bibliotekë. Në sallën e madhe kishte shumë punëtorë e punëtore. Në një cep ishte një nga ato të kompresso-rëve, Havaja, me një koleksion gazetash. Ma bëri me dorë, shkova.

— E ke parë Saliun — e pyeta unë.

— Është bërë individualist. Është struktur atje në sallën e vogël. Po merret me shkencë, s'pranon shoqëri. — më tha Havaja.

Saliu rrinte pranë dritäres. Mbi tryezë mbante hapur një libër të trashë. Kishte humbur fare në-për të.

— Salë, si u bë puna?

— «Dotorrja» më dha tri ditë pushim — tha duke qeshur. — Unë nuk e kuptoj fare mjekësinë e tij. Shkon tjetri të vizitohet tek ai, dhe ai i thotë pa

të keq: «Dil jashtë. S'ke gjë për raport». Kurse ngrihet e më jep tri ditë pushim mua. A e kupton ti këtë, apo jo? Dhe pas një listë me barna... — Saliu qeshi me të madhe.

— Po mirë. Nuk është keq të bësh ca pushim, derisa të këshillon ai.

— Për nder, kot e ka. Fare kot... Ç'më duhet mua pushimi, mor vëlla? Ai nuk është më të, më duket. Me të vërtetë unë nuk kam fjetur mbrëmë, por pushimin kot ma dha. Çfarë t'i bëj sekretarit, që ua dëgjon fjalën një më një këtyre kryqalinjve të kuq...

— Taksirat e paç, or Salë! Për të mirë u bë kështu. Po ç'po lexon ashtu?

— Po studjoj qëndrimin e bajraktarëve të veriut, gjithë akrobacitë e tyre me të huajtë...

— Këtu s'ka ndonjë temë të veçantë mbi ta, më duket.

— Studjo veprën e dytë të këtyre dokumentave, do të çuditesh — më tha dhe sytë i morën zjarr.

— Ata gjithnjë kanë kujtuar se ja kanë hedhur Partisë Komuniste, por s'u ka buzëqeshur fati... Sa dinakë e të zez kanë qenë ata, aq e urtë është Partia. Është gjë shumë interesante. Bajraktarët u ngajnë varrmihësve në gjithë historinë e tyre...

— Po pse nuk ke fjetur mbrëmë; ç'ka ndodhur andej nga ju?

— Histori e gjatë, luftë e vjetër në ndërtesë të re... — tha ai i menduar. Pastaj Saliu mbylli librin dhe më tregoi ç'kishte ngjarë...

— Ti e di që kam edhe një motër tjetër, përveç Verës... — nisi ai.

— Po, atë nxënësen e tetëvjeçares.

— Delinën, ish-nxënëse e klasës së tetë. Po, atë...

Kur erdha nga Rubiku këtu, më erdhi edhe familja nga fshati. Delina kishte një vit që nuk shkonte në shkollë, sepse tetëvjeçaren e kishte larg nga fshati. Bile kishte nja dy muaj që në qytetin tonë të vogël kishin filluar mësimet dhe prindërit e mi e mbanin Delinën në shtëpi. Vera ishte zënë me prindërit në fillim për këtë çështje, por pastaj ishte tërhequr në heshtje. As mua nuk më bëri zë, kurse prindërit jo e jo. Në ditët e para unë kujtoja se Delina shkonte në shkollë, kështu që nuk e vrisja mendjen dhe nuk pyeta asnjëherë për të. Ajo lexonte libra artistike dhe mua kjo gjë më gëzonte, se shikoja si po më rritej motra përpara sysh. Aty nga muaji nëntor, një pasdreke, drejtoresha e shkollës trokiti në shtëpinë tonë. Dola unë.

— Ju jeni prindi i Delinës? — më pyeti ajo.

— Jo, vëllai. Urdhëroni brenda! — i thashë.

— Ju falem nderit! Si është puna që e mbani vajzën pa shkollë? Ka dy muaj që kanë filluar mësimet... Vallë, s'ka njerëz në familjen tuaj që të jetojnë me kohën, me ligjet tona? Si shpjegohet ky qëndrim? — drejtoresha më shembi mirë.

— Moj shoqe... — unë desha të justifikohesha.

— Dëgjo shok. Më duket ju jeni metalurgu. Nesër vajza të vijë në shkollë. — zëri i drejtoreshës po më therte. Rashë ngushtë. Brenda s'dëgjohej fare zhurmë. Im atë dhe ime më rrinin në kuzhinë. Delina kaloi në korridor. — Po ti, nuk shkoke në shkollë? — e pyeta unë atë.

— Ju vëllai i saj, metalurg, nuk dini në shkon motra apo jo në shkollë?! Lumi që na mori!.. më qëlloi drejtoresha më zi se mësuesja ime dikur.

— Moj shoqja drejtoreshë, por unë... Nesër do të vijë menjëherë në shkollë. — desha t'i thosha

edhe ndonjë fjalë tjetër, por ajo iku. Kështu iku drejtoresha atëherë, kurse Delina shkoi me të vërtetë që të nesërmën në shkollë.»

Herë-herë unë shkoja në shkollë nëpër mbledhjet dhe Delina na nderonte me sjelljen dhe përparimin në mësime. Zënka ime atëherë me babanë, nënën dhe Verën për punë të Delinës u shua shpejt, si zjarr kashte.

Delina hodhi trup e u gjallërua mes shoqeve, aq më tepër se edhe me moshë ishte më përpara se klasa e saj... .

Saliu heshti, sikur u ndrydh në vetëvete.

— Po pastaj? — e pyeta Saliun ngase ende nuk po kuptoja ku e kishin burimin shqetësimet e tij.

— Pastaj... — vazhdoi ai i menduar. — Në filim të klasës së tetë, ishte koha kur nisën të prishe-shin në masë fejesat me shkuesi. Pak më parë prindërit e kishin fejuar Delinën, ndërsa në shtëpi she-nja pregetitjeje kishte vetëm për Verën, por përtë s'po të zgjatem, se ti e di. Për veten e saj Vera u tregua e zgjuar, tamam punëtore, kurse për Delinën jo. Fejesa u bë në heshtje, pothua fshehtas. Mua më tha im atë: «Filani na e kërkoi Delinën për filanin në filan fshat. Familje e mirë, djale i mirë, punon mekanik në centralin e lokalitetit.» «Pastaj, e dhatë?» — e pyeta unë. «Jo. Ta mendojmë njëherë... »

«Baba, kujdes! Mos na bën nishan në mes të njerëzve. Ndërroi moti. Delina po vazhdon shko-llën» — i thashë. «Shohim e bëjmë» — ma priti ai.

«Jo, shohim e bëjmë, baba — ndërhyri Vera. — Mua më latë pa të mesmen. Delinën do ta dërgojmë në shkollë të mesme. Nuk ka lezet që familja jonë të bjerë më poshtë se të tjerat. Pastaj, Delina mbaroi

provimet e lirimit me nota shumë të mira. I doli edhe e drejta e studimit për në Pedagogjike. Por, në vend që të gëzohej, ajo rrinte e menduar dhe kohët e fundit më shmangej. Gati nuk takohej fare me mua. Sikur druhej prej meje. Ishte mbyllur dhe **nuk cicëronte** si më parë nëpër shtëpi. E shikoja, por nuk merrja vesh ç'ndodhë me të. Mendoja se ajo ishte rritur dhe njeriu, kur rritet në një farë moshe, bëhet edhe më serioz. Kështu e shpjegoja unë qëndrimin e saj, prandaj edhe nuk i vura rëndësi.

Ka një javë që plasi sherri në shtëpi. Im atë, që e paskësh trashur me **zakon fejesën** e saj, e kishte bërë të kryer punën dhe kishte kurdisur «**zakone të reja**». Djalin na e paskësh pranuar në shtëpi. Ai na qenkësh lejuar që të njihej me Delinën. Im atë i kishte dhënë leje edhe të shetiste tok me Delinën e të shkonte edhe në kinema e përralla të tjera... Pas-këshin caktuar edhe datën e martesës. Mirëpo kjo nuk u bë.

Delina i prishi planet e babait. Ajo humbi besimin te të gjithë ne dhe iku nga shtëpia në kohën që aty ishte dhëndrri. Kishte gjetur shokët dhe shoqet e klasës së vet dhe kishin mbledhur organizatën e rinisë. Kishin njoftuar menjëherë edhe komitetin. Mbrëmë unë e gjeta atë të mërzitur e me sy të buhavitur. Nuk arriti të më sqaronte gjë, se im atë erdhi dhe kërceu si xhebraili. Këto që të kallëzova, i mora vesh pak e nga pak më vonë. Vera, që i kishte jetuar të gjitha këto, as që e bënte qejfin qeder. «Le të bëhet si të jetë më mirë» — kishte thënë. «Veç në punën time mos më ndërhyni». E, që t'i shmangej zënkës sime me babanë, as që më kishte folur fare ato ditë. As mbrëmë nuk foli, de-

risa... Plaku ndérhyri dhe lotët e Delinës më treguan më shumë se sa vetë Vera.

Natyrisht unë u zura rëndë me babanë. U zumë keq. Aq keq, sa i treguam derën njëri-tjetrit. Por as ai, as unë nuk dolëm nga apartamenti.

Në këtë zënkë na gjeti ekipi i komitetit të rinisë, i drejtorisë së shkollës dhe i bashkimit të grave të rrëthit. Delina, që humbi besimin te ne, gjeti mbështetjen tek ato shoqe. Çuditem edhe vetë, kur e mendoj se ku i gjeti Delina energjitetë të çante vettë... E natyrisht, për gjithë këto kishte faj Vera, kuptohet. Vera me moskokëçarjen e saj. Vera me mospërfilljen dhe lëkundjet e saj sa me prindërit sa me Delinën. Kur erdhën ato shoqe të ekipit, unë ende nuk e kisha të qartë si do të përfundonte çështja. Ato hynë njëra pas tjetrës si në shtëpinë e tyre dhe zunë vend në odën e pritjes.

— Si u bë kjo punë, shoku Sali? — më pyeti drejtoresha.

— Lëmsh u bë, ja si u bë... — psherëtita unë.

— Po pse nuk e lini Delinën të mbarojë shkolën? Pastaj le të martohet — tha instruktitorja e rinisë.

— Vajza e do vetë. Ne nuk e marrim nëpër këmbë — tha im atë duke përdredhur mustaqet e verdha. As ai as unë dhe asnjeri në shtëpi nuk dinim ende ç'kishte bërë Delina gjatë kohës që ishte i fejuari në shtëpi. Dinim se kishte ikur, po asgjë tjetër. Kështu që secili gjykonte sipas avazit të vet.

— S'është e vërtetë! — thirra unë. — Kësaj i thonë të shkelësh me këmbë fëmijën tënde, e jo më të drejtën e saj.

— Ti, Salë, merre me ngadalë — ndérhyri Vera. — Pa pyete Delinën ç'thotë. Derisa e do ajo, s'ka punë as babai as nëna.

Vera fliste e bindur dhe serioze.

— S'besoj të jetë kështu, shoqja Vera — tha instruktorja e rinisë. — Motra juaj kaq e re ka kohë të mendojë pér një problem të tillë.

— Po s'ke ç'i bën, moj bijë, kur e don vetë...  
— u shfajësua nëna.

— Ti, nënë, kujto rininë tënde dhe mos folë atë që s'është, — i thashë. — Kurse ti, Vera, ke më shumë faj se këta të dy...

— Sali, s'po flet fare mirë. Nëna ka të drejtë — ma ktheu ftohët ajo.

— Ja ku po ta them unë të drejtën: je më mikroborgjeze se sa çdo fshatar! — i shfryva aty në mes njerëzish.

— Borgjezi s'ka vend në shtëpinë time — folim atë rëndë-rëndë. Kur duhen vetë, pse t'i pengojmë ne?

Më vinte të pëllcisja. Gjithë kjo bisedë bëhej në sy të atyre shoqeve të tjera. Asnjëri nga ne të shtëpisë nuk e dinte mendimin e Delinës. Babai dhe nëna kishin besim në heshtjen e saj. Vera e quante të kryer dhe i jepte rrugë kësaj pune. Merre me mend si isha.

— Delinë! Delinë, moj! Eja këtu — thirra. Ishte shpresa ime e fundit pér të bërë pluhur gjithë atë kullë që kishin ngritur. Delina do të jepte mendim, do të thoshte një gjysmë fjale dhe gjithë problemi do të zgjidhej. Do të çlirohej shtëpia nga gjithë ai mishmash.

Ajo erdhi nga dhoma tjetër. Ishte e mpirë dhe pak e zbetë.

— Eja, Lina, ulu këtu — i foli drejtoresha. Po ajo s'pranoi. Qëndroi më këmbë, mes heshtjes.

— Delinë — i thashë, ndërsa zemra më rrihte me rrëmbim — e njeh ti atë mekanikun?

Të gjithë prisnin me padurim, kur ajo ngriti kokën.

— Po — tha. — E kam parë.

Babait ju çel fytyra. Nëna doli të bënte kafetë. Vera queshte si budallaqe. Ishte e vetmja që queshte.

— Delinë, e do ti atë? — pyeti drejtoresha.

— Jo. Nuk e dua. E quaj të tepërt ndërhyrjen

— tha. — Ju vetë më keni mësuar të mos lejojmë njeri të na marrë nëpër këmbë dëshirat tonë, jetën tonë.

Asaj i rrëshqitën lotët. Ajo nuk e përmbajti dot veten. U ngrita. E rrroka dhe e putha aty. Kjo komedi shtëpie mori fund. Im atë nisi të dridhte duhan, por i dridheshin gishtat dhe duhani i ra mbi prehër.

Mora vesh se që mbrëmë e kishin thirrur atë mekanikun në komitet. Mori fund, Po ne u bëmë lëmsh, veç nga faji i Verës. Ja, kjo qe.

— Domethënë Vera qëndroi indiferente ndaj motrës? U tregua egoiste?

— Kështu e gjykoj unë — tha Saliu më në fund.

Po tani, ç'do të bësh, do të vish tutje nga shtëpia?

— Jo. Do të shkoj nga dhomat e beqarëve, sepse s'kam kohë. Do të marr një sy gjumë se sonte do të punoj natën. Nuk e di cilit biraç i ka qëlluar të punojë në dy turne. . . . Do të punoj, përndryshe do të më prishë nervat vetmia. Si thua, a mos jam dallash?

— Gjërat s'janë aq të thjeshta sa na duken — i thashë. — Si duket Vera s'e paska vënë ujët në zjarr pér motrën e vogël. Sikur të kishte lëvizur

ajo në kohë, do të ishte zgjidhur më së miri kjo-punë, pa qenë nevoja të vinin në familje.

Saliu u ngrit. E la studimin mbi bajraktarët dhe u nis në drejtim të uzinës. E kush i dinte shqetësimet e tij veç meje?

Atë natë unë punova në turnin e tretë. Ngadritat dhe shkëndijëzat e zjarrta metalike Saliu dukej si një pjesë e kuqe e konvertit, të cilin e godiste me fuqi nga platforma në sytë e ndritshëm prej metaline. Goditjet e tij ishin të furishme, të përpikta-dhe tufat e shkëndijëzave të kuqe i derdheshin rrëth-e rrötull si shi yjesh.

## T R E

Në dhomë numër 17 dy beqarët luanin letra. I treti mungonte. I pari nga lojtarët ishte një djalë i shëndoshë, nga ata që i kanë llafet të pakta. Tjetri, ndoshta do të ishte i një moshe me të parin, por dukej më i ri, se ballin ja mbulonin balluket që, siç shihej, nuk i krihte më.

Ballukja nënqeshi me djallëzi. Kishte vetëm dy letra në duar. Tjetri as që e kishte mendjen aty. Ai dukej i mërzitur dhe, si dukej, donte ta mbaronte lojën një çast e më parë. Hodhi letrën dhe priti pak.

— I mbajç me shëndet!... — ja priti ballukja dhe i përplasi letrat njérën pas tjetrës.

— E lëmë... — i tha tjetri dhe u mbështet në karrige.

— Sikur të luanim me para, sonte do të të përlaja... — tha ballukja tek i xixëllonin sytë. Shoku nuk lëvizi nga karrigja. E shikoi atë si diçka të largët.

— Do lëkë? — i foli me njëfarë ironie, por ballukja e hetoi menjëherë zemërimin në sytë e tij dhe në atë qëndrimin e palëvizshëm në karrigë.

— Bakir, vallë, ti nuk rropatesh për lekë? —

ballukja ishte plotësish i bindur pér ato që tha dhe i zgjati duart mbi tryezë, ku ende qëndronin letrat.

— Jo. Nuk rropatem pér lekë. Pér lekë nuk futem 600 metér nën dhe. — i foli Bakiri ftohët dhe ndezi cigaren.

— Vallahi-bilahi, ti vdes pér një thërrime lavdi... — tha ballukja dhe mori cigare në paqetën e Bakirit, i cili shikonte diku tej dritäres, te dritat që llamburitnin në luginë.

— Kurse ti, o Frang, pér dhjetë qindarka...

Frangu lëmoi balluken me dorë, por nuk u prek nga fjala e Bakirit.

— Ti mendon me gjithë mend se pas vdekjes do të të ngrenë përmendore, o lumëmadh?

— E pse jo? Eja këtu, or cap fshati... — Bakiri e tërroqi shokun pranë dritäres dhe të dy qëndruan më këmbë. — Shiko si llamburit kjo natë nëntori atje poshtë. Kjo është përmendorja jonë. Ne e rrimitim atë, ajo neve...

— Ke filluar të flasësh si shkrimtari, or lumëmadh. S'ka as dy muaj që u ngule këtu në dhomën tonë dhe të mori koka erë. Po fluturon.

— Shikoje vetë. Mos thashë ndonjë gjë që s'është?

— E, ç'shikon ti atje poshtë? Qyteti të duket më i bukur natën se ditën. Po edhe atë do ta marrë lumi. Do të mbytet. Ty të pëlqejnë gjërat që vdesin...

— Unë nuk shkoj atë. Shkoj të riun mbi rrafshinë. I riu është i bukur.

Frangu u zu ngushtë.

— I riu është imi. Unë do të shkoj i pari. Do të vendosem, sa të martohem... — tha.

Dera e dhomës u hap. Hyri brenda era e nën-

torit dhe një djalë i ri si ata, me valixhe në dorë. Ai ishte i treti. Frangut kërceu përpjetë dhe u rrrok e u puth i pari, ndërsa Bakiri e shikonte pa lëvizur nga vendi. E shikonte me dashuri dhe kënaqej më të. Ndërsa takohej me Frangun, djali i porsaardhur shikoi Bakirin. Sytë e tij të gjallë flisnin më shumë se sa ato shprehjet standarte të takimeve. Ata u përshëndetën, pastaj djali u ul në tryezë.

— Kujtova se do ju gjeja në turn... — tha dhe sytë e gjallë i shkëlqyen nga ngazëllimi që u takua me shokët. Edhe Bakiri ishte i gëzuar, por nuk shfaqeji. Vendosi duart mbi tryezë, shikoi të ardhurin me vëmendje dhe priste të rejat.

— Shyqyr që erdhe në kohë. Mora lejen e zakonshme, se martohem të dielën — tha Frangut. — Do të vini të dy në dasmë!

Djali i porsaardhur qeshi. Ai dukej i lumtur. Por Bakiri ende nuk ishte i sigurtë në atë që priste.

— C'na solle? — e pyeti djalin.

Djalit ju formua një rrudhëz mes vetullash. U bë serioz si një burrë në moshë dhe Bakirit i pikoi mu në zemër.

— Takova redaktorin tim — tha djali.

— C'është redaktori? — pyeti Frangut duke lëmuar ballukan me dorë.

Djali e shikoi me seriozitet. Bakiri thithi ciganen i mërzitur. Tashmë e mori vesh atë që priste. Redaktori nuk ja kishte pranuar veprën përsëri.

— Redaktori, Frang vëllai, është gjykatësi im i parë. — tha djali i menduar. Ai i buzëqeshi ëmbël Frangut. E tash Bakirit i erdhi edhe më keq. Nisi të zjente nga brenda dhe ta kishte inat atë djall fjalë, si mishërimin e së keqes.

— Ai e kishte lexuar shkrimin tim dhe më dha

vërejtje të tjera... Ndoshta do të më duhen edhe nja gjashtë muaj punë.

— Domethënë i lave duart nga... — Frangu nuk foli më gjatë. Ai e kishte fjalën te honorari, por nuk ja arriti qëllimit, se Bakiri e shikoi me zemërim. «Kyçe!» — i tha ai. Dhe Frangu e kuptoi se atmosfera nuk ishte e mirë.

I porsaardhuri vazhdoi të tregonte vërejtjet që i kishin bërë për librin.

— Si të tha, si të tha ai? — ja preu fjalën Bakiri, se nuk e kuptoi shokun e vet dhe e shtypi cigaren në tavëll tërë nervozizëm.

Shkrimtari qeshi.

— «Këto nuk ndodhin — tha. — Janë trilli yt.»

— Po ti nuk i the që shkrove për ne dhe për këtë mal?! Sikur të më pyesnin mua, do t'u thosha: «E, më shihni? Unë jam trilli...» — Bakiri nga zemërimi e kishte mbledhur dorën grusht.

Shkrimtari qeshi dhe sytë i shkëlqyen e ju bënë më të vegjël, ndërsa Bakiri shfrynte me gjithë mend. Ai shkrim i kishte pëlqyer shumë Bakirit dhe e priste me padurim të dilte libër.

— Hajd, bre Meritan! Mos u mërzit! Leje krijuese ke boll... — i tha Frangu dhe u ngrit e mori kutinë e qumështit për të preqatitur darkën. Meritan i tha se kishte ngrënë dhe Frangu u ul përsëri.

— Që nesër në galeri nuk do të hysh më — i tha Bakiri. — Të bukur leje krijuese që bëre! Të ulesh e të shkruash edhe ditën. Një kopje të atij shkrimtit ma jep se do t'ua jap minatorëve. Do t'i kallim zjarrin atij redaktorit...

— Leja mbaron të shtunën. Unë filloj punën

time. Kurse ai redaktori ka ca të drejtë. Ndoshta do të punoj edhe ca mbi shkrimin. Duhet pastruar zhavorri nga minerali, siç bëjmë ne shpesh në galeri. Do menduar njëherë qetë-qetë kjo punë... — tha Meritani i ngrysur. Po ju s'më thatë, ç'kemi këtej? — Meritani ngriti kokën dhe e shikoi Bakirin në sy.

— Asgjë. Uzina vuri në veprim furrën e tretë. Këmi një rritje në plan. Po e përballojmë me rezervën e sektorit tonë. Te ne vazhdon ai damari i dhjamur. — Bakiri fliste i menduar. Ai ende dukej se nuk po shkëputej nga redaktori. Redaktori do të ishte njeri i çuditshëm, derisa nuk pëlqente shkrimin e Meritanit. «Po, po. Njeri i çuditshëm është ai», mendoi Bakiri.

— Në këtë damar po grijmë lekë... — tha Frangu.

Meritani nxori paqetën dhe ndezi një cigare. Pastaj u çua të zhvishej. Bakiri shikonte me dashuri trupin delikat të Meritanit, tek hiqte xhaketën, duke lëshuar shtëllungë tymin e duhanit.

— Në qoftë se ky damar na mban nja dy muaj, vjetori realizohet në shtator — tha Meritani. «Ky po flet tamam si minator», mendoi Bakiri, që po ndiqte me vëmendje lëvizjet e Meritanit.

— Zor se zgjat aq. Vjen i pjerrët dhe diku ka përzjerje. Kjo po na shqetëson të gjithë që tanë. Pastaj ata të uzinës bëjnë shumë zhurmë për mineralin tonë. E kërkojnë gjithnjë me përqindje dhe, kur t'i shikosh, me dy furra... — Bakiri dukej i mërzitur dhe i lodhur.

Dera u hap dhe brenda hyri sekretari i partisë për minierën, veshur për në galeri. Kapuçeta s'ja mbulonte dot thinjat ndër tamtha.

vërejtje të tjera... Ndoshta do të më duhen edhe nja gjashtë muaj punë.

— Domethënë i lave duart nga... — Frangu nuk foli më gjatë. Ai e kishte fjalën te honorari, por nuk ja arriti qëllimit, se Bakiri e shikoi me zemërim. «Kyçe!» — i tha ai. Dhe Frangu e kuptoi se atmosfera nuk ishte e mirë.

I porsaardhuri vazhdoi të tregonte vërejtjet që i kishin bërë për librin.

— Si të tha, si të tha ai? — ja preu fjalën Bakiri, se nuk e kuptoi shokun e vet dhe e shtypi cigaren në tavëll tërë nervozizëm.

Shkrimtari qeshi.

— «Këto nuk ndodhin — tha. — Janë trilli yt.»

— Po ti nuk i the që shkrove për ne dhe për këtë mal?! Sikur të më pyesnin mua, do t'u thosha: «E, më shihni? Unë jam trilli...» — Bakiri nga zemërimi e kishte mbledhur dorën grusht.

Shkrimtari qeshi dhe sytë i shkëlqyen e ju bënë më të vegjël, ndërsa Bakiri shfrynte me gjithë mend. Ai shkrim i kishte pëlqyer shumë Bakirit dhe e priste me padurim të dilte libër.

— Hajd, bre Meritan! Mos u mërzit! Leje krijuese ke boll... — i tha Frangu dhe u ngrit e mori kutinë e qumështit për të prebatit darkën. Meritan i tha se kishte ngrënë dhe Frangu u ul përsëri.

— Që nesër në galeri nuk do të hysh më — i tha Bakiri. — Të bukur leje krijuese që bëre! Të ulesh e të shkruash edhe ditën. Një kopje të atij shkrimtit ma jep se do t'ua jap minatorëve. Do t'i kallim zjarrin atij redaktorit...

— Leja mbaron të shtunën. Unë filloj punën

time. Kurse ai redaktori ka ca të drejtë. Ndoshta do të punoj edhe ca mbi shkrimin. Duhet pastruar zhavorri nga minerali, siç bëjmë ne shpesh në galeri. Do menduar njëherë qetë-qetë kjo punë... — tha Meritani i ngrysur. Po ju s'më thatë, ç'kemi këtej? — Meritani ngriti kokën dhe e shikoi Bakirin në sy.

— Asgjë. Uzina vuri në veprim furrën e tretë. Kemi një rritje në plan. Po e përballojmë me rezervën e sektorit tonë. Te ne vazhdon ai damari i dhjamur. — Bakiri fliste i menduar. Ai ende dukej se nuk po shkëputej nga redaktori. Redaktori do të ishte njeri i çuditshëm, derisa nuk pëlqente shkrimin e Meritanit. «Po, po. Njeri i çuditshëm është ai», mendoi Bakiri.

— Në këtë damar po grijmë lekë... — tha Frangu.

Meritani nxori paqetën dhe ndezi një cigare. Pastaj u çua të zhvishej. Bakiri shikonte me dashuri trupin delikat të Meritanit, tek hiqte xhaketën, duke lëshuar shtëllungë tymin e duhanit.

— Në qoftë se ky damar na mban nja dy muaj, vjetori realizohet në shtator — tha Meritani. «Ky po flet tamam si minator», mendoi Bakiri, që po ndiqte me vëmendje lëvizjet e Meritanit.

— Zor se zgjat aq. Vjen i pjerrët dhe diku ka përzjerje. Kjo po na shqetëson të gjithë që tanë. Pastaj ata të uzinës bëjnë shumë zhurmë për mineralin tonë. E kërkojnë gjithnjë me përqindje dhe, kur t'i shikosh, me dy furra... — Bakiri dukej i mërzitur dhe i lodhur.

Dera u hap dhe brenda hyri sekretari i partisë për minierën, veshur për në galeri. Kapuçeta s'ja mbulonte dot thinjat ndër tamtha.

— Ou, na paska ardhur shkrimtari! — thirri ai  
dhe u takua me të tre e u ul në karrigë. Mori një  
cigare dhe, pa e zgjatur, foli hapur.

— E dini si është puna? Një shembje në galerinë tuaj...

Të tre djemtë shikuan sekretarin e partisë në  
bebëz të syrit. Por, si u pa, ai i kuptoi djemtë në  
heshtjen e tyre, prandaj vazhdoi:

— Shokët janë shëndoshë — tha ai i qetë. —  
Puna është se na doli shumë dhé e zhavorr. Na hum-  
bi atë damarin... Deri në heqje të dheut, mineral  
s'ka në atë burim. Kurse ata miqtë kanë ndezur të  
tretën... Kot ta zgjasim. Do ta bëjmë me forca të  
përqëndruara heqjen e dheut e të zhavorrit. Ti, Ba-  
kir, do të vish?

— Ka marrë fund! — tha Bakiri, që deri atë  
çast rrinte si i mpirë. Ai u gjallërua sakaq dhe u  
ngrit të vishej.

— Po ti, dhëndërr? — pyeti sekretari Frangun.

— Unë dua të nisem nesër... — përtypi fjalët  
Frangu.

— Mirë. Ti, shoku Meritan, pusho sonte. Siç  
po shihet, do të kemi punë edhe nesër.

— Shoku sekretar, mua më ke në radhë. Jam  
i freskët. — tha Meritani dhe u ngrit pas Bakirit.

— Mirë, bëni si të dini — u tha sekretari dhe  
u ngrit e dolë. Pas tij iku Bakiri. Meritani po vishej  
me shpejtësi.

— Ti ke marrë lejen?! — pyeti ai Frangun, që  
po mendohej te dritarja.

— E mora, dreqin. Po s'e kam hallin aty. Unë  
martohem pasnesër dhe...

— Dhe të trashëgohesh! Nisu ti, normën tënde

e bëj unë. E na e ki në kujdes nusen, or qamet!  
Mos na e tremb me ato balluket. . ! — qeshi Meritani.

Frangu e shikoi me mëdyshje. «Dreqi vetë je, or shkrimtar», sikur thoshin sytë e tij nën balluke.

— Mos më shiko si cap, po kris. — i tha Meritani.

— Do të blej edhe ca kafe... Mund të nisem nesër paradite — ja priti Frangu i menduar. — Ju kam ftuar edhe ju. Ju pres.

— Po e mbaruam dot këtë, bën gati qoshenë — qeshi Meritani dhe sytë e vegjël përsëri i shkëlqyen e doli si era nga dhoma numër 17. Ai u përzie me grupin e minatorëve që çanin erën e nëntorit në drejtim të galerisë pesë. Këta ishin minatorë të të dyja turneve të lira. Shkonin grupe-grupe duke këmbyer ndonjë bisedë. Shkyenin errësirën me llambat që mbanin dhe hynin njëri pas tjetrit nëpër gojën e vogël të malit. Zbrisnin me të shpejtë shkallinat e para dhe tundnin dorën për të përshëndetur ata që vinin me vagona të mbushur për tek elektrovozi. Zhurma e vagonave vinte si uturimë e nëndheshme. Aty ata e ndjenin se po punohej me një ritëm jo të zakonshëm. Dukej sikur mali i tërë zjente nga brenda për atë proçkë që u kishte bërë. Njerëzit vërshuan si ujë i rrëmbyer i një lumi dhe pas ca të gjithë kishin detyra të caktuara.

Meritani gjeti një minator të ri tek shtynte vagonin vetëm. I vuri edhe vetë krahët vagonit dhe i nguli këmbët mirë. Vagoni e rriti shpejtësinë. I riu ishte mbuluar në djersë. Ngriti me njerën dorë kapuçetën e mushamasë dhe Meritani dalloi sytë e njojur të një komunisti të ri, që kryente stazhin e kandidaturës.

— Pse vetëm ti? — e pyeti.

— Ishim pak. Ky është vagoni i njëzetë — tha kandidati i ri.

Meritani desh ta vështronte përsëri djalin, por ai kishte ulur kokën dhe shtynte vagonin me tërë forcën. «Kështu e ka filluar jetën prej minatori edhe Bakiri», mendoi Meritani. «Kështu dhe pastaj ndejni për gjithnjë. Si do të ketë qenë Bakiri para se të bëhej minator dhe komunist?»

Në kthim vagonat e boshatisur vinin me shpejtësi e me zhurmë shurdhuese. Meritanit i duhej të vraponte pas vagonit tok me shokun e vet, duke lënë të lirë linjën nga vinin vagonat e mbushur.

— Meritan! — dëgjoi ai zërin e Bakirit diku pas shpine. Ktheu kokën dhe pa shokun e vet tek po shtynte i vetëm një vagon. Ai tundi kokën i pakënaqur dhe vazhdoi punën. «Sigurisht Bakirit nuk i erdhi mirë që, pas udhëtimit, Meritani të ulej në galeri. Por, në punë të tilla s'do shumë mend. Njeriu e kupton vetë. Bakiri, po ta ketë me tërë mend kështu, e ka gabim,» mendoi Meritani.

Ata arritën në vend për mbushje. Aty punonin dhjetë vetë. Pluhuri i kishte nxirë fytyrat e tyre, saqë Meritani e pati zor të dallonte se cilët ishin.

— Shkrimtar, shkruaj për ne! — i tha njëri nga ata, tek drejtoi trupin dhe hodhi lopatën e fundit me zall mbi vagonin e mbushur plot e përplot. Sytë e minatorit xixëlluan në sfondin e kuqërremptë të fytyrës.

— Mos u bëj merak! — ja ktheu kandidati në vend të Meritanit.

— E pse jo, është turn me rendiment. — tha Meritani.

— Ç'e do — tha djali i menduar — prodhimi mbeti prapa...

— Koha. Do ta bëjmë që ajo të vrapijë pas nesh.

— Kohën? — minatori qeshi dhe përsëri i xi-xëlluan sytë në sfondin e kuqërrëmtë të fytyrës së djerisit.

Aty afër mëngjezit doli përsëri pak mineral. Meritani pyeti kandidatin se sa do të kishte shkuar numri i vagonave.

— 189! — tha ai. — Duhet të jenë edhe më shumë, por kaqështë llogaria ime...

Pas pak ata dolën nga galeria se u zëvendësuan nga grupe të tjera minatorësh. Ishte prishur radha e turneve. Asnjërit s'i bëhej më vonë, nëse do të linte gjumin e do të vinte përsëri në turn.

Meritani e gjeti Bakirin shtrirë në krevat, veshur siç kishte qenë në galeri. Ai kishte fjetur një copë. Meritani u zhvesh dhe nisi të lahej, kur Bakiri lëvizzi pak dhe i foli nëpër gjumë.

— Meritan, fli!

Në atë kohë hyri në dhomë Frangu, veshur përnisje, me një strajcë mbushur me sende. Bakiri hapi sytë, e pa dhe i foli përsëri Meritanit.

— Ky po na martohet — tha dhe u çua e ndënjë mbi krevat. Tërhoqi valixhen. Frangu sikur u drodh. Bakiri e hapi me të shpejtë valixhen dhe u zverdh nga tronditja. Aty gjeti vetëm gjysmën e kartmonedhave që kishte lënë. Meritani po e shikonte me vëmendje. Bakiri, duke shikuar sytë e pastër që shkëlqenin nën ballin e madh të Meritanit, e kuptoi se sa e rëndë ishte të tregonte që i mungonin kartmonedhat.

Frangu ishte përkulur dhe diç ngatërronte në strajcë. Bakiri u ngrit dhe i shkoi pranë.

— Merri, Frang!... Ti shkon në fshat për marteşë. S'të blemë dot ndonjë gjë... Merri!

Frangu u ngrit prej strajcës. Ai ishte ngrysur. Instinktivisht shtriu dorën që i dridhej lehtë. Bakiri ja vuri kartmonedhat në të dhe ja mbylli gishtë-rinjtë duke i buzëqeshur me mundim ca nga lodhja, ca nga ajo tronditja, që mezi po e ndrynte në vëtëvete.

Meritani ishte nga ata njerëz të pakujdes që nuk i numrojnë kurrë lekët, kështu që nuk i ra gjë në sy. Tërhoqi njérën prej grumbullit dhe të gjitha qindëshet ja dha shokut.

— Frang, pranoi! Qofsh i lumtur dhe u bëfsh minator i vërtetë.

— Po nuk është nevoja, mor burrë. Unë s'kam dasmë me harxhe... — Ai u mundua t'i kundërshtonte, por shokët s'ja pranuan më. Sytë e tij endeshin sa andej-këtej, sikur kërkonin diçka që i humbi në çast, por nuk ndeshnin as te Bakiri as te Meritanë.

Ai doli pas pak me strajcën në sup, ndërsa shokët ranë në gjumë të thellë me mendimin se përsëri do të shkonin në galerinë pesë për të ndërruar shokët.

\* \* \*

Të dielën gjithë ditën turni i Bakirit punoi në galerinë pesë për heqjen e dheut e të zhavorrit, se damari i mineralit ende flinte pas gjithë atij vërshimi që zinte galerinë, apo hapej vendi i zënë.

Fytyra të lodhura me sy që shkëlqenin punonin me su'l'm. Vagonat përcillnin po atë uturimë shqetësuese që sillte mendimi se koha dhe prodhimi ishin ndalur e tok me ta do të shuhej edhe furra e tretë në uzinën e shkrirjes.

Bakiri me Meritanin vazhduan punën dhe pasi u zëvendësua turni, se i dyti kishte mungesa. Ishte e treta ditë që në galerinë pesë dritat notonin në pluhurin e në tymin e vazhdueshëm. Kështu që Frangun ata e panë vonë, ditën e hënë. Po ai Frang, me fytyrën e nxirë nga pluhuri si një maskë trajedie. Sytë e të treve u ndeshën në heshtje. Dy shokët ndalën vetëm një sekondë vagonin e mbushur që e shtynin me mundim. Vagoni bosh i Frangut kaloi me zhurmë e kuje aty pranë.

— Frang! — i thirri Bakiri i çuditur dhe drejttoi trupin.

— Paske ardhur? — foli Meritani dhe i shkëlqyen sytë, por zëri i tij nuk u dëgjua. E mbyti zhurma dhe kuja. «Sigurisht që Meritani di ta vlerësojë më shumë se Bakiri ardhjen time në punë fill pas dasmës», mendoi Frangu.

Kurse ata të dy vazhduan të shtynin vagonin, secili duke menduar për Frangun në mënyrën e vet. Sidoqoftë Frangu kishte ardhur. Diçka do të kishte ndodhur me të... Ata e çuan vagonin në pikëderdhje dhe u kthyen përsëri gati pa këmbyer asnje fjälë. Në vështrimet që këmbyen, atyre ju duk se që të dy mendonin veç për atë.

Përsëri e ndeshën shokun e tyre.

— Frang, kur do ta lesh?

— Mos më pritni... — thirri ai dhe vazhdoi të shtynte vagonin, pa e kthyer kokën nga shokët.

Ai ishte serioz. Ishte aq serioz Frangu, sa shokëve u vinte për të qeshur. Por ata nuk qeshën me të. Vazhduan rrugën në drejtim të elektrovozit me ritëm të shpejtë, se pas kishin shokë të tjerë me vagona të mbushur.

Ata e lanë punën, apo doli minerali me ngjyrën e vet të murrme. Dy shokët nuk e panë më Frangun. Ata dolën vetëm. Kaluan nga banjot e mensa dhe shkuan të flinin në dhomën 17. Mbi tryezë gjetën dy grumbuj me kartmonedha. Bakiri i shikoi me interes, i numroi, pastaj pyeti shokun:

— Meritan, sa lekë ke pasur?

— Pse?

— U kthye Frangu përsëri... — tha Bakiri dhe i hodhi kartmonedhat përsëri mbi tryezë. Ato ishin tamam. Kurse Frangu vazhdonte të punonte, ndonëse në shtëpi e priste nusja...

---

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Në korie mes lisash .....	3
Buzë pranverës. ....	15
Zgjimi .....	31
Fundi prej teritali. ....	50
«Bin-jak! Bin-jak!» .....	58
Merko. ....	63
Dy origjinalet .....	84
Shqetësimi i metalurgut .....	95
Tre. ....	109